

LIBRI I ABSTRAKTEVE
Abstracts book

Prishtinë, Kosovë
04.06.2025

Kjo konferencë është organizuar nga / This conference has been organized by:



Mbështetur nga/ Supported by:



**Accessible
Quality
Healthcare**

SDC project implemented by Swiss TPH



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë / Ministry of Health
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës /
National Institute of Public Health of Kosovo



Fuqizimi i komuniteteve të shëndetshme – arritjet dhe sfidat në promovimin e shëndetit



Strengthening healthy communities – achievements and challenges in health promotion

IV Konferenca Rajonale
për Promovim dhe
Edukim Shëndetësor

IV Regional Conference
for Health Promotion
and Education

Prishtinë, Kosovë
04.06.2025

Komiteti organizativ
Organizing Committee

Adnora Nurboja
Valbona Zhjeqi
Rina Hoxha
Mejreme Bajçinovci
Genc Bajraktari
Premtim Kadriu

Komiteti shkencor
Scientific Committee

Merita Berisha
Ardita Baraku
Naser Ramadani
Elena Kosevska
Gentiana Qirjako
Sanije Gashi
Naim Jerliu
Ariana Kalaveshi
Isme Humolli
Sefedin Muçaj
Lul Raka
Xhevat Jakupi
Lindita Maxhuni
Florie Miftari - Basholli

Sekretariati organizativ
Organizing secretariat

Sevdie Spahiu
Lendita Krasniqi
Shkelzen Kurtaj
Agron Hoxha
Pranvera Krasniqi
Sebahate Pacolli – Krasniqi
Igballe Shalaku
Nekibe Hyseni
Floriana Mehmedaliu
Diellza Thaçi
Nysret Ymeri

Anëtarët e nderit
Honorary members

Enver Baraku
Drita Zajmi
Nurishahe Hula
Gjyle Mulliqi
Tahire Gjergji
Gordana Pavlekovic

Konferenca e IV^{të} Rajonale për Promovim dhe Edukim Shëndetësor

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), për nder të 100-vjetorit të themelimit, organizon Konferencën e IV-të Rajonale të Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor me temën kryesore “Fuqizimi i komuniteteve të shëndetshme – arritjet dhe sfidat në promovimin e shëndetit”, në bashkëpunim me Asociacionin Kosovar të Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor, me datë 04 Qershor 2025, në Hotel International Prishtina në Prishtinë, Kosovë.

Konferenca siguron një platformë për profesionistët, akademikët, studiuesit dhe studentët që të kontribuojnë me punimet e tyre në tema që lidhen me promovimin dhe edukimin e shëndetit.

Qëllimi: Këtë vit, konferenca do të ketë në fokus mjediset dhe qasjet e shëndetshme, ndërtimin e partneriteteve drejt shëndetit më të mirë të individit dhe komunitetit.

Rezultatet e pritshme: Si pjesëmarrës të Konferencës së IV-të Rajonale për promovim dhe Edukim Shëndetësor, me pjesëmarrje ndërkombëtare, e temën kryesore “Fuqizimi i komuniteteve të shëndetshme – arritjet dhe sfidat në promovimin e shëndetit”, ju do të jeni në gjendje të prezentoni, të ndani dhe diskutoni në mënyrë aktive për situatën aktuale të promovimit dhe edukimit shëndetësor, tendencat dhe zgjidhjet e mundshme që të forcohet partneriteti ndërinstitucional dhe ndër-sektorial midis akterëve të ndryshëm dhe politikëbërësve.

The IVth Regional Conference on Health Promotion and Education

National Institute of Public Health of Kosovo (NIPHK) in honor of the 100th anniversary of its foundation, is organizing the IVth Regional Conference on Health Promotion and Health Education with the main theme: “Strengthening healthy communities – achievements and challenges in health promotion”, in collaboration with Kosova Association for Health Promotion and Education, on June 4th , 2025 at Hotel International Prishtina, in Prishtina, Kosovo.

The NIPHK Conference provides a platform for professionals, academics, researchers, and students to contribute with their papers on topics related to health promotion and health education.

Aim: This year, the conference will focus on Healthy Settings and building partnerships towards better individual and community health.

Expected outcomes: As a participant of the The IVth International Regional Conference on Health Promotion and Health Education with the main topic “Strengthening healthy communities – achievements and challenges in health promotion”, you will be able to present and/or actively share and discuss current situation, trends and possible solutions to strengthen the interdisciplinary and cross-sectorial partnership among different stakeholders and policymakers.

E merkture 4 Qershor 2025		Wednesday 4 June 2025
Vendi: Prishtinë		HOTEL INTERNATIONAL PRISHTINA
		Venue: Prishtina
08:30 – 09:00	<i>Regjistrimi / Registration</i>	
09:00 – 09:30	Moderator: Adnora Nurboja <i>Mirëseardhja dhe hapja e Konferencës</i> <i>Welcoming and opening of the Conference</i> <i>Përfaqësues të MSh (TBC)</i> <i>IKShPK: Dr. Ardita Baraku - Drejtor ekzekutiv</i> <i>Fakulteti i Mjekësisë, Prof.Sefedin Muçaj - Dekan</i>	
09:30 - 11:00	Sesioni plenar / Plenary session Moderator: Ardita Baraku Padmini Murthy:“Beijing Platform of Action and Beyond: The Challenges and Progress in Women’s Health Globally” Jozef Suvada “Small Country, Big Vision: How Kosovo Can Shape the Future of Global Health”, Arbër Shehu: “Preventing and detecting lung cancer: from risk to response” Ardiana Gjini: “Cancer Epidemiology- a global and UK perspective” Merita Berisha: “Arritjet dhe sfidat në promovimin e shëndetit në Kosovë”	
11:00 – 11:30	Pauzë freskimi / Short break / Poster prezantimet / Poster exhibition	
11:30 – 13:00	<i>Sesion paralel / Parallel session</i> <i>Sesioni I / Session I</i> Moderator: Rina Hoxha Profilet shëndetësore - Health Profiles Mejreme Bajçinovci, “Profili shëndetësor për Rajonin e Prishtinës” Agron Hoxha, “Profili shëndetësor për Rajonin e Prizrenit” Lendita Krasniqi, “Profili shëndetësor për Rajonin e Pejës” Shkëlzen Kurtaj, “Profili shëndetësor për Rajonin e Gjakovës” Igballe Shalaku, “Profili shëndetësor për Rajonin e Gjilanit” Nekibe Hyseni “ Profili shëndetësor për Rajonin e Mitrovicës” Florie Miftari Basholli, “Profili shëndetësor për Rajonin e Ferizajit”	

11:30 – 13:00	<i>Sesion paralel / Paralel session</i> <i>Sesioni II / Session II</i> Moderator: <i>Merita Berisha</i> <i>Ngritja e kapaciteteve dhe bashkëpunimi ndërsektoral - Capacity building and Cross-sectorial collaboration</i> <i>Valbona Zhjeqi,</i> "Ndikimi i trajnimit të komunikimit shëndetësor në kënaqshmërinë e pacientëve me shërbimet shëndetësore në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës" <i>Niman Bardhi,</i> "Roli i Ministrisë së Shëndetësisë në Edukimin dhe Promovimin e Shëndetit -Një Qasje Politikëbërëse" <i>Pranvera Krasniqi,</i> "Morbiditeti të të moshuarit mbi 65 vjeç në Kosovë gjatë viteve 2022–2023: Sfidat dhe domosdoshmëria e promovimit shëndetësor" <i>Zejnije A. Shala,</i> "Qasja e integruar në kujdesin shëndetësor" <i>Rozarta Nezaj,</i> "Akreditimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor në Shqipëri" <i>Sead Ahmetaj,</i> "Promovimi dhe zhvillimi i shëndetit"
13:00 – 14:00	Pauzë dreke / Lunch break / Poster prezantimet / Poster exhibition
14:00 – 15:30	<i>Sesion paralel / Paralel session</i> <i>Sesioni III / Session III</i> Moderator: <i>Isme Humolli</i> <i>Sëmundjet ngjitëse - Communicable diseases</i> <i>Donjeta Hajdari Pllana,</i> "Serologic and Genomic Investigation of West Nile Virus in Kosovo" <i>Edita Goranci Haxhiu,</i> "Ndërlidhja në mes të vaksinimit kundër fruthit dhe incidencës së sëmundjes si dhe evaluimi i imunitetit pasvaksinal" <i>Faik Hoti,</i> "Rasti i parë me Mpox në Kosovë dhe menaxhimi i tij – Studim rasti" <i>Shqipe Krasniqi Kola,</i> "Njohuritë, qëndrimet dhe praktikat lidhur me Ethet hemorragjike me sindromë veshkore në mesin e banorëve të përkohshëm në bjeshkë" <i>Kadrionë Azizi,</i> "Qëndrimet e prindërve para dhe pas vaksinimit kundër HPV-së në Kosovë" <i>Donart Zymberi</i> "Hepatiti Viral në Ballkan: Barrë Shëndetësore Publike dhe Strategjitë e Parandalimit"

	Endrit Muji , “Analizimi i njohurive rreth sëmundjeve seksualisht të transmetueshme tek nxënësit e shkollave të mesme në komunën e Gjilanit”
14:00 – 15:30	<i>Sesion paralel / Paralel session</i> <i>Sesioni IV / Session IV</i> Moderator: Valbona Zhjeki Sëmundjet jo-ngjitëse - NCD Naim Jerliu, “Të moshuarit me sëmundje kronike jongjitëse dhe malinje në Kosovë: Qasjet dhe sfidat e kujdesit” Gentiana Qirjako, “May Measurement Month campaign in Albania” Sanije Gashi, “Sëmundjet malinje në Kosovë” Elvira Rasimi, “2016/2021 Study on Knowledge, Attitudes, Practices and Behaviors of the Population Regarding Non-Communicable Diseases in Kosovo and the Use of Findings in the Design of Awareness Campaigns” Ariana Bytyqi Katanolli, “Vlerësimi i ndërhyrjeve për ndryshimin e sjelljeve shëndetësore përmes Kohortës së Sëmundjeve Kronike Jo-Ngjitëse në Kosovë” Naud Volders, “Understanding and Managing: Health Literacy and Chronic Disease Management Among Older Adults Visiting Community Centres and NGOs in Prishtina, Kosovo” Musli Gashi, “Vdekshmëria nga sëmundjet kardiovaskulare në Kosovë”
15:30 – 16:00	Paузë freskimi / Short break / Poster prezantimet / Poster exhibition
16:00 – 17:30	<i>Sesion paralel / Paralel session</i> <i>Sesioni V / Session V</i> Moderator: Gentiana Qirjako Faktoret e rrezikut - Risk Factors and communication Naim Jerliu, “Parandalimi i sëmundjeve jo të transmetueshme në Kosovë: Vlerësimi i sesioneve këshilluese motivuese për stile të jetesës më të shëndetshme në kujdesin parësor shëndetësor” Rudina Çumashi, “Pink October” in Albania – Empowering Communities through Health Education and Mobile Breast Cancer Screening” Adnora Nurboja, “Edukimi shëndetësor dhe mjedisor i Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian” Antigona Ukëhaxhaj, “Cilësia e ajrit të brendshëm në amvisëritë e Komunës së Prishtinës”

	Vlera Haxhishabani, “Hezitimi ndaj vaksinave : Ndikimi i medias dhe strategjitë për luftën kundër dezinformimit në Shëndetin Publik” Donjet Bislimi, ” Vlerësimi i besimit të publikut në autoritetet e Shëndetit publik dhe komunitetin mjekëor për të menaxhuar krizën COVID-19, Kosovë, Shtator-Tetor 2022” Vlora Ejupi, “Çrregullimet e gjumit gjatë kemioterapisë te pacientët me kancer”
16:00 – 17:30	<i>Sesion paralel / Paralel session</i> <i>Sesioni VI / Session VI</i> Moderator: Florie Miftari Basholli Tema tjera - Other topics Rina Hoxha, “Trendi i lindjeve normale dhe lindjeve me prerje Cesariene në Kosovë për 5 vitet e fundit” Albana Beqiri, “Ndikimi i teknologjisë në mjekësi” Zarife Miftari, ” Digital Dignity: Advancing Online Safety and Rights Through the Bodyright Campaign” Hajrullah Fejza, “Promovimi i Shëndetit Seksual në Kosovë - qasjet dhe perceptimet” Fitim Sadiku, “Kujdesi Grupor gjatë 1000 Ditëve të Para: Një Strategji për Promovimin dhe Kujdesin Shëndetësor gjatë Shtatzënisë” Mehmet Fatih Erol, “Comparison of the Effectiveness of Single Anastomosis Sleeve Ileal Bypass and Roux-en-Y Gastric Bypass in Obese Patients with Type 2 Diabetes” Genc Bajraktari, “Shëndeti mendor në epokën digjitale: sfidat dhe mundësitë për fuqizimin e komuniteteve përmes edukimit shëndetësor online”
17:30 – 18:00	Përmbledhja dhe përfundimi i konferencës / Recapitulation and the end of the conference

Conference topics / Temat e konferencës

1. Profilet shendetesore / Health profiles
2. Ngritja e kapaciteteve dhe bashkëpunimi ndërsektoral / Capacity building and cross-sectorial collaboration
3. Sëmundjet ngjitëse / Communicable diseases
4. Sëmundjet jo-ngjitëse / Non-communicable diseases
5. Faktoret e rrezikut dhe komunikimi / Risk factors and communication
6. Tema tjera / Other topics

Fjalë përshëndetëse

Në kuadër të përvjetorit të 100-të të themelimit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, kam kënaqësinë të prezantoj librin e abstrakteve të Konferencës së IV-të Rajonale për Promovim dhe Edukim Shëndetësor “Fuqizimi i komuniteteve të shëndetshme – arritjet dhe sfidat në promovimin e shëndetit”. Kjo konferencë vijon traditën e tri edicioneve të mëparshme, Konferencës së I-rë "Promovimi dhe edukimi i shëndetit: Nga politika në praktikë, nga praktika në politikë", Konferencës së II-të "Promovimi i shëndetit dhe edukimi shëndetësor: Mësimi nga praktikat" dhe Konferencës së III-të: "Promovimi dhe edukimi shëndetësor - Mjediset e shëndetshme", duke vazhduar kontributin për avancimin e njohurive dhe praktikave në fushën e shëndetit publik.

Promovimi dhe edukimi shëndetësor, si një nga funksionet themelore të shëndetit publik, për një shekull ka qenë shtyllë e rëndësishme në mbështetjen e institucioneve, profesionistëve shëndetësorë, individëve dhe komunitetit në përballje me sfidat shëndetësore. Gjatë këtyre 100 viteve, Kosova ka arritur përparime të rëndësishme: ulje të vdekshmërisë së foshnjave, parandalim të sëmundjeve vaksinë-preventabile, rritje të jetëgjatësisë dhe përmirësim të indikatorëve shëndetësorë. Programet parandaluese dhe promovuese kanë qenë thelbësore në fuqizimin e individit dhe komunitetit që të ndërmarrin vendime të informuara, të mbështetura në evidenca, dhe të përqafojnë sjellje të shëndetshme – në përputhje me temën e kësaj konference “Fuqizimi i komuniteteve të shëndetshme – arritjet dhe sfidat në promovimin e shëndetit”.

Konferenca e IV-të, e organizuar për 100-vjetorin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, ofron platformë shkencore për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave më të fundit në promovim dhe edukim shëndetësor. Me pjesëmarrjen e ligjëruesve të shquar vendorë dhe ndërkombëtarë, dhe me një program të pasur e gjithëpërfshirës, kjo konferencë ofron hapësirë për diskutime mbi temat kyçe të fushës. Libri i abstrakteve përmbledh këto kontribute të rëndësishme, duke reflektuar angazhimin për përmirësimin e shëndetit të komunitetit dhe fuqizimin e individit nëpërmjet njohurive dhe praktikave të bazuara në evidencë.

Në këtë përvjetor të veçantë, falënderoj të gjithë pjesëmarrësit dhe kontribuuesit që me punën dhe përkushtimin e tyre kanë ndihmuar në ngritjen e standardeve të shëndetit publik në Kosovë dhe shprehi bindjen se bashkëpunimi dhe përkushtimi do të vazhdojnë të jenë udhërrëfyes në sfidat e së ardhmes, drejt vizionit të përbashkët për popullatë të shëndetshme.

Singerisht!

Dr. Sci. Ardita Baraku

Drejtor ekzekutiv

Instituti Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

Opening remarks

In the framework of the 100th anniversary of the establishment of the National Institute of Public Health of Kosovo, I am pleased to present the book of abstracts of the IVth Regional Conference on Health Promotion and Education “Empowering Healthy Communities – Achievements and Challenges in Health Promotion”. This conference follows the tradition of the three previous editions, the Ist Conference “Health Promotion and Education: From Policy to Practice, from Practice to Policy”, the IInd Conference “Health Promotion and Education: Learning from Practice” and the IIIrd Conference: “Health Promotion and Education – Healthy Environments”, continuing the contribution to the advancement of knowledge and practices in the field of public health.

Health promotion and education, as one of the fundamental functions of public health, has been an important pillar in supporting institutions, health professionals, individuals and the community in facing health challenges for a century. During these 100 years, Kosovo has achieved significant progress: reducing infant mortality, preventing vaccine-preventable diseases, increasing life expectancy and improving health indicators. Preventive and promotional programs have been essential in empowering individuals and communities to make informed, evidence-based decisions and embrace healthy behaviors – in line with the theme of this conference “Empowering Healthy Communities – Achievements and Challenges in Health Promotion”.

The IVth Conference, organized for the 100th anniversary of the National Institute of Public Health of Kosovo, provides a scientific platform for the exchange of the latest knowledge and experiences in health promotion and education. With the participation of prominent local and international lecturers, and with a rich and comprehensive program, this conference provides space for discussions on key topics in the field. The book of abstracts summarizes these important contributions, reflecting the commitment to improving community health and empowering the individual through evidence-based knowledge and practices.

On this special anniversary, I thank all participants and contributors who, with their work and dedication, have helped raise public health standards in Kosovo and express my belief that cooperation and dedication will continue to guide the challenges of the future, towards a shared vision for a healthy population.

Sincerely,

Dr. Ardita Baraku, PhD

Executive director

National Institute of Public Health of Kosova

Abstraktet e konferencës

Conference abstracts

Platforma e veprimit në Pekin dhe më gjerë: Sfidat dhe progresi në shëndetin e grave globalisht

Padmini Murthy MD, MPH, MS, FAMWA, FRSPH

Hyrje: “Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit, e miratuar në vitin 1995, është një dokument historik për avancimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në nivel global, duke u përqendruar në 12 fusha kritike shqetësuese, dhe viti 2025 shënon 30-vjetorin e saj, duke ofruar një mundësi për të vlerësuar progresin dhe për të adresuar sfidat e vazhdueshme në shëndetin dhe fuqizimin e grave.

Konferenca shënoi një pikë kthese të rëndësishme për axhendën globale për barazinë gjinore. Është interesante të theksohet se Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit u miratua unanimisht nga 189 vende dhe aktualisht konsiderohet dokumenti kryesor i politikave globale mbi barazinë gjinore.

Progresi nga viti 1995 deri më sot

Disa nga fushat kryesore të progresit përfshijnë:

1. Shëndeti i Përmirësuar i Nënës 2. Qasje e Përmirësuar në kujdesin shëndetësor për vajzat dhe gratë. 3. Rritje e regjistrimit në shkollë për vajzat adoleshente. 3. Njohja e shëndetit të grave si përparësi dhe investimi në mirëqenien e grave është çelësi për mirëqenien shoqërore dhe arritjen e qëllimit të SDG 20230 për të Mos Lënë Askënd Pas. 4. Vëmendje e Rritur për adresimin e dhunës ndaj grave në nivel lokal, kombëtar dhe global.

Sfidat:

1. Progres i pabarabartë në shëndetin e grave për shkak të rritjes së pabarazive shëndetësore në disa rajone gjeografike. 2. Diskriminimi gjinor, stereotipet dhe normat mund të krijojnë pengesa për shëndetin dhe fuqizimin e vajzave dhe grave. 3. Rritje e pengesave në shëndetin mendor për shkak të trazirave civile, pandemive dhe fatkeqësive klimatike. 4. Mungesa e mbrojtjes dhe mohimi i të drejtës së votës për gratë dhe vajzat nga pakicat etnike dhe ata me aftësi të kufizuara. 5. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, pothuajse 70% e punonjësve të shëndetësisë janë gra, por vetëm rreth 25% e roleve udhëheqëse në shëndetësi mbahen nga gratë.

Rekomandime:

Është thelbësore për partneritete pozitive shumë-nivelëshe midis palëve të ndryshme të interesuara me një investim në shëndetin e grave dhe një angazhim të fortë politik dhe prioritizim të çështjeve urgjente që prekin gratë, shëndetin e tyre, udhëheqjen dhe drejtësinë gjinore - si barazia gjinore, shëndeti riprodhues dhe adresimi i të gjitha formave të dhunës dhe diskriminimit ndaj vajzave dhe grave.

Beijing Platform of Action and Beyond: The Challenges and Progress in Women's Health Globally

Padmini Murthy MD, MPH, MS, FAMWA, FRSPH

Introduction: “The Beijing Declaration and Platform for Action, adopted in 1995, is a landmark document for advancing women's rights and gender equality globally, focusing on 12 critical areas of concern, and 2025 marks its 30th anniversary, offering an opportunity to assess progress and address ongoing challenges in women's health and empowerment.

The conference marked a significant turning point for the global agenda for gender equality. It is interesting to note Beijing Declaration and Platform for Action, was adopted unanimously by 189 countries, and at present is considered the key global policy document on gender equality.

Progress from 1995 to Present

Some of the key areas of progress include:

1. Improved Maternal Health 2. Improved access to health care for girls and women. 3. Increased school enrollment for adolescent girls. 3. Recognition of women's health as a priority and investment in women's wellbeing is key for societal wellbeing and achieving the SDG 2030 goal of *Leave No One Behind*. 4. Increased attention to addressing violence against women locally, nationally and globally.

Challenges:

1. Uneven progress in women's health due to increased health disparities in some geographic regions .2. Gender discrimination, stereotyping and norms can create barriers for girls and women's health and empowerment. 3. Increased mental health setbacks due to civil unrest, pandemics and climate disasters.4. Lack of protection and disenfranchisement for women and girls from ethnic minorities and those with disabilities. 5. According to the world Health organization almost 70% of health workers are women, but only an estimated 25% of leadership roles in health are held by women.

Recommendations:

It is crucial for multi-level positive partnerships among diverse stakeholders with an investment in women's health and strong political commitment to and prioritization of urgent issues affecting women, their health, leadership and gender justice – like gender equality, reproductive health and addressing all forms of violence and discrimination against girls and women.

Vend i vogël, vizion i madh: Si mund ta formojë Kosova të ardhmen e shëndetit global

Folës: Prof. MD. Jozef Šuvada, PhD., MPH, MBA, MHA, MSc.

*Profesor i Plotë, Universiteti Shën Elizabeth i Shëndetit Publik dhe Shëndetit Global (SK),
Universiteti Scranton (SHBA), Universiteti McMaster (CA), Universiteti Makerere (UG)
jozef.suvada.mzsr@gmail.com*

Përmbledhje e Leksionit

100-vjetori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Kosovë është njëkohësisht një përkujtim dhe një thirrje për veprim. Na fton të reflektojmë se si një vend i formësuar nga kriza dhe rimëkëmbja tani mund të kontribuojë në një të ardhme më elastike dhe të qëndrueshme të shëndetit global. Udhëtimi i Kosovës, nga konflikti dhe përçarja sociale deri te ndërtimi i institucioneve dhe inovacioni, ofron njohuri unike për botën. Momente të tilla përfaqësojnë një dritare të fuqishme mundësish: një konvergjencë të historisë, aftësisë dhe vizionit. Në një kohë kërcënimesh globale në përshejtim, siç janë paqëndrueshmëria klimatike, ndryshimet demografike, pabarazitë dixhitale dhe rimëkëmbja pas pandemisë, po bëhet gjithnjë e më e qartë se madhësia e një kombi nuk është ajo që përcakton ndikimin e tij. Përkundrazi, është se sa efektivisht mëson nga e kaluara e tij, mobilizon njerëzit e tij dhe zbaton inovacionin për të forcuar sistemet dhe shoqëritë.

Ky leksion mbështetet në shembuj krahasues nga Estonia, Ruanda, Islanda dhe Sllovenia për të treguar se si kombet më të vogla mund të veprojnë si laboratorë të shkathët të transformimit të shëndetit. Kosova, me popullsinë e saj të re dhe të lidhur globalisht, infrastrukturën e saj dixhitale që evoluon me shpejtësi dhe përvojën e saj në rindërtimin nën presion, është e gatshme të udhëheqë pikërisht në këtë mënyrë.

E bazuar në një kornizë të Teorisë së Ndryshimit, leksioni paraqet tre fusha ku Kosova mund të bëhet një kontribuese globale:

1. Inovacioni Dixhital i Shëndetit Publik: Kosova ka mundësinë të kalojë përpara duke zbatuar sisteme shëndetësore inteligjente, duke përfshirë të dhënat mjekësore elektronike, mbikëqyrjen e sëmundjeve të mbështetur nga inteligjenca artificiale dhe rrjetet e tele-shëndetësisë. Këto teknologji mund ta ndihmojnë Kosovën të sigurojë barazi, aksesueshmëri dhe vendimmarrje të bazuara në të dhëna.

2. Diplomacia Shëndetësore dhe Përgatitja Rajonale: Përmes bashkëpunimit me vendet fqinje dhe partnerët ndërkombëtarë, Kosova mund të forcojë rolin e saj si një pjesëmarrëse në Ballkanin Perëndimor. Angazhimi i saj ndaj transparencës së të dhënave dhe planifikimit ndërkufitar të emergjencave është kritik për sigurinë shëndetësore rajonale dhe globale.

3. Fuqia Punëtore Rezistente dhe Lidershipi i Gjeneratës së Ardhshme: Investimi i Kosovës në profesionistë të shëndetit publik me aftësi ndërdisiplinore, që lidhin shkencën e të dhënave, shëndetin e sjelljes, politikën mjedisore dhe etikën, mund të ndërtojnë një fuqi punëtore të gatshme për kërcënime të reja dhe të paparashikuara.

Përvoja e Kosovës në përballimin e krizave të shumta sociale dhe shëndetësore nuk ka qenë një dobësi, por një provë e rezistencës. Njerëzit dhe institucionet e saj kanë mësuar të përshtaten, të rindërtojnë dhe të riimagjinojnë atë që është e mundur. Sot, të njëjtat aftësi mund t'i shërbejnë komunitetit global, duke informuar sistemet shëndetësore që janë më gjithëpërfshirëse, më të përgatitura dhe më të qëndrueshme.

Shëndeti publik nuk ka të bëjë vetëm me parandalimin e sëmundjeve. Ka të bëjë me projektimin e shoqërive që vlerësojnë dinjitetin, solidaritetin dhe mirëqenien afatgjatë. Kosova tani ka mundësinë të bëhet jo vetëm një pjesëmarrëse në progresin global të shëndetit, por edhe një bashkëarkitekte e drejtimit të saj. Ky leksion na bën thirrje të mendojmë me guxim, të veprojmë etikisht dhe të bashkëpunojmë përtej kufijve dhe disiplinave, duke ndërtuar jo vetëm sisteme shëndetësore më të forta, por edhe shoqëri më të forta.

Small Country, Big Vision: How Kosovo Can Shape the Future of Global Health

Speaker: Prof. MD. Jozef Šuvada, PhD., MPH, MBA, MHA, MSc.

Full Professor, St. Elizabeth University of Public Health and Global Health (SK), Scranton University (US), McMaster University (CA), Makerere University (UG)

jozef.suvada.mzsr@gmail.com

Lecture Abstract

The 100th anniversary of the National Institute of Public Health in Kosovo is both a commemoration and a call to action. It invites us to reflect on how a country shaped by crisis and recovery can now contribute to a more resilient and sustainable global health future. Kosovo's journey, from conflict and social disruption to institution building and innovation, offers unique insights for the world. Moments like this represent a powerful window of opportunity: a convergence of history, capability, and vision. In a time of accelerating global threats such as climate volatility, demographic shifts, digital inequities, and post-pandemic recovery, it is increasingly clear that a nation's size is not what determines its impact. Rather, it is how effectively it learns from its past, mobilizes its people, and applies innovation to strengthen systems and societies.

This lecture draws on comparative examples from Estonia, Rwanda, Iceland, and Slovenia to show how smaller nations can act as agile laboratories of health transformation. Kosovo, with its young and globally connected population, its rapidly evolving digital infrastructure, and its experience in rebuilding under pressure, stands poised to lead in exactly this way.

Grounded in a Theory of Change framework, the lecture presents three areas where Kosovo can become a global contributor:

1. **Digital Public Health Innovation:** Kosovo has the opportunity to leap ahead by implementing smart health systems, including electronic medical records, AI-supported disease surveillance, and telehealth networks. These technologies can help Kosovo ensure equity, accessibility, and data-driven decision-making.
2. **Health Diplomacy and Regional Preparedness:** Through collaboration with neighboring countries and international partners, Kosovo can strengthen its role as a convener in the Western Balkans. Its commitment to data transparency and cross-border emergency planning is critical for regional and global health security.
3. **Resilient Workforce and Next-Generation Leadership:** Kosovo's investment in public health professionals with interdisciplinary skills, linking data science, behavioral health, environmental policy, and ethics, can build a workforce ready for emerging and unforeseen threats.

Kosovo's experience of navigating multiple social and health crises has not been a weakness but a crucible of resilience. Its people and institutions have learned to adapt, rebuild, and reimagine what is possible. Today, those same capabilities can serve the global community, informing health systems that are more inclusive, more prepared, and more sustainable.

Public health is not just about preventing illness. It is about designing societies that value dignity, solidarity, and long-term well-being. Kosovo now has the opportunity to become not just a participant in global health progress but a co-architect of its direction. This lecture calls on us to think boldly, act ethically, and collaborate across borders and disciplines, building not only stronger health systems but stronger societies.

Parandalimi dhe zbulimi i kancerit të mushkërive: Një qasje kombëtare nga rreziku te reagimi

Dr. Arber Shehu, MD, MS – Drejtor Mjekësor, AstraZeneca, SHBA

Abstrakti:

Kanceri i mushkërive mbetet shkaku kryesor i vdekjeve nga kanceri në botë, me 2.48 milionë raste të reja dhe 1.8 milionë vdekje në vitin 2022. Parashikimet globale tregojnë se kjo shifër mund të kalojë 3.5 milionë vdekje deri në vitin 2050. Faktorët e jashtëm të rrezikut përfshijnë duhanpirjen (shkaktar në 80–90% të rasteve), ndotjen e ajrit, ekspozimin ndaj radonit dhe substancave kancerogjene në vendin e punës. Faktorët e brendshëm përfshijnë predispozitën gjenetike, plakjen, sistemin imunitar të dobësuar dhe inflamacionin kronik të mushkërive (si COPD).

Shumica e rasteve zbulohen në stade të avancuara për shkak të simptomave jo specifike, nivelit të ulët të njohurive shëndetësore dhe mungesës së skriningut të strukturuar. Ndërhyrjet për edukim dhe skrining janë thelbësore për të ndryshuar këtë realitet. Skriningu me tomografi të kompjuterizuar me dozë të ulët (LDCT) ul vdekshmërinë me 20–24% dhe ofron një mundësi të provuar për zbulim të hershëm.

Ky prezantim ofron një qasje të integruar globale, të bazuar në udhëzimet e përditësuara nga USPSTF dhe ACS, si dhe në modele të suksesshme si Iniciativa ALCSI në SHBA. Qasja përfshin ndërgjegjësim publik, fuqizimin e mjekëve të kujdesit parësor, përfshirjen e komunitetit dhe ndërtimin e sistemeve të ndjekjes së pacientëve pas diagnozës.

Ndryshimi është i mundur përmes bashkëpunimit global, veprimit institucional dhe politikave të bazuara në prova shkencore.

Fjalë kyçe: Kancer i mushkërive, LDCT, edukim shëndetësor, skrining, faktorë të rrezikut, politika publike, shëndeti global

Preventing and Detecting Lung Cancer: A National Approach from Risk to Response

Dr. Arber Shehu, MD, MS – Medical Director, AstraZeneca, USA

Abstract:

Lung cancer remains the leading cause of cancer-related death globally, with 2.48 million new cases and 1.8 million deaths reported in 2022. Projections indicate this figure could exceed 3.5 million annual deaths by 2050. External risk factors include tobacco smoking (responsible for 80–90% of cases), air pollution, occupational exposure to carcinogens, and radon. Internal factors include genetic predisposition, aging, immunosuppression, and chronic inflammatory lung diseases such as COPD.

Late diagnosis—often due to low health literacy, nonspecific symptoms, and limited access to care—results in poor outcomes. Low-dose computed tomography (LDCT) screening has been shown to reduce lung cancer mortality by 20–24% and represents a proven tool for early detection.

This presentation outlines a global, integrated approach based on the latest guidelines from the USPSTF and American Cancer Society, as well as best-practice models such as the American Lung Cancer Screening Initiative (ALCSI). It highlights the importance of public awareness, primary care physician engagement, community-based education, and post-diagnosis patient navigation systems.

Addressing the lung cancer crisis requires political commitment, cross-sector collaboration, and an urgent collective response grounded in evidence-based policy and action.

Keywords: Lung cancer, LDCT, health education, screening, risk factors, prevention, global health

Epidemiologjia e kancerit – perspective globale dhe e Britanise se Madhe

Dr Ardiana Gjini, Specialiste e Shëndetit Publik, Britani e Madhe

Kanceri është shkaktari i dytë i vdekjeve në popullatën globale, pas sëmundjeve ishemike të zemrës. Poashtu është shkaktari i dytë më i madh i peshës së sëmundjeve – global burden of disease. Prej grupit të kancereve, kanceri i mushkërive shkakton numrin më të madh të vdekjeve, dhe poshtu numrin më të madh të vdekjeve të parakohsme (ndër moshën 75 vjeçare), me më së 1.76 milion vdekje në vit, me kancerin e zorrës së trashë (kolorektal) që vie pas me mbi 860 mijë vdekje në vit. Incidenca e kancerit është më e lartë në vendet me jetëgjatësi e lartë të popullatës pasi që rreziku i kancerit rritet me moshë. Porse, incidenca është poashtu e varur nga kapacitetet diagnostifikuese dhe raportuese të vendeve, prandaj në vendet e pazhvilluara ose ato në zhvillim incidence e raportuar është më e ulët. Mortaliteti i kancerit poashtu varet nga kapacitetet dhe praktikatat diagnostifikuese e raportuese të sistemeve shëndetësore dhe në shumë vende, vdekjet nga kanceri raportohen si vdekje nga komplikimet e tij, psh. hemoragjia, komplikime infeksioni, etj.

Në Britaninë e Madhe (BM), kanceri është shkaktari më i madh i vdekjeve të parakohshme, duke shkaktuar më shumë se 40% të të gjitha vdekjeve të parakohshme. Përkundër avancimeve të mëdha në menaxhimin dhe trajtimin e kancerit, ende gjysma e rasteve të kancereve në Britaninë e Madhe nuk mbijetojnë deri në 5 vjet. Kanceri prek gati 1 në 2 persona gjatë jetës në Britaninë e Madhe.

Kanceri është një prej aspekteve të shëndetësisë që i kushton më së shumti jo vetëm sistemit shëndetësor por edhe tërë shoqërisë. Dhe atë për shkak të kujdesit shëndetësor të kushtueshëm dhe viteve të humbura të jetës së shëndetshme (Years of Life Lost, YLL).

Kontrolla e kancerit fokusohet në reduktimin e faktorëve të rrezikut, ku prijnë pirja e duhanit dhe obeziteti, në diagnostifikimin e mëhershëm të rasteve, skrinimi i popullatës, vaksinimi, hulumtimi dhe zhvillimi i metodave të trajtimit. Rezistenca ndaj antibiotikëve është një aspekt i rëndësishëm dhe në rritje të rëndësishë për kotnrollin e kancerit globalisht.

Në konkludim, kanceri është një prej problemeve më madhore të shëndetit publik në Britaninë e Madhe dhe globalisht.

Cancer Epidemiology – Global and UK Perspectives

Dr Ardiana Gjini, Public Health Specialist, UK

Cancer is the second leading cause of death in the global population, after ischaemic heart disease. It is also the second largest cause of disease burden – global burden of disease. Of the cancer group, lung cancer causes the highest number of deaths, and also the highest number of premature deaths (over the age of 75), with over 1.76 million deaths per year, with colorectal cancer following with over 860 thousand deaths per year. The incidence of cancer is higher in countries with high life expectancy as the risk of cancer increases with age. However, the incidence is also dependent on the diagnostic and reporting capacities of the countries, therefore in underdeveloped or developing countries the reported incidence is lower. Cancer mortality also depends on the diagnostic and reporting capacities and practices of health systems and in many countries, deaths from cancer are reported as deaths from its complications, e.g. haemorrhage, infectious complications, etc.

In the United Kingdom (UK), cancer is the leading cause of premature death, accounting for more than 40% of all premature deaths. Despite major advances in cancer management and treatment, half of all cancer cases in the UK do not survive for 5 years. Cancer affects almost 1 in 2 people during their lifetime in the UK.

Cancer is one of the most costly aspects of health, not only to the health system but also to society as a whole. This is due to the high cost of healthcare and the Years of Life Lost (YLL).

Cancer control focuses on reducing risk factors, such as smoking and obesity, early detection, population screening, vaccination, and research and development of treatments. Antibiotic resistance is an important and growing issue in cancer control globally.

In conclusion, cancer is one of the major public health problems in the UK and globally.

Arritjet dhe Sfidat për Promovimin e Shëndetit në Kosovë

Merita Berisha^{1,2}

¹ *Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës*

² *Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës*

Hyrja

Për shumë dekada edukimi dhe promovimi shëndetësor kanë përcjellur dhe ndihmuar në arritjen e rezultateve si dhe adresimin e sfidave për shëndetin në Kosovë.

Qëllimi

Ky punim paraqet disa nga arritjet dhe sfidat kryesore në fushën e promovimit të shëndetit dhe edukimit në Kosovë ndër vite.

Materiali dhe metodat

Për përgatitjen e këtij punimi, janë përdorur materialet, hulumtimet dhe dokumentet strategjike të disponueshme të përgatitura vitet e fundit në Kosovë për të reflektuar mbi arritjet dhe sfidat për shëndetin në Kosovë.

Rezultatet

Nga tetori i vitit 1999, në IKSHPK ka filluar punën Komisioni i KESH, me prioritet ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe është pasuar me trajnimin e trajnerëve në bashkëpunim me OBSH në nëntor të vitit 1999.

Përfshirja e individit, komunitetit dhe popullsisë, forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial dhe shënimi i ditëve ndërkombëtare të shëndetit janë disa arritje të viteve të fundit.

Përfundimi

Të dhënat dhe raportimi i rregullt, hulumtimi dhe çështjet mjedisore vazhdojnë të mbesin sfida edhe në vendin tonë. Nevojitet të pajisemi me aftësitë e nevojshme për të qenë gati të përballemi me sfida të reja për shëndetin.

Fjalët kyçe:

Promovimi dhe edukimi shëndetësor, Kosova.

Achievements and Challenges for Health Promotion in Kosovo

Merita Berisha^{1,2}

¹ *National Institute of Public Health of Kosovo*

² *Medical Faculty, University of Prishtina*

Introduction

For many decades, health education and promotion have guided and helped achieving results and address health challenges in Kosovo.

Aim

This work presents some of the major achievements and challenges in the field of health promotion and education in Kosovo.

Materials and methods

For the preparation of this paper, available materials, researches and strategic documents prepared in recent years in Kosovo have been used to reflect on the achievements and challenges for health in Kosovo.

Results

In October 1999, the KESH Commission began work at the National Institute of Public Health, with a priority on building human capacities, followed by training of trainers in collaboration with WHO in November 1999.

Involving the individual's, community and population, strengthening inter-sectoral cooperation and collaboration, marking international health days are several achievements over the years.

Conclusion

Data and regular reporting, research, and environmental issues continue to be challenges in our country. We need to equip ourselves with the necessary skills to be ready to face new health challenges.

Key words

Health Promotion and education, Kosovo.

- I -

Profilet shëndetësore

Health profiles

Profili shëndetësor për rajonin e Prishtinës

Mejreme Bajçinovci^{1,2}, Sevdie Spahiu^{1,2}, Merita Berisha^{1,2}, Ardita Baraku¹, Florie Miftari Basholli^{1,2}, Sebahate Pacolli Krasniqi^{1,2}, Lejlifere Shabanaj Krasniqi^{1,2}, Floriana Saiti¹, Arlinda Jetishi¹, Heroida Ferati¹, Egzon Pnishi¹

1. *Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës*
2. *Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë*

Abstrakti

Hyrje: Rajoni i Prishtinës shtrihet në pjesën veri perëndimore të Kosovës, është rajoni më i madh i Kosovës me 27% të sipërfaqes dhe ka tetë komuna: Prishtinën, Podujevën, Drenasin, Lipjanin, Fushë Kosovën, Obiliqin, Graçanicën dhe Artanën.

Qëllimi: Pasqyrimi i profilit shëndetësor për Rajonin e Prishtinës si dhe paraqitja e aktiviteteve të edukimit dhe promovimit shëndetësor të realizuara.

Materiali dhe metodologjia: Hulumtimi është i tipit kohortë retrospektiv me komponentën deskriptive, burim i të dhënave janë: Agjencia e statistikave të Kosovës, analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës dhe sistemit shëndetësor 2023, raporti i gjendjes perinatale në Kosovë 2023 si dhe raporti vjetor i aktiviteteve edukative shëndetësore.

Rezultatet: Rajoni i Prishtinës ka popullsi prej 507,530 banorë, prin komuna e Prishtinës me 226,068 banorë, ndërsa Artana ka numrin më të vogël të banorëve me 4,495. Rajoni i Prishtinës kishte këtë strukturë të indikatorëve: Banorë 31.7%, lindur gjallë 31.3%, vdekur 15.2% dhe të vdekur foshnje 46%. Indikatorët demografik ishin: Nataliteti 14.6‰, mortaliteti 6.5‰, mortaliteti infantil 7.2‰, shtimi natyror 8.1‰, nupcialiteti 8.7‰ dhe divorciteti 1.7‰. Indikatorët e mbulimit në Kujdesin Parësor janë: 1,275 banorë/mjek, 6,801 banorë/stomatolog dhe 498 banorë/infermier. Edukimi dhe Promovimi shëndetësor është realizuar përmes këtyre aktiviteteve: shpërndarja e 15,850 materialeve edukativo shëndetësore, mbajtja e 149 ligjëratave me 13,550 pjesëmarrës.

Konkluzioni: Për të përmirësuar profilin shëndetësor të Rajonit të Prishtinës, rekomandohet që institucionet shëndetësore dhe autoritetet lokale të fokusohen në fuqizimin e kujdesit parësor përmes rritjes së numrit të mjekëve familjarë, përmirësimit të infrastrukturës dhe trajnimeve të vazhdueshme profesionale.

Fjalët kyqe: komuna, rajoni, shëndetësi, indikator.

Health Profile for the Prishtina Region

Mejreme Bajçinovci^{1,2}, Sevdie Spahiu^{1,2}, Merita Berisha^{1,2}, Ardita Baraku¹, Florie Miftari Basholli^{1,2}, Sebahate Pacolli Krasniqi^{1,2}, Lejlifere Shabanaj Krasniqi^{1,2}, Floriana Saiti¹, Arlinda Jetishi¹, Heroida Ferati¹, Egzon Pnishi¹

1. National Institute of Public Health of Kosovo

2. UP, Faculty of Medicine

Abstract

Introduction: The Pristina Region is located in the north-west of Kosovo, it is the largest region of Kosovo with 27% of the area and has eight municipalities: Pristina, Podujevo, Drenas, Lipjan, Fushë Kosovë, Obiliq, Graçanica and Artana.

Aim: Overview of the profile for the Pristina Region as well as the presentation of the education and promotion activities carried out.

Material and methodology: The research is the retrospective cohort type with descriptive components, the data sources are: Kosovo Agency of Statistics, analysis of the health status of the population and the health system 2023, the report of the perinatal situation in Kosovo 2023 and the annual report of the of educational activities.

Results: The Pristina region has a population of 507,530 inhabitants, the municipality of Pristina has 226,068 inhabitants, while Artana has 4,495 inhabitants. The Pristina region has a structure of indicators: Residents 31.7%, live births 31.3%, deaths 15.2% and infant deaths 46%. Demographic indicators were: Birth rate 14.6‰, mortality 6.5‰, infant mortality 7.2‰, natural increase 8.1‰, marriage rate 8.7‰ and divorce rate 1.7‰. Primary Care coverage indicators are: 1,275 inhabitants/doctor, 6,6801 inhabitants/dentist and 498 inhabitants/nurse. Education Promotion is carried out through several activities: distribution of 15,850 educational materials, holding 149 lectures with 13,550 performers.

Conclusion: In order to raise the profile of the Prishtina region, it is recommended that care and institutions focus on strengthening primary care through increasing the number of family doctors, improving the activities and training of professionals.

Keywords: municipality, region, health, indicators.

Profili shëndetësorë në Rajonin e Prizrenit

Agron Hoxha, Fadil Kyeziu

QRSHP - Prizren, QKMF – Prizren

Hyrje: Rajoni i Prizreni shtrihet në jugëperëndim të vendit ku përfshin komunat e Prizrenit, Suharekës, Dragashit dhe Mamushës. Sipas regjistrimit të popullsisë për vitin 2024 nga ASK, ky rajon ka 227,154 banorë, ndërsa komuna me numrin më të madh të banorëve është Prizreni (me 147,428 banorë). Rajoni i Prizrenit kufizohet me Gjakovë, Klinë, Drenas, Shtërpce, Shtime, Maqedoni, Shqipëri, Klima vjetore mesatare është 12.6 shkallë celsius. Lartësia mbidetare më e larta 2000-meter e bjeshkëve të Sharit, ndërsa me e ulta në Vermicë 270 meter lartësi mbidetare. Lumi rrjedhës Lumbardhi i cili kalon nëpërmjedis të qytetit të Prizrenit, derdhet në lumin Drini në Vermicë të Prizrenit me pastaj vazhdon dhe bashkohet në Kukës me Drinin e zi dhe derdhet në lumin Buna tutje në det. Në kujdesin shëndetësor të popullsisë në këtë rajon, janë të organizuara Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare, të cilat ofrojnë kujdes parësor, ndërsa vepron edhe Spitali i Përgjithshëm Rajonal, i cili ofron shërbime të kujdesit dytësor. Qendra IRSHP në Prizren ofron shërbime dhe kujdes shëndetësor publik në nivel të të gjithë rajonit.

Qëllimi: Hulumtimi dhe vlerësimi i karakteristikave të profilit shëndetësorë në rajonin e Prizrenit

Materiali dhe metodat: Si material janë shfrytëzuar të dhënat nga Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës dhe sistemit shëndetësor 2023 si dhe Raportet Vjetore të Aktiviteteve Edukativo - Shëndetësore të realizuara në Rajonin e Prizrenit.

Rezultatet: Problemet shëndetësore dhe socio ekonomike, kushtet socio ekonomike të dobëta, mungesa e ligjit për sigurime shëndetësore dhe pensionale

Për mbrotje më të mirë shëndetësore është së pari zbatimi i ligjit për sigurime shëndetësore dhe pensionale, që do të ndikonte në furnizimin dhe kontrollin e rregullt të barnave dhe kontraktim të shërbimeve shëndetësore. Dhe me kete edhe permirsimin direkt e gjendjes shendetsore te popullates ne pergjithesi ne Rajonin e Prizrenit.

Në këtë rajon janë të organizuara 5 Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare, me rreth 47 Qendra të Mjekësisë Familjare. Rreth 191 mjekë të familjes dhe të përgjithshëm punojnë në këto qendra.

Përfundimi: Të përmirësohet mirëqenia e qytetarit duke krijuar vende të punës sigurim shendetsor dhe pensional.

Fjalë kyçe: shëndeti, profili shëndetësor, mjekësia familjare, ligjet, instituti

Health profile of the Prizren Region

Agron Hoxha, Fadil Kyeziu

RCPH – Prizren, MFMC – Prizren

Introduction: The region of Prizren lies in the southwest of the country and includes the municipalities of Prizren, Suhareka, Malisheva, Dragash and Mamusha. According to the 2024 population census by KAS, this region has 227,154 inhabitants (2024), while the municipality with the largest number of inhabitants is Prizren (with 147,428 inhabitants (2024)). The altitude in this region lies between 270 m and 2000 m. The average annual climate is around 12.60C. In this region, we have flows of rivers such as Lumbardhi, Toplluha and Drini, which flow into the Adriatic Sea. In the health care of the population in this region, the Main Centers of Family Medicine are organized, which offer primary care, while the Regional General Hospital also operates, which offers secondary care services. IRSHP Center in Prizren provides services and public health care at the level of the entire region.

Aim: The purpose of this paper was to research and evaluate the characteristics of the health profile in the Prizren Region.

Method: For the realization of the purpose of this research, we used the data from the Analysis of the population's health status and the health system 2023, as well as the Annual Reports of Educational - Health Activities carried out by the Regional Institute of Public Health in Prizren.

Results: Health and socio-economic problems, poor socio-economic conditions, and lack of health insurance and pension law have made the health situation in this region of the country difficult. For better health protection, full implementation of the health law and the law on health insurance and pensions is required.

in this region are organized 5 Main Family Medicine Centers, with about 44 Family Medicine Centers. About 183 family and general doctors work in these centers.

Conclusions: To improve the well-being of citizens, the organization, systematization of health services, and the construction of health insurance are essential.

Key words: health, health profile, family medicine, laws, institute

Profili shëndetësor i Rajonit të Pejës

Lendita Krasniqi¹, Adnora Nurboja¹, Fuat Dervishaj¹, Albina Vrella¹, Elvane Krasniqi^{2}, Art Nurboja³*

Lendita.Y.Krasniqi@rks-gov.net

- ^{1.} *Qendra Rajonale e Shëndetit Publik -Pejë*
- ^{2.} *Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare –Pejë*
- ^{3.} *Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.*

Abstrakt

Hyrje: Rajoni i Pejës, një nga rajonet kryesore në pjesën Veri-Perëndimore të Kosovës, përfshin pesë komuna: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan, me gjithsej 178,742 banorë. Rajoni ka përjetuar një rënie të popullsisë prej 45.968 banorësh krahasuar me vitin 2015, duke reflektuar sfida në aspektin e shëndetit dhe zhvillimit të rajonit.

Qëllimi: Ky punim synon të analizojë indikatorët shëndetësorë dhe aktivitetet edukativo-shëndetësore në Rajonin e Pejës.

Materiali dhe Metodat: Përdoren të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, analiza e gjendjes shëndetësore dhe raportet vjetore të aktiviteteve edukativo-shëndetësore të vitit 2023. Aktivitetet e analizuara përfshijnë takimet, ligjëratat dhe fushatat për edukimin dhe promovimin e shëndetit.

Rezultatet: Realizimi i 12 takime të KESH-it, 162 ligjëratat dhe 8 fushata për sensibilizimin e popullsisë. Aktivitetet kanë pasur mbështetje nga institucione si QKMF, Drejtoritë Komunale të Arsimit, Shëndetësisë dhe Rinisë, Kryqi i Kuq, OJQ dhe mediat lokale. Pjesëmarrësit në këto aktivitete kanë qenë 9,040 individë dhe janë shpërndarë 8,830 lifleta dhe 600 broshura.

Konkluzion: Rajoni i Pejës ka një sistem shëndetësor të mirëpajisur me QRSHP, QKMF, QMF dhe ambulanca që ofrojnë mbështetje të rëndësishme për shëndetin e popullsisë. Aktivitetet edukativo-shëndetësore kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e kushteve shëndetësore, megjithatë, nevojitet intensifikimi i përpjekjeve për të adresuar sfidat e ndryshme të shëndetit publik, veçanërisht në zonat më të izoluara.

Fjalët kyçe: Rajoni i Pejës, indikatorët shëndetësorë, aktivitetet edukativo-shëndetësore, shëndeti publik.

Health Profile of the Peja Region

Lendita Krasniqi¹, Adnora Nurboja¹, Fuat Dervishaj¹, Albina Vrella¹, Elvane Krasniqi^{2}, Art Nurboja³*

Lendita.Y.Krasniqi@rks-gov.net

^{1.} Regional Institute of Public Health Peja

^{2.} Main Family Health Centre – Peja

^{3.} National Institute of Public Health of Kosovo

Abstract

Introduction: The Peja Region, located in the northwestern part of Kosovo, includes the municipalities of Peja, Istog, Klina, Junik, and Deçan, with a total population of 178,742 in 2023. Compared to 2015, the region has experienced a population decrease of 45,968 inhabitants, highlighting ongoing demographic and public health challenges.

Objective: This paper aims to present the main health indicators and health education and promotion activities conducted in the Peja Region, offering an overview of the current public health situation and community engagement efforts.

Materials and Methods: The analysis is based on official data from the Kosovo Agency of Statistics, health status reports from the NIPHK, and annual reports on health education and promotion activities for 2023.

Results: A total of 12 Health Education Committee (HEC) meetings, 162 lectures, and 8 awareness campaigns were held, engaging 9,040 participants. In total, 8,830 leaflets, 600 brochures, and other educational materials were distributed. These activities were supported by local institutions and partner organizations, including MFCs, municipal directorates, the Red Cross, NGOs, and local media.

Conclusion: The Peja Region has a well-organized health infrastructure. However, demographic shifts and public health disparities call for sustained efforts and intensified outreach, particularly in more remote areas. Health education activities have proven effective but require continuous support to improve population health outcomes.

Keywords: Peja Region, health indicators, health education, public health.

Profili Shëndetësor i Rajonit të Gjakovës

Shkelzen Kurtaj¹, Safete Kamberi¹, Leonora Hoxha², Lavdije Pozhegu², Elbunit Kryeziu³

¹Qendra Rajonale e Shëndetit Publik – Gjakovë,

²Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Gjakovë

³Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Rahovec

shkelzen.kurtaj@rks-gov.net

Abstrakt

Hyrje: Rajoni i Gjakovës përbëhet nga Komunitet: Gjakovë dhe Rahovec dhe gjendet në pjesën jugperëndimore të Kosovës. Me sipërfaqe prej 862.41 km² ose 7.9 % të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës, me 151,095 banorë ose 8.4% banorë në krahasim me numrin e përgjithshëm të banorëve të Kosovës. Kufizohet me rajonin e Prizrenit, me rajonin e Pejës dhe me Republikën e Shqipërisë me të cilën ka dy pika kufitare atë të Qafë Prushit dhe të Qafë Morinës. Me lartësi mbidetare rreth 380 m. Qyteti i Gjakovës ka 88 fshatra dhe Rahoveci me 36.

Qëllimi: Ky punim synon të hulumtojë dhe analizojë Indikatorët Shëndetësorë dhe Aktivitetet edukativo - shëndetësore në Rajonin e Gjakovës.

Materiali dhe Metodati: Janë shfrytëzuar të dhënat nga Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës dhe Sistemit Shëndetësor 2023 si dhe Raportet Vjetore të Aktiviteteve Edukativo - Shëndetësore 2023 të realizuara në Rajonin e Gjakovës.

Rezultatet: Mbrojtja shëndetësore në Institucione publike realizohet përmes: KPSH (2 QKMF, 17 QMF, 19 AMF), KDSH (Spitali i përgjithshëm Rajonal “Isa Grezda” dhe QSHMB), dhe KTSH (QRSHP dhe QKMP). Në nivel Rajoni janë 42 Institucione Publike Shëndetësore ose 8.5% në nivel të Kosovës. Institucione Private Shëndetësore jo spitalore janë 163 ose 7.8% në nivel të Kosovës dhe Institucione private shëndetësore spitalore 2 ose 6.5% në nivel të Kosovës.

Numri i punëtorve shëndetësor dhe joshëndetësor në Institucione Shëndetësore është 1202 ose 8.7% në nivel të Kosovës. Prej tyre 227 Mjek, 724 Infemier, 51 Stomatolog, 3 Farmacist, 10 bashkëpunëtor shëndetësor dhe 187 punëtorë joshëndetësor. Janë realizuar 12 takime të KESH-it, 150 ligjërata dhe 8 fushata për sensibilizimin e popullsisë. Aktivitet janë zhvilluar nga anëtarët e Komisionit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në nivel të Rajonit dhe nga Mjek dhe Infemierë nga KPSH. Pjesëmarrësit në këto aktivitete kanë qenë 8200 persona dhe janë shpërndarë 8000 lifleta dhe 500 tjera material edukativo shëndetësorë (broshura, postera, maica, butona, lapsa). Aktivitetet kanë pasur mbështetje nga Institucionet si: IKSHPK, QRSHP, Drejtoritë Komunale të Shëndetësisë dhe Arsimit të Rajonit, OJQ (AQH) dhe mediat lokale.

Konkluzion: Rajoni i Gjakovës ka një Sistem Shëndetësor Publik që është i organizuar në tri nivele: Kujdesi Parësor, Dytësor dhe Tretësor shëndetësor, që ofrojnë mbrojtje shëndetësore të popullsisë. Aktivitetet edukativo-shëndetësore kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive edukativo shëndetësore, por kërkojnë mbështetje të vazhdueshme për të përmirësuar rezultatet e shëndetit të popullatës. Nevojitet intensifikimi i përpjekjeve për të adresuar sfidat e ndryshme të Shëndetit Publik.

Fjalët kyçe: Rajoni i Gjakovës, Indikatorët Shëndetësor, Aktivitetet Edukativo - Shëndetësore, Shëndeti Publik.

Health Profile of the Gjakova Region

Shkelzen Kurtaj¹, Safete Kamberi¹, Leonora Hoxha², Lavdiye Pozhegu², Elbunit Kryeziu³

¹Regional Institute of Public Health – Gjakova,

²Main Family Health Centre – Gjakova

³Main Family Health Centre – Rahovec

shkelzen kurtaj@rks-gov.net

Abstract

Introduction: The Gjakova Region consists of the Municipalities: Gjakova and Rahovec and is located in the southwestern part of Kosovo. With an area of 862.41 km² or 7.9% of the total area of Kosovo, with 151,095 inhabitants or 8.4% inhabitants compared to the total number of inhabitants of Kosovo. It borders the Prizren region, the Peja region and the Republic of Albania with which it has two border points, that of the Prushi Pass and the Morina Pass. With an altitude of about 380 m. The city of Gjakova has 88 villages and Rahovec with 36.

Purpose: This paper aims to research and analyze Health Indicators and educational-health activities in the Gjakova Region.

Material and Methods: Data from the Analysis of the Health Status of the population and the Health System 2023 and the Annual Reports of Educational and Health Activities 2023 carried out in the Gjakova Region were used.

Results: Health protection in public Institutions is carried out through: PHC (2 MFMC, 17 FMC, 19 MA), SHC (Regional General Hospital “Isa Grezda” and CMHC), and THC (RPHC and NCOM). At the Regional level there are 42 Public Health Institutions or 8.5% at the level of Kosovo. Private non-hospital Health Institutions are 163 or 7.8% at the level of Kosovo and 2 private hospital Health Institutions or 6.5% at the level of Kosovo. The number of health and non-health workers in Health Institutions is 1202 or 8.7% at the Kosovo level. Of these 227 are Doctors, 724 Nurses, 51 Dentists, 3 Pharmacists, 10 healthcare associates and 187 non-healthcare workers. A total of 12 Health Education Committee (HEC) meetings, 150 lectures and 8 campaigns for population awareness have been carried out. Activities have been carried out by members of the Commission for Health Education and Promotion at the regional level and by a Doctor and Nurse from the PHC. Participants in these activities were 8200 people and 8000 leaflets and 500 other health educational materials (brochures, posters, T-shirts, buttons, pencils) were distributed.

The activities have had support from Institutions such as: NIPH, RPHC, Municipal Directorates of Health and Education of the region, NGOs (AQH) and local media.

Conclusion: The Gjakova Region has a Public Health system that is organized in three levels: Primary, Secondary and Tertiary Health Care, that provide health protection to the population. Health education activities have contributed to increasing health education awareness and knowledge, but require continued support to improve population health outcomes. Efforts need to be intensified to address the various challenges of Public Health.

Keywords: Gjakova Region, Health Indicators, Health Education Activities, Public Health.

Profili shëndetësor i rajonit të Gjilanit

Igballe Shalaku

Qendra Rajonale e Shëndetit Publik Gjilan

Abstrakt

Hyrje: Rajoni i Gjilanit gjendet në jug-lindje të Kosovës, njihet si rajon në të cilin në të kaluarën është kultivuar gruri e duhani, pastaj është zhvilluar industria e tekstilit, radiatorëve, baterive dhe qeramikës, po ashtu njihet edhe për banjën e Kllokotit që është ndër banjat më të vizituara në Kosovë.

Nga të dhënat statistikore vitale për rajonin e Gjilanit, vërehet një mesatare e ulët e natalitetit krahasuar me mesataren në Kosovë. Niveli ulët i natalitetit në komunat me shumicë serbe ka ndikuar që mesatarja për rajon të jetë e ulët. Mortaliteti për vitin 2023 pësuar ngritje në krahasim me vitin paraprak, që ndërlidhet me pandeminë COVID-19.

Rajoni i Gjilanit ka: KPSH të përbërë nga QKMF-të, dhe AMF-të, Spitalin e përgjithshëm Rajonal, QRSHP, Qendra e Shëndetit Mendor. Gjatë vitit 2023 në rajonin e Gjilanit, sa i përket situatës epidemiologjike janë raportuar 26563 raste të sëmundjeve ngjitëse.

Monitorimi i ujit nga shërbimi i Ekologjisë Humane është bërë në Ujësjellësin e Gjilanit, gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 janë punuar gjithsej 1234 rutina.

Prej sëmundjeve respiratore dhe kardiovaskulare jemi fokusuar në sëmundjet të cilat direkt kanë lidhshmëri me aerodotjen: Influenza, sëmundjet obstruktive respiratore, bronhiti kronik, tensioni arterial, angina pectoris dhe cardiomyopatia.

Me qëllim të kontrollimit të standardeve higjieno-sanitare dhe përcaktimit të ndotësve bakteriologjik në SRGj janë bërë vizita dhe janë marrë strisho. Mbikqyrja higjieno-sanitare në institucione shkollore dhe parashkollore. Gjatë vitit 2023 në laborator janë kryer gjithsej 26405 analiza dhe ekzaminime të ndryshme.

Për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore të popullatës duhet:

- Të implementohet ligji për sigurime shëndetësore.
- Të rritet numri i personelit shëndetësor.
- Të rritet bashkëpunimi i institucioneve me organizata të ndryshme me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve në përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës.
- Përmirësimi dhe mirëmbajtja e ambientit.

Health Profile of the Gjilan Region

Igballe Shalaku

Regional Center for Public Health Gjilan

Abstract

Introduction: The region of Gjilan is located in the south-east of Kosovo, it is known as a region where wheat and tobacco have been cultivated, then there is the textile industry of radiators, batteries and ceramics, it is also known for the bath of Klllokot, which is among the baths most visited in Kosovo.

From the vital statistical data for the region of Gjilan, a low average birth rate is observed compared to the average in Kosovo. The low birth rate in municipalities with a Serbian majority has influenced the average of the region to be low. Mortality for 2023 has increased compared to the previous year, which is related to the COVID-19 pandemic.

The region of Gjilan has: PHC composed of MFMC and MFA, Regional General Hospital, QRSHP, Mental Health Center - During 2023 in the region of Gjilan, as far as the epidemiological situation is concerned, 26563 cases of infectious diseases

Water monitoring by the Human Ecology service was done in the Gjilan Waterworks, during the period January-December 2023 total of 1234 routines were worked.

From respiratory and cardiovascular diseases, we have focused on diseases that are directly related to air pollution: Influenza, obstructive respiratory diseases, chronic bronchitis, arterial tension, angina pectoris and cardiomyopathy.

In order to check the hygiene and sanitary standards and determine the bacteriological pollutants in the Regional Hospital of Gjilan, visits were made and swab tests were taken. Hygienic-sanitary supervision in school and preschool institutions. During the year 2023, a total of 26.405 different analyzes and examinations were performed in this laboratory.

In order to improve the general health condition of the population, it is necessary to:

- Implement the law on health insurance.
- To increase the number of health personnel.
- To increase the cooperation of institutions with different organizations in order to coordinate activities in improving the health status of the population.
- Improvement and maintenance of the environment.
-

Profili shëndetësor në Rajonin e Mitrovicës

Nekibe Hyseni, Nysret Ymeri.

Kontribuan: Fahri Shabani, Fevzi Sylejmani, Teuta Fejza, Shaqir Ibrahim, Skender Ahmeti, Naile Xhaka, Adlije Shaqiri, Fisnik Kamberi, Ilir Havolli, Fatmir Osmani, Bashkim Meha.

Institucioni: Qendra Rajonale e Shëndetit Publik, Mitrovicë.

Hyrje: Rajoni i Mitrovicës përfaqëson një zonë të rëndësishme të Kosovës si në aspektin strategjik ashtu edhe në atë kulturor, socioekonomik dhe shëndetësor. Monitorimi i gjendjes shëndetësore të popullatës, i kombinuar me vlerësimin e faktorëve natyror dhe mjedisorë, është thelbësor për hartimin e politikave efikase dhe përmirësimin e shërbimeve publike në këtë rajon.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë gjendjen shëndetësore të popullatës dhe të shqyrtojë faktorët ndikues në shëndetin e popullatës për Rajonin e Mitrovicës viti 2023. Po ashtu synon të vlerësojë performancën e institucioneve shëndetësore dhe sfidat me të cilat ato përballen.

Materiali dhe Metodat: Janë analizuar të dhëna të mbledhura nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Qendra e Statistikave Shëndetësore në IKSHPK, Raportet: DKSH, QKMF, QRSHP-Departamentet Epidemiologji, Ekologjini humane, Promovim dhe Edukim Shëndetësor.

U analizuan tregues si nataliteti, mortaliteti, incidenca e sëmundjeve ngjitëse, numri i vizitave në QKMF, kapaciteti i kuadrit profesional, si dhe shërbimet spitalore dhe radiologjike. Janë përfshirë edhe të dhëna për qasjen në ujë të pijshëm, ndotjen e ajrit dhe ujërave sipërfaqësorë, menaxhimin e mbeturinave, hapësirat e gjelbra dhe objektet sportive.

Rezultatet: Gjetjet tregojnë për përmirësime të lehta në disa indikatorë të shëndetit publik, krahasuar me vitet paraprake, përfshirë një rritje të qasjes në shërbimet shëndetësore dhe përmirësime në edukimin shëndetësor. Megjithatë, sfida të mëdha mbeten në infrastrukturën shëndetësore, numrin e stafit të specializuar dhe ndikimin negativ të faktorëve mjedisorë, sidomos ndotjes së ajrit dhe menaxhimit të mbeturinave.

Përfundimi: Për të përmirësuar gjendjen shëndetësore të popullatës në Mitrovicë, kërkohet një qasje e koordinuar mes institucioneve shëndetësore dhe atyre mjedisore. Nevojitet investim i mëtijshëm në infrastrukturë, rritje e kapaciteteve njerëzore dhe përfshirje më aktive e komunitetit në proceset edukative dhe vendimmarrëse. Përdorimi i të dhënave statistikore në planifikimin shëndetësor është kyç për arritjen e qëndrueshmërisë në këtë sektor.

Fjalë kyçe: Mitrovicë, shëndet publik, sistem shëndetësor, analiza statistikore.

Health Profile in the Mitrovica Region

Nekibe Hyseni, Nysret Ymeri

Contributors: Fahri Shabani, Fevzi Sylejmani, Teuta Fejza, Shaqir Ibrahim, Skender Ahmeti, Naile Xhaka, Adlije Shaqiri, Fisnik Kamberi, Ilir Havolli, Fatmir Osmani, Bashkim Meha

Institution: Regional Center of Public Health, Mitrovica

Introduction: The Mitrovica region represents a key area of Kosovo, both strategically and in terms of its cultural, socio-economic, and health-related importance. Monitoring the health status of the population, combined with the assessment of environmental and natural factors, is essential for developing effective policies and improving public services in the region.

Objective: The objective of this paper is to analyze the health status of the population and examine the factors influencing public health in the Mitrovica Region for the year 2023. It also aims to evaluate the performance of healthcare institutions and the challenges they face.

Materials and Methods: The analysis is based on data collected from the Kosovo Agency of Statistics, the Health Statistics Center at the National Institute of Public Health of Kosovo (NIPHK), and reports from: the Directorate of Health and Social Welfare (DHSW), Family Medicine Centers (FMC), and the Regional Center of Public Health (RCPH) - particularly the departments of Epidemiology, Human Ecology, and Health Promotion and Education. Indicators analyzed include birth and death rates, incidence of infectious diseases, number of visits to FMCs, availability of specialized medical staff, and hospital and radiology services. The study also includes data on access to drinking water, air and surface water pollution, waste management, green spaces, and sports facilities.

Results: The findings indicate slight improvements in certain public health indicators compared to previous years, including increased access to health services and advancements in health education. However, major challenges persist in healthcare infrastructure, the number of specialized personnel, and the negative impact of environmental factors—particularly air pollution and inadequate waste management.

Conclusion: Improving the health status of the population in Mitrovica requires a coordinated approach between health and environmental institutions. Further investment in infrastructure, enhancement of human resources, and more active community involvement in educational and decision-making processes are necessary. The use of statistical data in health planning is key to achieving sustainability in this sector.

Keywords: Mitrovica, public health, healthcare system, statistical analysis

Profili shëndetësor i Rajonit të Ferizajt

Florie Miftari Basholli^{1,2}, Merita Berisha^{1,2}, Sevdie Spahiu^{1,2}, Mejreme Bajçinovci^{1,2}, Sebahate Pacolli Krasniqi^{1,2}, Lejlifere Shabanaj Krasniqi², Sevdie Mehmeti³, Lumnie Halimi³, Diana Jerliu

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti Hasan Prishtina, Prishtinë, Kosovë

² Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, Prishtinë, Kosovë

³ Qendra Rajonale e Shëndetësisë Publike, Ferizaj, Kosovë

Hyrje

Rajoni i Ferizajt, që përfshin pesë komuna, është një zonë me rëndësi strategjike në jug të Kosovës. Ky profil shëndetësor analizon gjendjen e shëndetit publik për vitin 2023, me fokus në resurset humane, indikatorët demografikë dhe ngarkesën nga sëmundjet jo ngjitëse.

Qëllimi

Qëllimi i këtij studimi është të paraqesë një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes shëndetësore në rajon, duke identifikuar sfidat dhe resurset ekzistuese për përmirësimin e sistemit shëndetësor.

Metodologjia

Të dhënat janë mbledhur nga raportet zyrtare të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2023. Të dhënat e analizuar janë të dhënat për resurset humane, indikatorët demografikë, të mbulimit, vëllimit dhe aktivitetet e promovimit shëndetësor.

Rezultatet

Në vitin 2023, rajoni kishte 1,197 profesionistë shëndetësorë, të sistemuar në tri nivelet e kujdesit shëndetësor. Mortaliteti ishte 5.7‰ nataliteti 13.5‰, në spitalin rajonal mjekimi mesatar ishte 3.7 ditë, shfrytëzimi i kapacitetit spitalor 60.3%, shtrime/mjekë (ngarkesa ditore) 0.9, shtrime/infermierë (ngarkesa ditore) 0.5, operacione/mjek 7.4, kurse mortaliteti spitalor ishte 10.3‰. Komuna e Ferizajt kishte përqindjen më të lartë të profesionistëve shëndetësor dhe të rasteve të paraqitura të sëmundjeve kronike jongjitëse. Aktivitetet e edukimit shëndetësor kanë përfshirë ligjërata edukativo shëndetësore dhe shpërndarje të materialeve në komunitet.

Përfundim

Rajoni i Ferizajt ka potencial për përmirësim të mëtejshëm të shërbimeve shëndetësore përmes fuqizimit të resurseve humane dhe shtimit të aktiviteteve të edukimit shëndetësor.

Fjalët kyçe: Ferizaj, kujdesi shëndetësor, indikatorë demografikë, edukim shëndetësor.

Health profile of Ferizaj Region

Authors: Florie Miftari Basholli^{1,2}, Merita Berisha^{1,2}, Sevdie Spahiu^{1,2}, Mejreme Bajçinovci^{1,2}, Sebahate Pacolli Krasniqi^{1,2}, Lejlifere Shabanaj Krasniqi², Sevdie Mehmeti³, Lumnie Halimi³, Diana Jerliu

¹ Faculty of Medicine, Hasan Prishtina University, Prishtina, Kosovo

² National Institute of Public Health of Kosovo, Prishtina, Kosovo

³ Regional Center for Public Health, Ferizaj, Kosovo

Introduction

The Ferizaj region, comprising of five municipalities, is a strategically important area in southern Kosovo. This health profile analyzes the public health situation in 2023, focusing on human resources, demographic indicators, and the burden of non-communicable diseases.

Objective

The objective of this study is to present a general overview of the health status in the region, identifying existing challenges and resources for improving the healthcare system.

Methodology

Data were collected from official reports of the National Institute of Public Health of Kosovo (NIPHK) and the Kosovo Agency of Statistics (KAS) for the year 2023. The analyzed data include human resources, demographic indicators, coverage and service capacity indicators, health promotion activities.

Results

In 2023, the region had employed 1,197 healthcare professionals across the three levels of healthcare. The mortality rate was 5.7‰, while the birth rate was 13.5‰, average treatment in the regional hospital was 3.7 days, hospital capacity utilization 60.3%, hospitalizations/doctor (daily workload) 0.9, hospitalizations/nurses (daily workload) 0.5, surgeries/doctor 7.4, while hospital mortality was 10.3‰. The municipality of Ferizaj had the highest percentage of healthcare professionals and reported cases of non-communicable chronic diseases. Health education activities included educational lectures and the distribution of informational materials in the community.

Conclusion

The Ferizaj region has potential for further improvement of healthcare services through the strengthening of human resources and increased health education efforts.

Keywords: Ferizaj, healthcare, demographic indicators, health education.

- II -

Ngritja e kapaciteteve dhe bashkëpunimi ndërsektoral

Capacity building and Cross-sectorial collaboration

Ndikimi i trajnimit të komunikimit shëndetësor në kënaqshmërinë e pacientëve me shërbimet shëndetësore në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

Valbona Zhjeki^{1,2}, Rina Hoxha^{1,2}, Merita Berisha^{1,2}, Diellza Thaçi Bacaj^{1,2}, Pranvera Krasniqi^{1,2}, Florie Miftari Basholli^{1,2}, Sevdie Spahiu^{1,2}

¹Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti Hasan Prishtina, Prishtinë, Kosovë 10000

²Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, Prishtinë, Kosovë 10000

Hyrje: Aftësitë e komunikimit janë elementë kyç për shërbimet cilësore të kujdesit shëndetësor.

Qëllimi: Vlerësimi i kënaqësisë së pacientëve me shërbimet shëndetësore të ofruara në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK) në lidhje me çështjet e komunikimit para dhe pas trajnimit të aftësive të komunikimit për personelin.

Metodat: Ky është një studim sasior, longitudinal, ku të dhënat mbi kënaqshmërinë e pacientëve u mbledhën në dy pika kohore, para zbatimit të trajnimit të komunikimit (2018) dhe pas përfundimit të trajnimit (2022).

Pacientët mbi 18 vjeç u përzgjedhën radhazi pasi ata morën shërbimet në institucion, dhe të gjithë dhanë pëlqimin e tyre për të marrë pjesë në studim.

Rezultatet: Në studimin tonë, vlerësohen efikasiteti, komunikimi ndërpersonal pacient-ofrues i shërbimit shëndetësor, shpjegimet në lidhje me procedurat dhe gatishmëria për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve.

Krahasimi i rezultateve të kënaqësisë së pacientëve gjatë dy viteve zbuloi një përmirësim të ndjeshëm në kënaqshmërinë lidhur me komunikimin ($p < 0.000$), pas zbatimit të ndërhyrjeve trajnuese, duke sugjeruar që edhe trajnimi i shkurtër dhe i fokusuar mund të sjellë përmirësime kuptimplote në përvojën e pacientit.

Përfundimi: Ky studim ofron prova empirike që mbështesin ndikimin pozitiv të trajnimit të aftësive të komunikimit për stafin e kujdesit shëndetësor në kënaqshmërinë e pacientit.

Rezultatet sugjerojnë që trajnimi i komunikimit duhet të konsiderohet një përparësi strategjike brenda organizatave të kujdesit shëndetësor.

Fjalë kyçe: Kënaqshmëria e pacientit, trajnimi i aftësive komunikuese, cilësia e kujdesit, shërbimet shëndetësore.

Health communication training impact on patients' satisfaction with health services at the National Institute of Public Health of Kosova

Valbona Zhjeqi^{1,2}, Rina Hoxha^{1,2}, Merita Berisha^{1,2}, Diellza Thaçi Bacaj^{1,2}, Pranvera Krasniqi^{1,2}, Florie Miftari Basholli^{1,2}, Sevdie Spahiu^{1,2}

¹Faculty of Medicine, Hasan Prishtina University, Prishtina City, Kosova 10000

²National Institute of Public Health of Kosova, Pristina City, Kosova 10000

Introduction: Communication skills are key elements for qualitative health care services.

Purpose: Assess patient satisfaction with the health services provided in the National Institute of Public Health of Kosovo (NIPHK) related to communication issues before and after communication skills training for staff members.

Methods: This was a quantitative, longitudinal study using a repeated cross-sectional design. Data on patient satisfaction were collected at two time points, before the implementation of communication training (2018) and after the training was completed (2022).

Patients over 18 years old, were selected consecutively as they accessed services at the institution, and all of them provided their consent to participate in the study.

Results: In our study, efficacy, patient-provider interpersonal communication, explanations regarding procedures and readiness to answer to patients' needs are valued. The comparison of patient satisfaction scores across two years revealed a significant improvement in communication-related satisfaction ($p < 0.000$), after the implementation of training interventions, suggesting that even brief and focused training can produce meaningful, enhancements in patient experience.

Conclusion: This study provides empirical evidence supporting the positive impact of communication skills training for healthcare staff on patient satisfaction. The results suggest that communication training should be considered a strategic priority within healthcare organizations.

Keywords: Patient satisfaction, communication skills training, quality of care, health services.

Roli i Ministrisë së Shëndetësisë në Edukimin dhe Promovimin e Shëndetit -Një Qasje Politikëbërëse

Niman Bardhi¹, Naim Bardiqi¹, Besa Balidemaj¹, Ragip Hyseni¹, Ariana Qerimi¹, Adelina Lenjani¹

¹Ministria e Shëndetësisë e Kosovës

Abstrakt

Hyrje: Edukimi dhe promovimi i shëndetit janë komponentë thelbësorë të sistemit të shëndetit publik. Si institucion politikëbërës, Ministria e Shëndetësisë ka përgjegjësi kyçe në zhvillimin e politikave dhe ndërhyrjeve që ndikojnë drejtpërdrejt në sjelljet dhe mirëqenien e popullatës.

Qëllimi: Në këtë punim synojmë të paraqesim rolin shumëdimensional të Ministrisë së Shëndetësisë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave për edukimin dhe promovimin e shëndetit në nivel kombëtar.

Metodologjia: Hulumtim cilësor, analitik i bazuar në dokumente strategjike, legjislaion kombëtar dhe udhëzime të organizatave ndërkombëtare, duke shqyrtuar praktikën dhe qasjet politike të aplikuara nga Ministria.

Rezultatet: Ministria e Shëndetësisë vepron në disa nivele të ndërhyrjes duke hartuar politika kombëtare për edukimin dhe promovimin e shëndetit; organizim të fushatave ndërgjegjësuëse për sëmundjet kronike, higjienën, vaksinimin dhe shëndetin mendor; mbështet integrimin e edukimit shëndetësor në shkollë dhe komunitet; rregullon dhe monitoron përmbajtjen e mesazheve shëndetësore, për të garantuar cilësinë dhe bazën shkencore të tyre dhe mbështet financiarisht organizatat që punojnë në fushën e edukimit dhe promovimit të shëndetit duke krijuar partneritete publike-private për të përhapur informacionin shëndetësor në mënyrë më efektive. Janë përmbledhur aktivitete dhe dokumente të krijuara nga Ministria në fushën e edukimit dhe promovimit shëndetësor.

Përfundime: Ministria e Shëndetësisë ka një rol thelbësor në ndërtimin e një kulture të shëndetit përmes politikave të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që ndërlidhen me edukim dhe promovim të shëndetit. Për të maksimizuar ndikimin, nevojitet bashkëpunim ndër sektorial, përfshirje e komunitetit dhe monitorim i vazhdueshëm i efektivitetit të ndërhyrjeve.

Fjalë kyçe: Ministria e Shëndetësisë, edukimi, promovimi, shëndeti.

The Role of the Ministry of Health in Health Education and Promotion - A Policy-Making Approach

Niman Bardhi¹, Naim Bardiqi¹, Besa Balidemaj¹, Ragip Hyseni¹, Ariana Qerimi¹, Adelina Lenjani¹

¹Ministry of Health of Kosovo

Abstract

Introduction: Health education and promotion are essential components of the public health system. As a policy-making institution, the Ministry of Health has key responsibilities in developing policies and interventions that directly affect the behaviors and well-being of the population.

Purpose: In this paper, we aim to present the multidimensional role of the Ministry of Health in the design, implementation and monitoring of policies for health education and promotion at the national level.

Methodology: Qualitative, analytical research based on strategic documents, national legislation and guidelines of international organizations, examining the practices and policy approaches applied by the Ministry.

Results: The Ministry of Health operates at several levels of intervention by drafting national policies for health education and promotion; organizing awareness campaigns on chronic diseases, hygiene, vaccination and mental health; supporting the integration of health education in schools and communities; regulating and monitoring the content of health messages to ensure their quality and scientific basis, and financially supporting organizations working in the field of health education and promotion by creating public-private partnerships to disseminate health information more effectively. Activities and documents created by the Ministry in the field of health education and promotion are summarized.

Conclusions: The Ministry of Health has a fundamental role in building a culture of health through sustainable and comprehensive policies related to health education and promotion. To maximize impact, cross-sectoral cooperation, community involvement and continuous monitoring of the effectiveness of interventions are needed.

Keywords: Ministry of Health, education, promotion, health.

Morbiditeti te të moshuarit mbi 65 vjeç në Kosovë gjatë viteve 2022–2023: Sfidat dhe domosdoshmëria e promovimit shëndetësor

Pranvera Krasniqi^{1,2}, Naim Jerliu^{1,2}, Merita Berisha^{1,2}, Valbona Zhjeki^{1,2}, Fatime Ukaj^{1,2}, Rina Hoxha^{1,2}, Myvedete Tërshnjaku¹, Mirë Linda Hatashi¹

1. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

2. Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

Abstrakt

Hyrje: Rritja e qëndrueshme e popullatës mbi moshën 65 vjeç në Kosovë reflekton një transformim të rëndësishëm demografik me pasoja të dukshme për sistemin shëndetësor dhe strukturën sociale të vendit.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë morbiditetin e grupmoshës 65+ gjatë viteve 2022–2023 dhe të evidentojë nevojat për ndërhyrje në edukimin dhe promovimin shëndetësor në këtë kategori.

Materiali dhe metodat: Të dhënat janë marrë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) dhe nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe duke u analizuar sipas grupmoshës, gjinisë, diagnozave dhe niveleve të kujdesit shëndetësor.

Rezultatet: Mbi 90% e rasteve të morbiditetit në këtë grupmoshë janë evidentuar në kujdesin parësor, me sëmundjet më të shpeshta që i përkasin grupeve: XXI Faktorët që ndikojnë në gjendjen shëndetësore dhe kontaktin me shërbime shëndetësore, IX Sëmundjeve të sistemit të qarkullimit të gjakut, X Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes dhe IV Çrregullimet Endokrine, të ushqyeshmërisë dhe metabolizmit. Diagnozatat më të shpeshta përfshijnë hipertensionin, diabetin, infeksionet respiratore dhe problemet gastrointestinale.

Përfundimi: Trendet e moshimit dhe sëmundshmëria e të moshuarve kërkon një qasje të integruar për përmirësimin e shëndetit të të moshuarve, me fokus të veçantë në edukimin shëndetësor, vetëmënxhimin e sëmundjeve kronike dhe fuqizimin e kujdesit parësor. Për më tepër, theksohet rëndësia e politikave shëndetësore proaktive dhe programeve të promovimit të stilit të shëndetshëm të jetesës për të zbutur barrën e sëmundshmërisë në këtë kategori të popullatës në rritje.

Fjalë kyçe: të moshuarit, morbiditeti, edukimi dhe promovimi shëndetësor

Morbidity Among Older Adults Aged 65+ in Kosovo During 2022–2023: Challenges and the Need of Health Promotion

Pranvera Krasniqi^{1,2}, Naim Jerliu^{1,2}, Merita Berisha^{1,2}, Valbona Zhjeki^{1,2}, Fatime Ukaj^{1,2}, Rina Hoxha^{1,2}, Myvedete Tërshnjaku¹, Mirëinda Hatashi¹

1. National institute of Public Health of Kosovo

2. Faculty of Medicine, University of Prishtina

Abstract

Introduction: The sustainable increase in the population over the age of 65 in Kosovo reflects a significant demographic transformation with noticeable consequences for the country's healthcare system and social structure. The aim of this paper is to analyze the morbidity of the 65+ age group during 2022–2023 and to highlight the needs for interventions in health education and promotion for this category.

Materials and Methods: The data was obtained from the National Institute of Public Health of Kosovo (NIPHK) and the Kosovo Agency of Statistics, analyzed by age group, gender, diagnoses, and healthcare levels.

Results: Over 90% of morbidity cases in this age group were identified in primary healthcare, with the most common diseases belonging to the following groups: XXI Factors influencing health status and contact with healthcare services, IX Diseases of the circulatory system, X Respiratory diseases, and IV Endocrine, nutritional, and metabolic disorders. The most frequent diagnoses include hypertension, diabetes, respiratory infections, and gastrointestinal health conditions.

Conclusion: The aging trends and morbidity of older adults require an integrated approach to improve their health, with a particular focus on health education, self-management of chronic diseases, and strengthening primary care. Furthermore, the importance of proactive health policies and programs promoting healthy lifestyles is emphasized to reduce the burden of morbidity in this growing population group.

Keywords: elderly, morbidity, health education and promotion

Qasja e integruar në kujdesin shëndetësor

*Zejnije A. Shala¹, Pranvera Krasniqi², Merita Shehu³, Luljeta Reçica¹, Florije Budakova¹,
Kimete Ratkoceri¹, Fahrije Gashi¹*

¹*QKMF- Lipjan*

²*National Institute of Public Health Kosovo, Prishtina, Kosovo*

³*Accessible Quality Healthcare Project, Prishtina, Kosovo*

Abstrakt

Hyryje: Qasja e integruar në kujdesin shëndetësor përfaqëson një model të avancuar organizimi dhe ofrimi të shërbimeve, që synon koordinimin ndërmjet niveleve të ndryshme të kujdesit shëndetësor dhe sektorëve të përfshirë. Ky model adreson nevojat komplekse të pacientëve, veçanërisht të atyre me sëmundje kronike, duke siguruar një trajtim më të plotë, të vazhdueshëm dhe të personalizuar.

Qëllimi i hulumtimit: Ky studim synon të analizojë ndikimin e qasjes së integruar në përmirësimin e cilësisë së kujdesit dhe qasjes në shërbime shëndetësore, me theks të veçantë tek grupet vulnerabël. Gjithashtu, hulumtimi synon të vlerësojë efektin e kësaj qasjeje në reduktimin e kostove, menaxhimin më të mirë të burimeve dhe identifikimin e barrierave që pengojnë zbatimin efektiv të saj.

Metodologjia: Ky hulumtim prospektiv vlerëson perceptimet e pacientëve mbi qasjen e integruar në kujdesin shëndetësor, duke përdorur pyetësorë të strukturuar me përgjigje nominale. Pjesëmarrësit përfshijnë 100 pacientë në QKMF Lipjan. Të dhënat janë mbledhur në Maj 2025 dhe përpunuar me SPSS dhe Excel, duke përdorur frekuenca, përqindje dhe testin χ^2 për analizën statistikore.

Rezultatet: Sipas të dhënave, shumica e individëve (46%) kanë marrë shërbime shëndetësore të integruara në mënyrë të rrallë, ndërsa 36% e të anketuarve kanë raportuar se i kanë marrë shpesh. Vetëm 4% e pjesëmarrësve kanë theksuar se kanë marrë këto shërbime shumë shpesh (pothuajse sa herë kanë vizituar mjekun apo kanë ardhur për vizitë në QKMF), ndërsa 12% e tyre kanë treguar një frekuencë të ndërmjetme, mes kategorive "shpesh" dhe "rrallëher". Një grup i vogël, përkatësisht 2% e pacientëve, nuk kanë marrë kurrë këto shërbime. Sipas testit χ^2 , dallimi në mes të përgjigjeve është shumë i rëndësishëm statistikisht ($p < 0.01$), duke treguar që rezultatet nuk janë të rastit.

Konkluzione: Hulumtimi tregon se shërbimet shëndetësore të integruara për pacientët me sëmundje kronike si diabeti dhe hipertensioni janë shfrytëzuar rrallëher, me variacione të dukshme në përvojat e pacientëve. Kjo tregon barrierat në qasjen dhe përdorimin e shërbimeve. Testi χ^2 tregon një ndryshim të rëndësishëm në perceptimet e pacientëve, duke pasqyruar pasiguri në ofrimin e shërbimeve. Hulumtimi thekson nevojën për përmirësimin e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve për pacientët me sëmundje kronike.

Fjalë kyçe: qasje e integruar, kujdes shëndetësor, koordinim, sëmundje kronike, cilësi.

Integrated approach to healthcare

*Zejnije A. Shala¹, Pranvera Krasniqi², Merita Shehu³, Luljeta Reçica¹, Florije Budakova¹,
Kimete Ratkoceri¹, Fahrije Gashi¹*

¹QKMF- Lipjan

²National Institute of Public Health Kosovo, Prishtina, Kosovo

³ Accessible Quality Healthcare Project, Prishtina, Kosovo

Abstract

Introduction: The integrated approach in healthcare represents an advanced model of organizing and delivering services, aiming to coordinate across different levels of healthcare and involved sectors. This model addresses the complex needs of patients, especially those with chronic illnesses, by ensuring more comprehensive, continuous, and personalized care.

Purpose of the study: This study aims to analyze the impact of the integrated approach on improving the quality of care and access to healthcare services, with a special emphasis on vulnerable groups. Furthermore, the research seeks to assess the effect of this approach on cost reduction, better resource management, and the identification of barriers that hinder its effective implementation.

Methodology: This prospective study evaluates patients' perceptions of the integrated approach in healthcare, using structured questionnaires with nominal responses. The participants include 100 patients at the Family Medicine Center (QKMF) in Lipjan. Data were collected in May 2025 and processed using SPSS and Excel, employing frequencies, percentages, and the Chi-square (X^2) test for statistical analysis.

Results: According to the data, the majority of individuals (46%) have rarely received integrated healthcare services, while 36% reported receiving them often. Only 4% of participants stated they received such services very frequently (almost every time they visited the doctor or the center), while 12% reported a moderate frequency, between "often" and "rarely." A small group, 2% of individuals, reported never receiving these services. According to the Chi-square (X^2) test, the difference among the responses is statistically highly significant ($p < 0.01$), suggesting the results are not due to chance.

Conclusions: The study indicates that integrated healthcare services for patients with chronic conditions such as diabetes and hypertension have been rarely utilized, with notable variations in patient experiences. This suggests existing barriers in access and use of services. The Chi-square (X^2) test shows a significant difference in patient perceptions, reflecting uncertainty in service provision. The research highlights the need to improve access to and quality of services for patients with chronic diseases.

Keywords: integrated approach, healthcare, coordination, chronic disease, quality

Akreditimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor në Shqipëri

Phd . R Neza¹, MD V. Kamberi², ME Mirana Boriçi³

¹ *Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT*

¹ *Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, UBT*

² *Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë*

² *Kolegji Universitar "LOGOS"*

³ *Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë*

rozartanezaj312@gmail.com, vjollcakamberi@yahoo.com, miranaborici@yahoo.it

Abstrakt

Sfondi: Akreditimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor i referohet një procesi formal përmes të cilit organizatat e kujdesit shëndetësor vlerësohen dhe njihen për përmbushjen e standardeve të përcaktuara të cilësisë dhe sigurisë. Akreditimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor luan një rol kritik në sigurimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Akreditimi i institucioneve shëndetësore në Shqipëri është një përparësi strategjike në përpjekjet e vendit për të rritur cilësinë, sigurinë dhe përgjegjshmërinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Procesi i akreditimit është një komponent thelbësor i reformës së sistemit shëndetësor, që synon përafrimin e standardeve lokale të kujdesit shëndetësor me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Qëllimi: Ky punim shqyrton zhvillimin, zbatimin dhe ndikimin e sistemit të akreditimit në Shqipëri, me fokus në kuadrin e tij rregullator, strukturat institucionale dhe mekanizmat e përputhshmërisë. Ai thekson rolin e Ministrisë dhe Institucionit përgjegjës për Akreditimin e Institucioneve Shëndetësore.

Materiali dhe metodat: Ky është një studim deskriptiv analitik i cili bazohet në analizën e kuadrit rregullator dhe legjislativ në fuqi në Shqipëri si dhe të mjeteve dhe mekanizmave të përdorur për realizimin e procesit të akreditimit.

Rezultatet: Studimi gjithashtu analizon sfida të tilla si burimet e kufizuara, mungesa e trajnimit të vazhdueshëm profesional dhe rezistenca ndaj ndryshimit midis ofruesve të kujdesit shëndetësor. Pavarësisht këtyre pengesave, akreditimi ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së ofrimit të shërbimeve ndaj pacientëve. Akreditimi jo vetëm që promovon përmirësimin e vazhdueshëm brenda institucioneve të kujdesit shëndetësor, por shërben edhe si një mjet për rritjen e besimit publik dhe mbështetjen e llogaridhënies institucionale.

Përfundimi: Gjetjet nënvizojnë nevojën për angazhim të vazhdueshëm, nisma për ndërtimin e kapaciteteve dhe integrimin e akreditimit në politikat kombëtare shëndetësore për të siguruar efektivitet afatgjatë dhe besim në sistemin e kujdesit shëndetësor të Shqipërisë.

Fjalët kyçe: standartet e cilësisë akreditimi, kujdesi shëndetësor

Accreditation of healthcare institutions in Albania

Phd. R Nezaj¹, MD V. Kamberi², ME Mirana Boriçi³

¹Faculty of Medical Technical Sciences, UMT

¹Faculty of Biotechnology and Food, AUT

² University Hospital Center "Mother Teresa", Tirana

³ "LOGOS" University College

rozartanezaj312@gmail.com, vjollcakamberi@yahoo.com, miranaborici@yahoo.it

Abstract

Background: Accreditation of healthcare institutions refers to a formal process through which healthcare organizations are evaluated and recognized for meeting established standards of quality and safety. Accreditation of healthcare institutions plays a critical role in ensuring the quality and safety of healthcare services. The accreditation of health institutions in Albania is a strategic priority in the country's efforts to enhance the quality, safety, and accountability of healthcare services. The accreditation process is an essential component of health system reform, aimed at aligning local healthcare standards with international best practices.

Aim: This paper examines the development, implementation, and impact of the accreditation system in Albania, with a focus on its regulatory framework, institutional structures, and compliance mechanisms. It highlights the role of the Ministry of Health and Social Protection and the responsible institution for Accreditation of Health Care Institutions.

Material and methods: This is a descriptive-analytical study based on analyzing the regulatory framework and legislation in force in Albania, as well as the tools and mechanisms used to carry out the accreditation process of healthcare institutions.

Results: The study also analyzes challenges such as limited resources, lack of continuous professional training, and resistance to change among healthcare providers. Despite these barriers, accreditation has contributed to improved service delivery, enhanced patient safety, and greater accountability. The primary aim of healthcare accreditation is to ensure that institutions provide safe, high-quality care that meets the needs of patients and complies with national and international standards. Accreditation not only promotes continuous improvement within healthcare organizations but also serves as a tool for enhancing patient safety, increasing public trust, and supporting institutional accountability.

Conclusion: The findings underscore the need for sustained commitment, capacity-building initiatives, and integration of accreditation into national health policies to ensure long-term effectiveness and trust in Albania's healthcare system.

Keywords: quality standards, accreditation, healthcare

Promovimi dhe zhvillimi i shëndetit

*Sead Ahmetaj - Kosovo Bursa Cultural Center - Private Hayat Hospital,
seadahmetaj@hotmail.com*

Hyrje: Në shekullin në të cilin ndodhemi, mbrojtja shëndetësore dhe parandalimi i sëmundjeve kanë filluar të pranohen si një element i domosdoshëm në ofrimin e kujdesit shëndetësor për të gjitha vendet. Marrëdhiet midis shëndetit dhe një popullsie efikase dhe produktive ka bërë të nevojshme zhvillimin e politikave të reja shëndetësore. Epidemiologë, shkencëtarë socialë, edukatorë, politologë, ekonomistë, urbanistë dhe shkencëtarë kontribuon në perspektiva që ndriçojnë çdo aspekt të promovimit të shëndetit. Moshë, gjinia, faktorët socio-ekonomikë, gjendja shëndetësore, struktura e familjes, statusi i mbështetjes sociale mund të ndikojnë në zbatimin e sjelljeve mbrojtëse shëndetësore tek një individ.

Qëllimi: Objektivat kryesore të planeve kombëtare janë si ; mbajtja e shëndetshëm e individëve të gjitha moshave, mbrojtja e shëndetit të tyre, maksimizimi i shëndetit të individëve me sëmundje kronike dhe krijimi i një hapësire dhe mjedisi të shëndetshëm jetese. Megjithatë, gjatë gjithë procesit të zhvillimit të njerëzimit, këndvështrimi për konceptin e "Shëndetit" ka ndryshuar në çdo periudhë.

Materialet dhe metodat: Zhvillimet shkencore dhe teknologjike në fushën e mjekësisë kanë dhënë përparime të rëndësishme në trajtimin e sëmundjeve. Megjithatë, shihet gjithashtu se proceset e diagnostikimit dhe trajtimit shkaktojnë shpenzime të larta financiare. Shihet se sëmundjet e zakonshme dhe shkaqet e vdekjeve në botë dhe në Kosovë janë të ngjashme. Këto sëmundje janë sëmundjet kardiovaskulare, kanceri, diabeti dhe sëmundjet infektive. Duket se shkaqet e modifikueshme të këtyre sëmundjeve janë gjithashtu të ngjashme. Këto janë mangësitë ushqyese, përdorimi i duhanit, stresi dhe mungesa e aktivitetit fizik. Në këtë pikë, programet e promovimit të shëndetit zënë një vend të rëndësishëm në ofrimin e sjelljeve pozitive shëndetësore për individët, familjet dhe shoqërinë. Me këtë këndvështrim, shpenzimet e shpenzuara për trajtimin e sëmundjeve gjithashtu mund të ulen.

Baza e këtyre planeve janë;

- Të ndihmojë individët e të gjitha grupmoshave që të bëhen të shëndetshëm,
- Të optimizojë shëndetin në rastet e sëmundjeve/aftësisë kronike,
- Të krijojë një mjedis të shëndetshëm

Përfundimi: Për të arritur një qëllim, një individ ose grup duhet të vendosë dhe të arrijë të përmbushë nevojat. Prandaj, shëndeti nuk është qëllimi i jetës, por një burim për jetën e përditshme. Shëndeti është një koncept pozitiv që nxjerr në pah kapacitetet fizike krahas burimeve sociale dhe personale. Kushtet dhe burimet themelore për shëndetin janë: Paqja; Strehimi; Arsimi; Ushqimi; Të ardhurat; Një ekosistem stabil; Burimet e qëndrueshme.

Fjalët kyçe: Parandalimi i sëmundjeve, kujdesi shëndetësor, zhvillimet shkencore, shëndeti, ushqimi

Health Promotion and Development

*Sead Ahmetaj - Kosovo Bursa Cultural Center - Private Hayat Hospital
seadahmetaj@hotmail.com*

Introduction: In the century we are in, health protection and disease prevention have begun to be accepted as an indispensable element in the provision of health care for all countries. The relationship between health and an efficient and productive population has necessitated the development of new health policies. Epidemiologists, social scientists, educators, political scientists, economists, urban planners and scientists contribute perspectives that illuminate every aspect of health promotion. Age, gender, socio-economic factors, health status, family structure, social support status can influence the implementation of health protective behaviors in an individual.

Purpose: The main objectives of national plans are as follows; keeping individuals of all ages healthy, protecting their health, maximizing the health of individuals with chronic diseases and creating a healthy living space and environment. However, throughout the process of human development, the perspective on the concept of "Health" has changed in each period.

Materials and methods: Scientific and technological developments in the field of medicine have provided significant advances in the treatment of diseases. However, it is also seen that the diagnostic and treatment processes cause high financial costs. It is seen that common diseases and causes of death in the world and in Kosovo are similar. These diseases are cardiovascular diseases, cancer, diabetes and infectious diseases. It seems that the modifiable causes of these diseases are also similar. These are nutritional deficiencies, tobacco use, stress and lack of physical activity. At this point, health promotion programs occupy an important place in providing positive health behaviors for individuals, families and society. With this perspective, the expenses spent on treating diseases can also be reduced.

The basis of these plans are;

- To help individuals of all age groups to become healthy,
- To optimize health in cases of chronic diseases/disabilities,
- To create a healthy environment

Conclusion: To achieve a goal, an individual or group must decide and achieve to fulfill the needs. Therefore, health is not the goal of life, but a resource for everyday life. Health is a positive concept that highlights physical capacities in addition to social and personal resources. The basic conditions and resources for health are: Peace; Housing; Education; Food; Income; A stable ecosystem; Sustainable resources.

Keywords: Disease prevention, health care, scientific developments, health, food

Prezantimi i konceptit të Spitaleve të Shëndetshme në dy spitale pilot në Kosovë gjatë vitit 2023

Merita Berisha^{1,2}, Ardita Baraku^{1,3}, Valbona Zhjeqi^{1,2}, Florie Miftari Basholli^{1,2}, Mejreme Rexha^{1,2}, Sevdie Spahiu^{1,2}, Sebahate Pacolli^{1,2}, Pranvera Krasniqi^{1,2}, Floriana Saiti^{1,2}, Diellza Thaci^{1,2}, Fekrije Hasani⁵, Ilir Mecini⁵

¹ *Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publikë të Kosovës*

² *Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës*

³ *UBT, Institucioni i Arsimit të Lartë, Kosovë*

⁴ *Swiss Tropical and Public Health Institute (Shërbimet Shëndetësore të Integruara)*

Hyrje: Si pjesë e lëvizjes së OBSH-së "Mjedise të Shëndetshme", "Spitalet që Promovojnë Shëndetin" synon të integrojë vlerat dhe standardet e promovimit të shëndetit në strukturën dhe kulturën spitalore, duke i sjellë dobi pacientëve, stafit dhe komunitetit. Versioni aktual, "Standardet 2020 për Spitalet dhe Shërbimet Shëndetësore që Promovojnë Shëndetin", përfshin 5 standarde, 18 nënstandarde dhe 85 deklarata.

Qëllimi: Ky punim paraqet se si prezantuam konceptin e spitaleve të shëndetshme në dy spitale pilot në Kosovë, kryem vetëvlerësimin e parë dhe hartuam planin e parë të veprimit me ndërhyrje.

Materialet dhe metodat: Për vetëvlerësimin fillestar në dy spitale të përgjithshme të Pejës dhe Gjakovës gjatë periudhës korrik - shtator 2023 në Kosovë, u përzgjedhën 5 standarde, 12 nënstandarde dhe 20 deklarata.

U mbajtën shtatë punëtori të cilat u mbështetën nga projekti IHS, projekt i financuar nga SDC. Pas takimit të parë informues, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Ministria e Shëndetësisë, dy spitale me mbështetjen e ekspertëve të IHS nga partneri Optimedis, zhvilluan procesin e vetëvlerësimit dhe planin vjetor të veprimit.

Rezultatet: Gjatë vetëvlerësimit zbuluam se 7 standarde u përmbushën plotësisht, 10 u përmbushën pjesërisht dhe 3 nuk u përmbushën fare, të përshkruara më poshtë.

Standardi 1 i HPH "Demonstrimi i angazhimeve organizative për HPH": dy (2) standarde u përmbushën pjesërisht;

Standardi 2 i HPH "Sigurimi i aksesit në shërbim": një (1) standard u përmbush plotësisht, një (1) pjesërisht dhe një (1) nuk u përmbush;

Standardi 3 i HPH "Përmirësimi i kujdesit shëndetësor të përqendruar te njerëzit dhe përfshirja e përdoruesve": katër (4) standarde u përmbushën plotësisht, pesë (5) pjesërisht dhe dy (2) nuk u përmbushën;

Standardi 4 i HPH “Krijimi i një vendi pune të shëndetshëm dhe një mjedisi të shëndetshëm”: një (1) standard u përmbush plotësisht dhe një (1) pjesërisht;

Standardi 5 i HPH “Promovimi i shëndetit në një shoqëri më të gjerë”: një (1) standard u përmbush plotësisht dhe një (1) pjesërisht.

Bazuar në gjetjet, hartuam një plan veprimi vjetor.

Përfundimi: Standardet fillestare të aplikuara u zgjodhën në përputhje me kriteret e vendosura nga spitali për të siguruar që përmbushja e tyre të jetë në përputhje me kushtet specifike të secilit spital. Plani vjetor i veprimit i dy spitaleve synon të arrijë plotësisht të 20 standardet që u vlerësuan dhe të shërbejë si model që do të zgjerohet në spitale të tjera në Kosovë.

Fjalët kyçe: Spitalet e Promovimit të Shëndetit, Standardet, Kosova.

Introduction of the Healthy Hospital Concept in Two Pilot Hospitals in Kosovo during 2023

Merita Berisha^{1,2}, Ardita Baraku^{1,3}, Valbona Zhjeki^{1,2}, Florie Miftari Basholli^{1,2}, Mejreme Rexha^{1,2}, Sevdie Spahiu^{1,2}, Sebahate Pacolli^{1,2}, Pranvera Krasniqi^{1,2}, Floriana Saiti^{1,2}, Diellza Thaci^{1,2}, Fekrije Hasani⁵, Ilir Mecini⁵

¹ *National Institute of Public Health of Kosovo*

² *Medical Faculty, University of Prishtina*

³ *UBT, Higher Education Institution, Kosovo*

⁴ *Swiss Tropical and Public Health Institute (Integrated Health Services)*

Introduction: As part of the "Healthy Settings" WHO movement, "Health Promoting Hospitals" aims to integrate health promotion values and standards into the structure and hospital culture, benefiting patients, staff, and the community. The current version, "2020 Standards for Health Promoting Hospitals and Health Services", includes 5 standards, 18 sub-standards and 85 statements.

Aim: This work presents how we introduced the concept of healthy hospitals in two pilot hospitals in Kosovo, conducted first self-assessment and produced the first action plan with interventions.

Materials and methods: For initial self-assessment in two general hospitals of Peja and Gjakova during the period July - September 2023 in Kosovo, 5 standards, 12 substandards and 20 statements were selected.

Seven workshops were held which were supported by the IHS project, SDC funded Project. After first informative meeting, the National Institute of Public Health, Ministry of Health, two hospitals with the support of IHS experts from Optimedis partner, developed the self-assessment process and the annual action plan.

Results: During the self-assessment we found that 7 standards were met completely, 10 were met partially and 3 were not met at all, described below.

HPH Standard 1 "Demonstration of organizational commitments for HPH": two (2) standards were met partially;

HPH Standard 2 "Ensuring access to the service": one (1) standard was met completely, one (1) partially and one (1) was not met;

HPH Standard 3 "Improving people-centered health care and user involvement": four (4) standards were met fully, five (5) partially and two (2) were not met;

HPH Standard 4 “Creating a healthy workplace and a healthy environment”: one (1) standard was met fully and one (1) partially;

HPH Standard 5 “Health promotion in a wider society”: one (1) standard was met fully and one (1) partially.

Based on the findings we developed annual action plan.

Conclusion: The initial standards applied were chosen in accordance with the hospital's criteria sets to ensure that the meeting them could aligns with the specific conditions of each hospital. The annual action plan of two hospitals aims to achieve fully all 20 standards that were assessed and serve as a model to be expanded to other hospitals in Kosovo.

Keywords: Health Promotion Hospitals, Standards, Kosovo.

Promovimi i shëndetit në komunitetin rural vs urban

Delvina Lamallari, MD ¹

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.

delvina.lamallari@outlook.com

Abstrakt

Hyrje

Popullatat rurale përballen me sfida të rritura shëndetësore për shkak të mjedisit të jetesës, punës, statusit socio-ekonomik dhe aksesit të kufizuar në shërbimet shëndetësore. Shumica e vdekjeve në popullatë lidhen me faktorë të rrezikut të sjelljes, si: duhanpirja, dieta e pashëndetshme, konsumi i alkoolit dhe aktiviteti i ulët fizik.

Qëllimi i punimit

Ky punim ka për qëllim të tregoj rolin e promovimit të shëndetit në komunitetet rurale vs urbane, ndikimin e mjedisit, rrethit social, statusit socio-ekonomik dhe aksesit në shërbimet shëndetësore për dy grupet e popullatës.

Materiali dhe Metodat

Punimi bazohet në rishikimin e literaturës dhe të dhënave ekzistuese të punimeve shkencore të botuara viteve të fundit.

Rezultatet

Të dhënat zbuluan se popullatat rurale karakterizohen nga nivele më të ulëta arsimimi, të ardhura më të vogla, nivele më të larta të konsumit të alkoolit, glikemisë, hipertension arterial, obezitet. Ndërsa, popullata urbane ka nivele më të larta arsimimi, të ardhura mujore të mjaftueshme, duhanpirje dhe hiperkolesterolemi. Aksesit në kujdesin parësor shëndetësor ishte më i ulët në zonat rurale, megjithatë përgjithësisht konsiderohet i mirë.

Përfundime

Analiza tregoi një prevalencë më të lartë të mbipeshës tek gratë, si dhe një prevalencë të rritur të konsumit të alkoolit tek burrat. Aksesit në kujdesin parësor është më i ulët në zonat rurale, por qëndron në nivele të pranueshme. Nivelet më të ulëta të arsimimit dhe mundësia e ulët për edukim shëndetësor nënvizojnë nevojën për fushata të edukimit shëndetësor në fushat e promovimit shëndetësor dhe parandalimit të sëmundjeve.

Fjalët kyçe: zonat rurale, zonat urbane, shëndeti.

Health promotion in rural vs urban communities

Delvina Lamallari, MD ¹

¹Faculty of Medicine, University of Prishtina “Hasan Prishtina”.

delvina.lamallari@outlook.com

Abstract

Introduction

Rural populations face increased health challenges due to their living environment, work, socioeconomic status, and limited access to health services. Most deaths in the population are related to behavioral risk factors, such as smoking, unhealthy diet, alcohol consumption, and low physical activity.

Purpose of the paper

This paper aims to show the role of health promotion in rural vs. urban communities, the impact of the environment, social circle, socioeconomic status, and access to health services for the two population groups.

Material and Methods

The paper is based on a review of the literature and existing data from scientific papers published in recent years.

Results

The data revealed that rural populations are characterized by lower levels of education, lower income, higher levels of alcohol consumption, glycemia, arterial hypertension, and obesity. Whereas, the urban population has higher levels of education, sufficient monthly income, smoking and hypercholesterolemia. Access to primary health care was lower in rural areas, however, it is generally considered good.

Conclusions

The analysis showed a higher prevalence of obesity in women, as well as an increased prevalence of alcohol consumption in men. Access to primary care is lower in rural areas, but remains at acceptable levels. Lower levels of education and low access to health education underline the need for health education campaigns in the areas of health promotion and disease prevention.

Keywords: rural areas, urban areas, health.

Qëndrimet e nxënësve të shkollave të mesme të bashkisë ndaj zbatimit të lëndës së edukimit shëndetësor në programet shkollore

Arbnora Mulaj¹, Merita Berisha^{1,2}, Tahire Maloku Gjergji^{1,2}, Sefedin Muçaj^{1,2}

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

² Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publikë të Kosovës

Abstrakt

Hyrje: Sipas OBSH-së (1997) çdo shkollë duhet t'i kushtojë vëmendje mundësimit të fëmijëve dhe adoleshentëve në të gjitha nivelet për të mësuar aftësi kritike shëndetësore dhe jetësore.

Qëllimi: i këtij studimi është të vlerësojë qëndrimet e nxënësve të shkollave të mesme në komunën e Drenasit në lidhje me zbatimin e lëndës Edukim Shëndetësor në programet shkollore.

Metodat: Ky hulumtim tërthor përfshinte 464 nxënës të klasave 10-12 në dy shkolla të mesme në komunën e Drenasit, gjatë majit 2024. Për mbledhjen e të dhënave përdorëm një pyetësor të strukturuar që përmbante gjithsej 16 pyetje dhe analizimin e të dhënave duke përdorur programin SPSS.

Rezultatet: Qëndrimet e nxënësve të shkollave të mesme të larta në komunën e Drenasit në lidhje me zbatimin e lëndës Edukim Shëndetësor në programet shkollore ndryshojnë në varësi të moshës, por nuk pritet të ndryshojnë ndjeshëm midis shkollave.

Përfundim: Shumica e nxënësve e konsiderojnë Edukimin Shëndetësor si thelbësor dhe shprehin gatishmërinë për ta përfshirë atë në programet e tyre.

Fjalë kyçe: Qëndrime, nxënës, zbatim, edukim shëndetësor, shkollë, Drenas

The attitudes of municipality high school students towards the implementation of the health education subject in school programs

Arbnora Mulaj¹, Merita Berisha^{1,2}, Tahire Maloku Gjergji^{1,2}, Sefedin Muçaj^{1,2}

¹Faculty of Medicine, Hasan Prishtina University, Prishtina City, Kosova 10000

²National Institute of Public Health of Kosova, Pristina City, Kosova 10000

Abstract

Introduction: According to WHO (1997) every school should pay attention to enable children and adolescents at all levels to learn critical health and life skills.

The purpose: of this study is to assess the attitudes of high school students in the municipality of Drenas regarding the implementation of the subject Health Education in school programs.

Methods: This cross-sectional research included 464 students of grades 10 - 12 in two high school schools in the municipality of Drenas, during May 2024. For data collection we used a structured questionnaire containing a total of 16 questions and data analyzing using SPSS program.

Results: The attitudes of upper secondary school students in the municipality of Drenas regarding the implementation of the subject Health Education in school programs vary depending on age, but are not expected to vary significantly between schools.

Conclusion: The majority of students consider Health Education as essential and express willingness to include it in their programs.

Keywords: Attitudes, students, implementation, health education, school, Drenas

- III -

Sëmundjet ngjitëse

Communicable diseases

Hulumtimi Serologjik dhe Gjenomik i Virusit të West Nile në Kosovë

^{1,2}Petra Emmerich, ³Xhevat Jakupi, ⁴Kurtesh Sherifi, ⁵Shemsedin Dreshaj, ³Ariana Kalaveshi, ²Christoph Hemmer, ³Donjeta Pllana Hajdari, ^{1,2}Ronald von Possel, ¹Dániel Cadar, ¹Alexandru Tomazatos

¹Instituti për Mjekësi Tropikale, Bernhard Nocht, Qendra OBSH për Bashkëpunimin të Arbovirusëve dhe Etheve Hemoragjike, 20359 Hamburg, Gjermani

²Departamenti për Mjekësi Tropikale dhe Sëmundje Infektive, Qendra për Mjekësi Interne, Universiteti Rostock, 18057 Rostock, Gjermani

³Instituti Kombëtar I Shëndetësisë Publike, 10000 Pristina, Kosovo

⁴Fakulteti për Agrikulturë dhe Veterinari, Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina" 10000 Prishtinë, Kosovo

⁵Klinika Universitare e Sëmundjeve Infektive, Fakulteti I Mjekësisë
donjetapllana@hotmail.com / donjeta.hajdari@rks-gov.net

Abstrakti

Virusi i West Nile (WNV) po përhapet gjithnjë e më shumë nëpër Evropë, duke u shfaqur edhe në shtete që më parë ishin të paprekura. Kosova ndodhet në një rajon endemik të WNV, ku të dhënat seroepidemiologjike mbi këtë virus te njerëzit mungojnë. Për të adresuar këtë boshllëk, kemi realizuar një hetim seroepidemiologjik mbi 453 mostra serumi të zgjedhura rastësisht nga spacientët e hospitalizuar në Kosovë, duke zbuluar një prevalencë seropozitive anti-WNV IgG prej 1.55%. Analizat krahasuese dhe filogjeografike të gjenomave të WNV të marra duke sekuestruar mostra të arkivuara nga pacientë me ethe West Nile tregojnë të paktën dy hyrje të fundit dhe të dallueshme të linjës 2 të WNV në Kosovë nga vendet fqinje. Këto gjetje konfirmojnë statusin ekolo-epidemiologjik të WNV në Evropën juglindore, ku shpërndarja afatgjatë dhe afatshkurtër e varianteve të linjës 2 kontribuon në një qarkullim më të gjerë përmes Evropës qendrore. Rezultatet tona sugjerojnë një rrezik në rritje për përhapjen e WNV në Kosovë, duke theksuar nevojën për një program të integruar kombëtar mbikëqyrjeje që synon vektorët dhe popullatat e shpendëve për zbulimin e hershëm të epidemive, si dhe skanimin e dhuruesve të gjakut për të vlerësuar ndikimin e qarkullimit të virusit te popullata njerëzore.

Fjalë kyçe: Kosovë; Virus i West Nile; epidemiologji; gjenomikë; filogjeografi; serologji.

Serological and Genomic Research of West Nile Virus in Kosovo

^{1,2}Petra Emmerich, ³Xhevat Jakupi, ⁴Kurtesh Sherifi, ⁵Shemsedin Dreshaj, ³Ariana Kalaveshi, ²Christoph Hemmer, ³Donjeta Pllana Hajdari, ^{1,2}Ronald von Possel, ¹Dániel Cadar, ¹Alexandru Tomazatos

¹*Institute for Tropical Medicine, Bernhard Nocht, WHO Collaborating Centre for Arboviruses and Hemorrhagic Fevers, 20359 Hamburg, Germany*

²*Department of Tropical Medicine and Infectious Diseases, Center for Internal Medicine, University of Rostock, 18057 Rostock, Germany*

³*National Institute of Public Health of Kosova, 10000 Pristina, Kosovo*

⁴*Faculty of Agriculture and Veterinary Medicine, University of Pristina “Hasan Prishtina” 10000 Pristina, Kosovo*

⁵*University Clinic of Infectious Diseases, Faculty of Medicine*
donjetapllana@hotmail.com /donjeta.hajdari@rks-gov.net

Abstract

West Nile virus (WNV) is increasingly spreading across Europe, emerging in previously unaffected countries. Kosovo is located in a WNV endemic region, where seroepidemiological data on this virus in humans are lacking. To address this gap, we conducted a seroepidemiological investigation on 453 randomly selected serum samples from hospitalized patients in Kosovo, revealing a seropositive prevalence of anti-WNV IgG of 1.55%. Comparative and phylogeographic analyses of WNV genomes obtained by sequestering archived samples from patients with West Nile fever indicate at least two recent and distinct introductions of WNV lineage 2 into Kosovo from neighboring countries. These findings confirm the eco-epidemiological status of WNV in southeastern Europe, where long-term and short-term distribution of lineage 2 variants contributes to a wider circulation through central Europe. Our results suggest an increasing risk of WNV spread in Kosovo, highlighting the need for an integrated national surveillance program targeting vectors and bird populations for early detection of epidemics, as well as screening of blood donors to assess the impact of virus circulation in the human population.

Keywords: Kosovo; West Nile Virus; epidemiology; genomics; phylogeography; serology.

Ndërlidhja në mes të vaksinimit kundër fruthit dhe incidencës së sëmundjes si dhe evaluimi i imunitetit pasvaksinal

Dr. Sci. Edita Goranci - Haxhiu

Hyrje: Fruthi është njëra ndër sëmundjet më ngjitëse me të cilat përballet njerëzimi. Pavarësisht përparimit të konsiderueshëm në fushën e shëndetësisë publike, kjo sëmundje mbetet ende një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë të fëmijët në mbarë botën. Edhe pse ekziston një vaksinë e sigurt dhe shumë efektive, vdekjet globale nga fruthi vazhdojnë të regjistrohen. Për të eliminuar fruthin kërkohet nivel i lartë i imunitet të popullatës me mbulueshmëri mbi 95% me dy doza të vaksinës kundër fruthit, shytave dhe rubellës (MMR).

Qëllimi: Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ishte të vlerësohej ndërlidhja ndërmjet imunizimit me vaksinë kundër fruthit dhe incidencës së sëmundjes, të përcaktohej niveli i imunitetit pas vaksinimit, si dhe të analizohej progresi i arritur në përpjekjet për eliminimin e fruthit në Kosovë.

Materiali dhe metodat: Ky është studim i tipit të prerjes tërthore (cross-sectional), në të cilin është analizuar mbikëqyrja epidemiologjike e rasteve me fruth, duke u bazuar në diagnozën epidemiologjike, klinike dhe serologjike, mbulueshmëria me vaksinim nëpër vite në raport me incidencën e sëmundjes në popullatë duke analizuar seroprevalencën e fruthit në grupe të ndryshme të popullatës.

Rezultatet: Në Kosovë, gjatë periudhës 2017-2021 janë raportuar 1,507 raste të sëmundjeve të parandalueshme me vaksinë, ndër to ishin 749 raste të fruthit me incidencë 42 në 100,000 banorë. Shifër më të lartë të sëmundshmërisë ka pasur Fushë Kosova me 27.8% të rasteve, Prishtina 20.9% të përcjella nga Lipjani 7.9%, Mitrovica 5.8%. dhe Ferizaji 4.3% gjë që korrelohet me venbanimet me mbulueshmëri më të ulët me vaksinim. Është vërejtur dallim statistikor sinjifikant në mes të komunave të Hanit të Elezit, Istogut dhe të Therandës në raport me nivelin kombëtar (t test=6.89, t test=8.10 dhe t test=4.84) në nivelin e sinjifikancës $p > 0.05$ për të tri komunat. Sipas korrelacionit të Spearmanit ($r = .474$, $p > 0.05$) nuk është vërtetuar korrelacion i rëndësishëm në mes të mbulueshmërisë me vaksinim dhe incidencës së fruthit në nivel kombëtar. Rezultatet treguan seropozitivitet të përgjithshëm prej 74.5% (95%CI:0.70-0.88). Sipas testit Kruskal-Wallis është vërtetuar se ekziston dallim statistikor sinjifikant i seroprevalencës në mes të grupmoshave në nivelin e besueshmërisë $p < 0.01$ derisa sipas gjinisë, incidenca e fruthit ishte më e lartë te gjinia mashkullore, gjë që është në korrelacion me seroprevalencën më të ulët te e njëjta gjini ($P < 0.01$).

Përfundimi: Seroprevalenca e antitropave kundër fruthit në Kosovë nuk e ka arritur ende pragu e kërkuar prej 95%, duke krijuar rrezik për epidemi të mundshme të sëmundjes. Është e domosdoshme të zhvillohen strategji të përforcuara të imunizimit, të cilat synojnë grupet më të cenueshme të popullatës, si dhe të përfshijnë gjithë popullatën në mënyrë që të arrihet eliminimi i fruthit.

Fjalë kyçe: fruthi, seroprevalence, vaksinim

The correlation between measles vaccination and disease incidence, and the evaluation of post-vaccination immunity

Dr. Sci. Edita Goranci - Haxhiu

Introduction: Measles is one of the most contagious diseases faced by humanity. Despite safe and highly effective vaccine is available this disease remains one of the leading causes of mortality among children worldwide. Eliminating measles requires a high level of population immunity, which is achieved with over 95% coverage with two doses of the measles, mumps and rubella (MMR) vaccine.

Objective: The main objective of this research was to evaluate the correlation between measles vaccination and disease incidence, determine the level of immunity after vaccination and analyze the progress achieved in efforts to eliminate measles in Kosovo.

Material and methods: This is a cross-sectional study, in which the epidemiological surveillance of measles cases were analyzed, based on epidemiological, clinical and serological diagnosis, vaccination coverage over the years in relation to the disease incidence in the population by analyzing the measles seroprevalence in different population groups.

Results: In Kosovo, during the period 2017-2021, a total of 1,507 cases of vaccine-preventable diseases were reported, including 749 measles cases with an incidence of 42 per 100,000 inhabitants. The highest incidence rate was recorded in Fushë Kosova with 27.8%, Prishtina 20.9% followed by Lipjan 7.9%, Mitrovica 5.8%. and Ferizaj 4.3% of cases which correlates with the settlements with lower vaccination coverage. A statistically significant difference was observed between the municipalities of Hani i Elezit, Istog and Theranda in relation to the national level (t test=6.89, t test=8.10 and t test=4.84) at the significance level $p>0.05$ for all three municipalities. According to Spearman's correlation ($r=.474$, $p>0.05$) no significant correlation was confirmed between vaccination coverage and measles incidence at the national level. The results showed an overall seropositivity of 74.5% (95%CI:0.70-0.88). The findings from the research confirmed a statistically significant difference in seroprevalence between age groups at a confidence level of $p<0.01$, whereas by gender, measles incidence was higher in males, which correlates with lower seroprevalence in the same gender ($p<0.01$).

Conclusion: The seroprevalence of antibodies against measles in Kosovo has not yet reached the required threshold of 95%, posing a risk for potential epidemics disease outbreaks. It is essential to support strengthening the Immunization Program and develop national strategies, targeting the most vulnerable population groups considering the equity approach involving the entire population in order to achieve measles elimination.

Keywords: measles, seroprevalence, vaccination

Rasti i parë me Mpox në Kosovë dhe menaxhimi i tij – Studim rasti

¹Faik Hoti, ¹Pranvera Kaçaniku, ¹Magbule Vata, ²Lindita Ajazaj-Berisha, ¹Myrvete Arifi, ¹Hana Raifi, ¹Kadriona Azizi

¹Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

²Klinika e Sëmundjeve Infektive, Prishtinë

Abstrakti:

Hyrje: Më 26 dhjetor 2024, u konfirmua rasti i parë me Mpox (monkeypox) në Kosovë, në një pacient të kthyer nga një vend endemik. Ky rast paraqet një shembull të mirë të reagimit të koordinuar ndër-institucional ndaj një sëmundjeje të importuar me potencial për përhapje.

Metodologjia: Bëhet fjalë për një studim rasti i bazuar në të dhëna klinike, laboratorike dhe epidemiologjike të mbledhura nga Departamenti i Epidemiologjisë në IKSHPK dhe dhe Klinika Infektive. Gjatë këtij rastit, u aplikuan masat standarde të izolimit, gjurmimit të kontakteve dhe vaksinimit post-ekspozues, në përputhje me protokollin/udhëzuesin e IKSHPK-së, i bazuar në udhëzuesit specifik të OBSH-së.

Rezultatet: Pacienti, mashkull 30-vjeçar i kthyer nga Togo, u paraqit me ethe, lezione të lëkurës dhe limfadenopati. Diagnostikimi u konfirmua me PCR test në IKSHPK. U identifikuan edhe 20 kontakte të ngushta, nga të cilët 5 janë vaksinuar më 27 dhjetor me doza të siguruara nga Shqipëria. Përveç njoftimit brenda institucional, është bërë edhe njoftim zyrtar për publikun si dhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit (IHR), janë njoftuar edhe OBSH dhe ECDC. Janë shpërndarje materiale informuese për profesionistët shëndetësorë dhe udhëtarët e mundshëm në vende endemike.

Diskutim: Ky rast tregon rëndësinë e vigjilencës epidemiologjike, fuqizimin e kapaciteteve laboratorike dhe bashkëpunimit rajonal në përgjigjen ndaj sëmundjeve infektive zoonotike. Pavarësisht se Kosova nuk është një vend endemik sa i përket Mpox, reagimi i shpejtë ndihmoi në parandalimin e përhapjes komunitare.

Përfundim: Rasti i parë me Mpox në Kosovë thekson nevojën për përforcimin e mbikëqyrjes epidemiologjike ndërkufitare, gatishmërisë së sistemit shëndetësor dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare për menaxhimin efektiv të rasteve importuara.

Fjalë kyçe: Mpox, mbikëqyrje epidemiologjike, reagim i shpejtë, vaksinim post-ekspozues.

The First Mpox Case in Kosovo and Its Management – A Case Study

¹Faik Hoti, ¹Pranvera Kaçaniku, ¹Magbule Vata, ²Lindita Ajazaj-Berisha, ¹Myrvete Arifi, ¹Hana Raifi, ¹Kadriona Azizi

¹Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

²Klinika e Sëmundjeve Infektive, Prishtinë

Abstract:

Introduction: On December 26, 2024, the first case of Mpox (monkeypox) in Kosovo was confirmed in a patient returning from an endemic country. This case represents a strong example of a well-coordinated, multi-sectoral response to an imported disease with outbreak potential.

Methods: This is a case study based on clinical, laboratory, and epidemiological data collected by the Department of Epidemiology at NIPHK and the Infectious Disease Clinic. Standard procedures for case isolation, contact tracing, and post-exposure vaccination were implemented in accordance with the national protocol developed by NIPHK, aligned with WHO technical guidelines.

Results: The patient, a 30-year-old male recently returned from Togo, presented with fever, skin lesions, and lymphadenopathy. The diagnosis was confirmed via PCR testing at NIPHK. A total of 20 close contacts were identified, of whom five were vaccinated on December 27 with doses provided by Albania. In addition to internal notification procedures, an official public announcement was made, and in line with the International Health Regulations (IHR), WHO and ECDC were also notified. Informational materials are being distributed to health professionals and potential travelers to endemic countries.

Discussion: This case underscores the importance of robust epidemiological surveillance, strengthened laboratory capacity, and regional collaboration in responding to emerging zoonotic infectious diseases. Although Kosovo is not an endemic country for Mpox, the swift response effectively prevented community transmission.

Conclusion: The first Mpox case in Kosovo highlights the critical need for enhanced cross-border surveillance, improved health system preparedness, and strengthened cooperation with international health institutions for effective management of imported cases.

Keywords: Mpox, epidemiological surveillance, rapid response, post-exposure vaccination.

Njohuritë, qëndrimet dhe praktikat lidhur me ethet hemoragjike me sindromë veshkore në mesin e banorëve të përkohshëm në bjeshkë

Shqipe Krasniqi-Kola¹, Adnora Nurboja¹, Albina Vrella¹, Agnesa Salihu¹

¹IKSHPK-QRSHP Pejë

Shqipe.Kola@rks-gov.net, shqipe_krasniqi123@hotmail.com

Hyrje - Ethet hemoragjike me sindromë veshkore (EHSV) është një grup i sëmundjeve akute infektive të shkaktuara nga Hantavirusët, të cilët barten dhe transmetohen nga brejtës të veçantë të cilët edhe janë rezervoar natyror i tyre. Njeriu është nikoqir aksidental i virusit dhe infeksioni më së shpeshti shfaqet pas ekspozimit ndaj ekskreteve dhe sekreteve të brejtësve të infektuar. EHSV janë të përhapura në mbarë botën. Në Kosovë vatra natyrore të sëmundjes janë bjeshkët e Pejës, Deçanit, Istogut, Junikut, Gjakovës dhe Ferizajit dhe të rrezikuar janë njerëzit të cilët frekuentojnë këto bjeshkë për arsye të ndryshme

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim vlerësimin e njohurive të banorëve të përkohshëm që posedojnë stane në bjeshkë dhe i ekspozohen kontaktit me brejtës, vlerësimin e qëndrimeve dhe praktikave që qojnë në transmetimin e hantavirusëve nga rezervoari tek njeriu.

Materiali dhe metoda: Për studim është përdorur metoda sasiore me modelin cross-sectional të studimit. 204 pjesëmarrës nga komunat Deçan, Istog dhe Junik të cilët kanë stane në bjeshkë janë intervistuar ballë për ballë me pyetësor të standardizuar. Statistikat descriptive dhe analitike me significancë 95% dhe p value 0.05 janë përdorur për të shpjeguar përgjigjet e pjesëmarrësve.

Rezultatet: 192(94.1%) të anketuar kanë dëgjuar për EHSV dhe 164(90.4%) kanë njohuri se sëmundja është shumë serioze, por vetëm 49(24.0%) e konsiderojnë si shumë serioze në vendin ku jetojnë. Simptomet me të njohura janë ethet dhe simptomet e ngjashme me gripin (113 apo 55.4% dhe 82 apo 40.0%). Rrugë kryesore të bartjes së sëmundjes njohin kontaktin me brejtës (100 apo 49.0%) dhe si masë kryesore parandaluese kontrollin e brejtësve (89 apo 43.6%). 115 apo 56.4% kanë mësuar për sëmundjen nga të afërmit dhe shokët dhe 119 (58.8%) kanë pasur kontakt me brejtës gjatë sezonës paraprake.

Konkluzione: Ky studim vë në pah boshllëkun në njohuritë dhe qëndrimet e banorëve lidhur me EHSV, që si rrjedhojë ka pastaj edhe mangësi në praktika lidhur me parandalimin e sëmundjes.

Fjalë kyçe: Ethet hemoragjike me sindromë veshkore, hantavirusët, brejtësit, bjeshkët

Knowledge, attitudes and practices related to hemorrhagic fever with renal syndrome among temporary residents in the mountains

Shqipe Krasniqi-Kola¹, Adnora Nurboja¹, Albina Vrella¹, Agnesa Salihu¹

¹NIPHK-RIPH Peja

Shqipe.Kola@rks-gov.net, shqipe_krasniqi123@hotmail.com

Background: Hemorrhagic fever with renal syndrome (HFRS) is a group of acute infectious diseases caused by Hantaviruses, which are carried and transmitted by certain rodents which are also their natural reservoir. Humans are accidental host of the virus and infection often occurs after exposure to the excreta and secretions of infected rodents. HFRS is widespread worldwide. In Kosovo the natural foci of the disease are the mountains of Peja, Deçan, Istog, Junik, Gjakova and Ferizaj and the people who visit these mountains for various reasons are at risk.

Purpose: This study aims to assess the knowledge of the temporary residents who own small houses in the mountains and are exposed to contact with rodents, and to assess the attitudes and practices that leads to the transmission of hantaviruses from reservoir to humans.

Methods: The quantitative method with cross sectional model was used for the study. 204 participants from the municipalities of Deçan Istog and Junik who have small houses in the mountains were interviewed face to face with a standardized questionnaire. Descriptive and analytical statistics with 95% significance and p value 0.05 were used to explain the responses of the participants.

Results: 192 (94.1%) respondents have heard about HFRS and 164 (90.4%) have knowledge that the disease is very serious, but only 49 (24.0%) consider it as very serious in the place where they live. The most known symptoms are fever and flu-like symptoms (113 or 55.4% and 82 or 40.0%). The main known route of transmission of the disease is the contact with rodents (100 or 40.0%) and the rodent control as the main preventive measure (89 or 43.6%). 115 (56.4%) have learned about the disease from relatives and friends and 119 (58.8%) have had contact with the rodents during the previous season.

Conclusion: This study highlights the lack of knowledge and attitudes of residents regarding HFRS, which consequently has an impact on the lack of practices related to the prevention of the disease.

Keywords: hemorrhagic fever with renal syndrome, hantaviruses, rodents, mountains

Qëndrimet e prindërve para dhe pas vaksinimit kundër HPV-së në Kosovë

Kadrionë Azizi Msc¹, Kaltrina Azizi-Sadiku Phd.Cand

¹Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

²Kolegji Heimerer

Abstrakti

Hyrje

Në vitin 2023, Kosova për herë të parë ka përfshirë në kalendarin e rregullt të vaksinimit vaksinën e HPV-së për vajzat e moshës 12-vjeçare. Fillimi i procesit kishte sfida për sa i përket pranimin të kësaj vaksine nga komuniteti. Në një kontekst të ndjeshëm për shkak të “lodhjes” nga pandemia COVID-19, mungesa e informimit rreth një vaksine të “re”, qëndrimet konservatore dhe përhapja e vrullëshme e informatave jo të sakta në rrjete sociale, dhanë një ndikim të lehtë shtytës që Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës të zbatoi një qasje të integruar të komunikimit të rrezikut dhe përfshirjes së komunitetit në zbatimin e fushatës së vaksinimit.

Qëllimi

Ky hulumtim ka për qëllim të shqyrtoj qëndrimet e prindërve para dhe pas vaksinimit të vajzave të tyre me vaksinën HPV si dhe ndikimin e fushatave informuese, përfshirjen e profesionistëve shëndetësor, prindërve/ kujdestarëve ligjorë, në zbatimin e një Planit të komunikimit të përshtatur për grupet e synuara.

Materiali/ Metodat

Përmes analizës së të dhënave cilësore nga intervista me prindër, si dhe të dhënave sasiore mbi mbulueshmërinë e vaksinimit në vitin e parë të zbatimit, do të paraqiten rezultatet e arritura dhe mësimet e nxjerra.

Rezultatet dhe përfundimi

Gjetjet dëshmojnë se komunikimi transparent, i qëndrueshëm dhe i drejtpërdrejt ka luajtur një rol kyç në uljen e hezitimit dhe rritjen e besimit në vaksinën kundër HPV-së. Kjo përvojë ofron një model të mirë praktik për forcimin e programeve të vaksinimit, në veçanti me rastin e aplikimit të vaksinave të “reja”.

Fjalë kyçe: Vaksinimi, HPV, komunikimi ,hezitimi për vaksinim, Kosovë.

Parental Attitudes Before and After HPV Vaccination in Kosovo

Kadrionë Azizi Msc¹, Kaltrina Azizi-Sadiku Phd.Cand

¹Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

²Kolegji Heimerer

Abstract

Introduction

In 2023, Kosovo integrated the HPV vaccine into its national immunization schedule for the first time, targeting 12-year-old girls. The introduction of this vaccine faced several challenges, particularly regarding public acceptance. In a context marked by “pandemic fatigue” from COVID-19, limited public awareness about the “new” vaccine, conservative societal attitudes, and the rapid spread of misinformation on social media contributed to a hesitant reception. In response, the National Institute of Public Health of Kosovo implemented an integrated risk communication and community engagement approach to support the vaccination campaign.

Objective

This study aims to examine parental attitudes before and after their daughters received the HPV vaccine and to evaluate the impact of targeted information campaigns, healthcare professional involvement, and engagement of parents/legal guardians through a tailored communication plan.

Materials and Methods

Using qualitative data from parent interviews and quantitative data on vaccination coverage during the program’s first year, this research presents the achieved results and lessons learned.

Results and Conclusion

Findings indicate that transparent, consistent, and direct communication played a crucial role in reducing vaccine hesitancy and increasing public trust in the HPV vaccine. This experience offers a valuable best-practice model for strengthening immunization programs, particularly when introducing new vaccines.

Keywords: Vaccination, HPV, communication, vaccine hesitancy, Kosovo.

Hepatiti Viral në Ballkan: Barrë Shëndetësore Publike dhe Strategjitë e Parandalimit

Dr. Donart Zymberi

Mjek i Përgjithshëm QKMF-Gjakovë

donart.zymberi2@gmail.com

Abstrakti

Hyrje: Hepatitet virale, veçanërisht hepatiti B (HBV) dhe hepatiti C (HCV), mbeten një sfidë e rëndësishme e shëndetit publik në rajonin e Ballkanit. Shkalla e lartë e infeksioneve të padiagnostifikuara, mungesa e skriningut dhe mbulimi i pamjaftueshëm i vaksinimit përbëjnë faktorë kyç që nxisin përhapjen.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë barrën epidemiologjike të hepatitit viral në Ballkan dhe të analizojë strategjitë e nevojshme dhe aktuale të parandalimit.

Materiali dhe metodat: Ky punim është një rishikim i literaturës nga databaza të njohura mjekësore si PubMed, Scopus dhe Web of Science për periudhën 2015-2025.

Rezultatet: Rajonet e Ballkanit shfaqin variacione të ndjeshme në prevalencën e HBV dhe HCV, me prevalence më të lartë në vendet me burime të kufizuara dhe mbikëqyrje të dobët. Mungesa e skriningut universal dhe niveli i ulët i ndërgjegjësimit përbëjnë barrierat thelbësore. Gjithashtu, stigmatizmi social dhe mungesa e qasjes në kujdesin shëndetësor pengojnë diagnostikimin dhe trajtimin në kohë.

Përfundimi: Parandalimi efektiv kërkon qasje të shumëfishta, përfshirë rritjen e mbulimit të vaksinimit neonatal, zbatimin e programeve të skriningut kombëtar të bazuara në evidenca dhe edukimin e popullatës për rrugët e transmetimit dhe trajtimin. Bashkëpunimi ndër-rajonal dhe investimet në sistemin shëndetësor janë thelbësore për reduktimin e barrës epidemiologjike së hepatitit viral në Ballkan.

Fjalë kyçe: Hepatiti, Parandalimi, Shëndeti Publik, Skriningu

Viral Hepatitis in the Balkans: Public Health Burden and Prevention Strategies

Author: Dr. Donart Zymberi

Institution: Medical Doctor at QKMF-Gjakovë

donart.zymberi2@gmail.com

Abstract

Introduction: Viral hepatitis, particularly hepatitis B (HBV) and hepatitis C (HCV), remains a significant public health challenge in the Balkan region. The high rate of undiagnosed infections, lack of screening programs and insufficient vaccination coverage are key factors driving its continued spread.

Objective: This paper aims to assess the epidemiological burden of viral hepatitis in the Balkans and analyze both current and necessary prevention strategies.

Materials and Methods: This study is a literature review based on medical databases such as PubMed, Scopus, and Web of Science covering the period from 2015 to 2025.

Results: The Balkan region demonstrates considerable variation in the prevalence of HBV and HCV, with higher rates in countries with limited resources and inadequate surveillance systems. The absence of universal screening and low public awareness are major barriers. Additionally, social stigma and limited access to healthcare services hinder timely diagnosis and treatment.

Conclusion: Effective prevention requires multifaceted approaches, including increasing neonatal vaccination coverage, implementing evidence-based national screening programs, and educating the population about transmission routes and available treatments. Interregional collaboration and investment in healthcare infrastructure are essential to reducing the epidemiological burden of viral hepatitis in the Balkans.

Keywords: Hepatitis, Prevention, Public Health, Screening

Analizimi i njohurive rreth sëmundjeve seksualisht të transmetueshme tek nxënësit e shkollave të mesme në komunën e Gjilanit

Endrit Muji¹, Eronit Muji¹, Erisa Selmani¹, Rina Hoxha^{1,2}, Fatime Ukaj^{1,2}

¹Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

²Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Email adresa: endrit.muji@student.uni-pr.edu

Abstrakti

Hyrja: Sëmundjet seksualisht të transmetueshme (SST-të) janë një problem serioz shëndetësor global, veçanërisht te adoleshentët për shkak të faktorëve biologjikë, socialë dhe mungesës së edukimit të strukturuar seksual.

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të vlerësoj nivelin e njohurive mbi SST-të tek nxënësit e shkollave të mesme në Gjilan dhe të analizojë lidhjen me gjininë, moshën dhe klasën.

Materiali dhe Metodologjia: Studimi është i tipit transversal (cross sectional) dhe është kryer duke përdorur një anketë online përmes platformës Google Forms në një mostër të nxënësve të shkollave të mesme në qytetin e Gjilanit, me pjesëmarrjen e 105 nxënësve të klasave X, XI dhe XII (mosha 15-18 vjeç). Përpunimi i të dhënave u bë në Microsoft Excel dhe analiza statistikore u krye me testin Hi-katror. Janë raportuar vlerat X^2 dhe vlerat p, duke u konsideruar sinjifikante rezultatet me $p < 0.05$.

Rezultatet: Mosha mesatare e pjesëmarrësve ishte 16.6 vjeç, dhe mediana 17 vjeç. Nga pjesëmarrësit, 48.6% ishin femra dhe 51.4% meshkuj. Interneti ishte burimi kryesor i informacionit mbi SST-të, i përzgjedhur nga 68.6% e nxënësve. Njohuritë në përgjithësi rezultuan të pamjaftueshme. HIV/AIDS u njoh si sëmundje seksualisht e transmetueshme nga 84.8% e nxënësve, ndërsa sëmundjet e tjera u njohën nga më pak se 50% e tyre. Rastet më ekstreme ishin Hepatiti B dhe Hepatiti C, të cilët u identifikuan si SST vetëm nga 13.3% dhe 10.5% e nxënësve përkatësisht.

Përfundime: Studimi nxjerr në pah mungesën e njohurive adekuate mbi SST-të dhe nevojën për edukim seksual të strukturuar dhe ndërhyrje më të thelluara në sistemin arsimor.

Fjalët kyçe: Sëmundjet seksualisht të transmetueshme, adoleshentët, Gjilan

Analysis of Knowledge About Sexually Transmitted Diseases Among High School Students in the Municipality of Gjilan

Endrit Muji¹, Eronit Muji¹, Erisa Selmani¹, Rina Hoxha^{1,2}, Fatime Ukaj^{1,2}

¹Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

²Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Email adresa: endrit.muji@student.uni-pr.edu

Abstract

Introduction: Sexually transmitted diseases (STDs) are a serious global health issue, particularly among adolescents due to biological, social factors, and the lack of structured sexual education.

Objective: The aim of this study was to assess the level of knowledge about STDs among high school students in Gjilan and to analyze its association with gender, age, and class level.

Materials and Methods: The study is a cross-sectional type and was conducted using an online survey through the Google Forms platform with a sample of high school students in the city of Gjilan, involving 105 students from grades 10, 11, and 12 (ages 15–18). Data processing was carried out in Microsoft Excel, and statistical analysis was performed using the Chi-square test. The χ^2 values and p-values were reported, with results considered significant at $p < 0.05$.

Results: The average age of participants was 16.6 years, with a median of 17 years. Among the participants, 48.6% were female and 51.4% male. The internet was the main source of information about STDs, selected by 68.6% of students. Overall, knowledge was found to be insufficient. HIV/AIDS was recognized as a sexually transmitted disease by 84.8% of students, while the other diseases were identified by less than 50% of them. The most extreme cases were Hepatitis B and Hepatitis C, which were identified as STDs by only 13.3% and 10.5% of students, respectively.

Conclusions: The study highlights the lack of adequate knowledge about STDs and emphasizes the need for structured sexual education and deeper interventions within the educational system.

Keywords: Sexually transmitted diseases, adolescents, Gjilan

Lija e Majmunit - Një Problem i Shëndetit Publik

Arbër Aliu, MD

dr.arberaliu@gmail.com

Abstrakt

Hyrje: Lija e majmunit është një sëmundje me një rëndësi globale për shëndetin publik sepse nuk i atakon vetëm vendet e Afrikës Qendrore dhe Perëndimore, por edhe mbarë botën. Kur bota po përballlet me mutantin SARS-CoV- 19, shfaqja në shumë vende të botës e lisë së majmunëve, që deri më tani endemike tek qeniet njerëzore është vërtetë shqetësuese. Kjo është e rëndësishme, duke pasur parasysh se virusi është i lidhur me virusin ogurzi, shpesh fatal të variolës.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është që të përshkruhet lia e majmunit si një problem i shëndetit publik. Janë sqaruar shkaktarët, patofiziologjia, pasqyra klinike, diagnoza, trajtimi dhe parandalimi i përhapjes së kësaj sëmundje infektive.

Metodologjia: Për realizimin e këtij punimi janë marrë të dhënat më të reja duke shfrytëzuar literaturë elektronike dhe literaturë nga librat e botuar e cila është ilustruar me figura të ndryshme.

Rezultatet: Historiku i lijës së majmunit daton që nga 1958 në Copenhagen, kur tek majmunët e llojit *Cynomolgus* u shfaq një sëmundje e ngashme me lijën. Lija e majmunit tek njerëzit për herë të parë u identifikua në vitin 1970 në Republikën Demokratike të Kongos tek një djalë 9-vjeçar në një rajon ku lija ishte çrrënjësuar që në vitin 1968. Virus i lisë së majmunit është virus dyzinxihorë i mbështjellë i ADN-së që i përket gjinisë *Orthopoxvirus* në familjen *Poxviridae*. Lija e majmunit klinikisht shfaqet me ethe, kokëdhembje, skuqe, limfadenopati e cila është karakteristike. Kujdesi klinik duhet të fokusohet për të lehtësuar simptomat, menaxhuar komplikimet dhe për të parandaluar pasojat afatgjata apo komplikimet.

Përfundimi: Ky studim mbështet trajtimin dhe parandalimin e përhapjes së kësaj sëmundje infektive, nëpërmjet reduktimit të faktorëve të rrezikut. Vetëdijësimi i përgjithshëm i popullatës nga personeli mjekësor llogaritet si forma më adekuate e parandalimit eventual të infeksionit me lijën e majmunit.

Fjalët kyçe: Virusi i Mpox(Monkeypox), klinika, përhapja, parandalimi, shëndeti publik.

Monkeypox – A Public Health Concern

Arbër Aliu, MD

dr.arberaliu@gmail.com

Abstract

Introduction: Monkeypox is a disease of global public health significance because it does not only affect Central and West African countries but poses a threat worldwide. As the world continues to confront the SARS-CoV-2 variant, the emergence of monkeypox cases in multiple countries, previously endemic only in humans in specific regions, is deeply concerning. This is particularly important given that the virus is related to the notorious and often fatal smallpox virus.

Objective: The aim of this paper is to describe monkeypox as a public health issue. The causes, pathophysiology, clinical manifestations, diagnosis, treatment, and prevention of the spread of this infectious disease are explained.

Methodology: The research was conducted using the latest data sourced from electronic literature and published books, supplemented with various illustrations.

Results: The history of monkeypox dates back to 1958 in Copenhagen, where a pox-like disease was identified in *Cynomolgus* monkeys. Human monkeypox was first identified in 1970 in the Democratic Republic of Congo in a 9-year-old boy from a region where smallpox had been eradicated since 1968. The monkeypox virus is an enveloped, double-stranded DNA virus belonging to the *Orthopoxvirus* genus within the *Poxviridae* family. Clinically, monkeypox presents with fever, headache, rash, and characteristic lymphadenopathy. Clinical care should focus on symptom relief, managing complications, and preventing long-term consequences.

Conclusion: This study supports the importance of treating and preventing the spread of this infectious disease by reducing risk factors. Public awareness through medical personnel is considered the most effective method for potentially preventing monkeypox infection.

Keywords: Mpox virus (Monkeypox), clinical features, transmission, prevention, public health.

Vaksinimi me HPV-vaksinën në komunën e Prizrenit

Meriton Bytyqi,¹, Edmond Morina¹

¹Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare PRIZREN

meriton.bytyqi2016@outlook.com

dr.edmorina@gmail.com

Abstrakt

Hyrja: Vaksinimi mundëson eliminimin e shumë sëmundjeve infektive dhe nuk lejonë që të përhapet efekti i tyre në organizmin tonë. Vaksinimi mund të ketë ndonjë rrezik anësor mirëpo nuk mund të jetë rreziku më i madh sesa i sëmundjeve që ka për synim të parandalojë. Kalendarit të rregullt të vaksinimit në Kosovë në vitin 2023 i janë shtuar edhe 3 vaksina të reja si: Vaksina kundër Human Papilloma Virusit; Vaksina kundër Rotavirusit dhe Vaksina kundër Pneumokokut, me qëllim të parandalimit të sëmundjeve si Karcionima e qafës së mitrës, infeksioneve me Rotavirus, Pneumonisë, Meningjtit e Sepsës.

Qëllimi: Punimi përfshin hulumtimin e fëmijëve të vaksinuuar me vaksinën HPV në regionin e Prizrenit, impaktin që kishte kjo vaksinën në popullatë si tek fëmijët ashtu edhe te prindërit e tyre. Arsytet e mos pranimit nga ana e prindërve që të vaksinojnë fëmijët e tyre me vaksinën e HPV.

Metodologjia: Të dhënat janë marrë nga institucionet përkatëse, dhe përmes anketimit të palëve me interes (prindërit e fëmijëve që duhet vaksinuar), pastaj janë sistemuar në databaza të caktuara përmes programeve si Microsoft Word, Excel dhe Power point.

Rezultatet: Në kuadër të këtij hulumtimi janë marrë të dhëna nga njësia e vaksinimit në QKMF-Prizren, ku për vitin 2024 nga 950 vajza të klasës së VI-të që janë planifikuar të vaksinohen me HPV vaksinën 670 prej tyre janë vaksinuar. Në vitin 2025 filloj vaksinimi me vaksinën HPV edhe për gjininë mashkullore. Qendra e vaksinimit në IKSHPK në vitin 2025 e lejoj vaksinimin edhe të moshave deri në 21 vjeq. Nga 1850 të planifikuar 434 prej tyre janë vaksinuar (225 të gjinisë femërore, 199 të gjinisë mashkullore dhe 10 të moshës deri në 21 vjeq, të cilët u vaksinuan me vetdëshirë) Hulumtimi vazhdoj me anketimin e prindërve të cilët kanë fëmijë të kësaj moshe dhe të cilët është dashur t'i nënshtrohen vaksinimit me vaksinën HPV. Janë anketuar gjithsej 100 persona. Anketat janë përgaditur nga autorët përkatës dhe përmbajnë 10 pyetje.

Përfundimi: Numri i fëmijëve të vaksinuar me vaksinën HPV në komunën e Prizrenit është deri në një masë i kënaqshëm, megjithatë duhet punuar më tepër në informimin e prindërve rreth rrezikut nga infeksioni me Human Papilloma Virusin, pasojat shëndetësore që ky infeksion mund të shkaktojë, gjithashtu mbrojtjen që ofron vaksina për fëmijët e tyre.

HPV vaccination in the municipality of Prizren

Meriton Bytyqi, ¹, Edmond Morina ¹

¹Main Family Medicine Center PRIZREN

meriton.bytyqi2016@outlook.com

dr.edmorina@gmail.com

Abstract

Introduction: Vaccination enables the elimination of many infectious diseases and does not allow their effect to spread in our body. Vaccination may have some side risks, but it cannot be a greater risk than the diseases it aims to prevent. 3 new vaccines have been added to the regular vaccination calendar in Kosovo in 2023, such as: Human Papilloma Virus Vaccine; Rotavirus Vaccine and Pneumococcus Vaccine, with the aim of preventing diseases such as Cervical Carcinoma, Rotavirus Infections, Pneumonia, Meningitis and Sepsis.

Purpose: The paper includes research on children vaccinated with the HPV vaccine in the Prizren region, the impact this vaccine had on the population, both on children and their parents. Reasons for parents' refusal to vaccinate their children with the HPV vaccine.

Methodology: data was obtained from relevant institutions, and through a survey of stakeholders (parents of children who need to be vaccinated), then systematized in certain databases through programs such as Microsoft Word, Excel and Power point.

Results: As part of this research, data were obtained from the vaccination unit at the QKMF-Prizren, where for 2024, out of 950 sixth-grade girls who were scheduled to be vaccinated with the HPV vaccine, 670 of them were vaccinated. In 2025, vaccination with the HPV vaccine will also begin for males. The vaccination center at the National Institute of Public Health and Population in 2025 allows vaccination of people up to 21 years of age. Out of the planned 1850, 434 of them have been vaccinated (225 females, 199 males and 10 up to 21 years of age, who were vaccinated voluntarily). The research continued with a survey of parents who have children of this age and who should have been vaccinated with the HPV vaccine. A total of 100 people were surveyed. The surveys were prepared by the respective authors and contain 10 questions.

Conclusion: The number of children vaccinated with the HPV vaccine in the municipality of Prizren is to a satisfactory extent, however, more work needs to be done to inform parents about the risk of infection with the Human Papilloma Virus, the health consequences that this infection can cause, as well as the protection that the vaccine offers for their children.

Ethet Hemorragjike me Sindrom Veshkor – Si Problem i Shëndetit Publik

Elira Nuraj¹, Sefedin Muçaj^{1,2}

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

² Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

nurajelira@gmail.com

Abstrakt

Hyrje: Ethet Hemorragjike me Sindrom Veshkor (EHSV), njohur ndryshe si “Ethet e Minjve”, është një zoonozë virale akute që shfaqet te minjtë e infektuar me Hantan virusin. Kjo sëmundje karakterizohet nga temperaturë e lartë, sindrom hemorragjik, dhe çrregullime metabolike të shprehura në enët e gjakut.

Qellimi: synon të analizojë literaturën e disponueshme mbi EHSV, duke përqëndruar vëmendjen në grumbullimin, vlerësimin dhe analizimin e të dhënave nga burime të ndryshme.

Metodologjia: përfshin rishikim të literaturës në databazat Scopus, PubMed dhe Google Scholar, duke përdorur fjalë kyçe të tilla si HFRS, epidemiologji, zona endemike, etiologji, simptoma, parandalim dhe trajtim, shtrirja gjeografike, etj.

Rezultatet: të gjeturat përfshijnë njohuri të reja në lidhje me EHSV, paraqitjen e rasteve në Kosovë në periudhën 2013-2022, dhe rolin e personelit shëndetësor dhe qytetarëve në edukimin dhe promovimin e shëndetit.

Përfundimet: tregojnë se situata me EHSV në Kosovë është komplekse dhe kërkon një përqasje të integruar për menaxhimin dhe parandalimin e kësaj sfide shëndetësore dhe epidemiologjike. EHSV vazhdon të jetë një problem serioz në aspektin shëndetësor, social, ekonomik dhe biologjik, duke kërkuar një përqasje të integruar përballë shpërthimeve periodike dhe impaktit të lartë në shëndetin publik në Kosovë.

Fjalet kyçe: EHSV, epidemiologjia, parandalimi dhe trajtimi, shtrirja gjeografike.

Hemorrhagic Fever with Renal Syndrome – As a Public Health Problem

Elira Nuraj¹, Sefedin Muçaj^{1,2}

¹ Faculty of Medicine, University of Prishtina

² National Institute of Public Health of Kosovo

nurajelira@gmail.com

Abstract

Introduction: Hemorrhagic Fever with Renal Syndrome (HFRS), colloquially known as “Rat fever”, is an acute viral zoonosis prevalent in rats infected with the Hantaan virus. This disease is distinguished by elevated body temperature, a hemorrhagic syndrome, and metabolic disruptions affecting blood vessels.

Objective: This study aims to comprehensively examine existing literature on HFRS, with a specific focus on the compilation, assessment, and analysis of data derived from diverse sources.

Methodology: The research involves a thorough literature review utilizing databases such as Scopus, PubMed, and Google Scholar. Keywords employed include HFRS, epidemiology, endemic areas, etiology, symptoms, prevention and treatment, geographic distribution, among others.

Results: The study presents novel insights into HFRS, details cases documented in Kosovo between 2013-2022, and emphasizes the roles of healthcare professionals and citizens in health education and promotion.

Conclusions: The findings underscore the complexity of the HFRS situation in Kosovo, necessitating a comprehensive approach to effectively manage and prevent this health and epidemiological challenge. HFRS remains a significant concern impacting health, society, economy, and biology, demanding an integrated strategy to address periodic outbreaks and their substantial impact on public health in Kosovo.

Keywords: HFRS, epidemiology, prevention and treatment, geographic distribution.

Njohuritë dhe qëndrimet e maturantëve për sëmundjen e HIV/AIDS-it në komunën e Rahovecit

Dafina Hajredini¹, Rina Hoxha^{1,2}, Fatime Ukaj^{1,2}

¹. Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

². Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

dafina.hajredini3@student.uni-pr.edu

Abstrakti

Hyrje: HIV/AIDS-i është një nga sfidat më të mëdha shëndetësore dhe sociale për dekada, duke prekur miliona individë në tërë botën pavarësisht përparimeve të mëdha në fushën e mjekësisë dhe edukatës shëndetësore, kjo sëmundje mbetet ende një rrezik i madh për shëndetin publik dhe një çështje delikate për shoqëritë. Vitet e fundit, adoleshentët janë bërë një nga grupet më të rrezikuara nga HIV.

Qëllimi: Qëllimi i këtij hulumtimi është që ta shqyrtojë nivelin e njohurive dhe qëndrimeve të maturantëve të komunës së Rahovecit për HIV/AIDS-in, duke e vlersuar poashtu edhe ndikimin që edukimi dhe informacionet e shpërndara në shkolla, media dhe mjedisin social kanë në preceptimet dhe qëndrimet e tyre rreth kësaj sëmundjeje.

Metodologjia: Hulumtimi është i tipit cros sectional me komponentën descriptive (përshkruese). Ky hulumtim është realizuar përmes një pyetsori online, i cili në përmbajtje ka gjithsej 16 pyetje. Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 114 maturantë gjithsej, të shkollave të mesme të Rahovecit. Ndërkaq me anë të programit kompjuterik Excel rezultatet janë gjeneruar në formë tabelare dhe grafike.

Rezultatet dhe diskutimi: Në këtë hulumtim u fokusua në vlerësimin e njohurive dhe qëndrimeve të maturantëve rreth HIV/AIDS, duke marrë parasysh nivelin e edukatës dhe informacionit që ata kanë marrë në lidhje me këtë temë. Shohim se njohuritë e tyre bazike tek shumica e maturantëve rreth HIV/AIDS, nuk janë të pakta. E nëse thellohem në pyetje më delikate atëherë shohim se njohuritë nuk i kanë dhe aq të qarta. Kurse, sa i përket qëndrimeve, ata kanë qëndrime të ndryshme, pra shohim se kemi nevojë që sa më shumë të flitet për këtë temë delikate.

Përfundimi: Përfundimisht, maturantët e komunës së Rahovecit përgjithësisht kanë njohuri bazë të mira për HIV/AIDS-in dhe mënyrat e transmetimit të tij. Ku 88% e kanë definuar HIV/AIDS-in saktë si virus që dëmton sistemin imunitar, ndërsa një përqindje e vogël kanë njohuri të mangëta apo e ngatërrojnë me kancerin. Sa i përket transmetimit, 63.2% e lidhin me marrëdhënie seksuale pa mbrojtje dhe 26.4% me përdorimin e shiringave të papastra. Megjithatë, 8.6% gabimisht mendojnë se transmetohet përmes prekjes së lëkurës. Dhe, sa i përket qëndrimit të maturantëve ndaj personave me HIV/AIDS është kryesisht pozitiv, me 60.5%.

Fjalët kyçe: HIV/AIDS; Njohuritë dhe qëndrimet; Maturantët; Ndërgjegjësimi i të rinjëve; Edukimi seksual

Knowledge and Attitudes of High School Graduates Regarding HIV/AIDS in the Municipality of Rahovec

Dafina Hajredini¹, Rina Hoxha^{1,2}, Fatime Ukaj^{1,2}

¹ Faculty of Medicine, University of Prishtina

² National Institute of Public Health of Kosovo

dafina.hajredini3@student.uni-pr.edu

Abstract

Introduction: In modern times, despite significant advancements in the field of medicine and public awareness, HIV/AIDS remains one of the greatest global health challenges. Continuous awareness and education are essential to prevent its spread. High school graduates, as an important societal group, represent a segment of youth that can play a vital role in raising awareness and preventing the transmission of HIV.

Purpose: The aim of this study is to examine the level of knowledge and attitudes of high school graduates from Rahovec and surrounding areas regarding HIV/AIDS. It also aims to assess the impact of education and information disseminated through schools, the media, and the social environment on their perceptions and attitudes toward this disease.

Methodology: This is a cross-sectional study with descriptive components. The research was conducted through an online questionnaire consisting of 16 questions in total. A total of 114 high school graduates from Rahovec participated in the study. The collected data was processed using Microsoft Excel and presented in tables and graphs.

Results and Discussion: In this study, around half of the respondents (39.5%) held negative views toward people living with HIV, while 60.5% believed that people living with HIV are no different from others. A similar study conducted in Cameroon produced comparable results, where about half of the respondents had negative views, while approximately 65% considered people with HIV to be the same as others.

Conclusion: Overall, high school graduates from the municipality of Rahovec possess a good basic understanding of HIV/AIDS and its modes of transmission. About 88% correctly identified HIV/AIDS as a virus that weakens the immune system, whereas a small percentage either had insufficient knowledge or confused it with cancer. Regarding transmission, 63.2% associated it with unprotected sexual intercourse, and 26.4% with the use of contaminated needles. However, 8.6% mistakenly believed it could be transmitted through skin contact. Concerning attitudes toward people living with HIV/AIDS, the majority (60.5%) held positive views.

Keywords: HIV/AIDS; Knowledge and attitudes; High school graduates; Youth awareness; Sexual education

Incidenca e Lijës së majmunit në Evropë për periudhën 2022-2024- Rishikim literature

Fluturim Ramaj¹, Dr. Dardan Ismajli ², Arianita Bytyqi¹

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

² Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika e Endokrinologjise

Abstrakt

Hyrje:Lija e majmunit (monkeypox) është një sëmundje ngjitëse virale zoonotike, virusi i lijes së majmunit i përket familjes Poxviridae, nënfamiljes Chordopoxvirinae dhe gjinisë orthopoxvirus. Virusi i lijes së majmunit u izolua për herë të parë në vitin 1958 nga majmunët në Institutin Statens Serum në Kopenhagë, Danimarkë .Rasti i parë i njohur njerëzor i lijes së majmunit u regjistrua në vitin 1970 në Republikën Demokratike të Kongos. Njohja klinike, diagnoza dhe parandalimi ende mbeten sfida në zonat endemike me burime të pakta ku gjendet lija e majmunit. Epidemiologjia e lijes së majmunit mbështetet nga studimet e kryera në fund të zhdukjes së lijes së madhe, por vlerësime të reja janë të nevojshme tani sepse vaksinimi rutinë kundër lijes së madhe ka mbaruar dhe ka një rënie të imunitetit. Përveç kësaj, studimet themelore ekologjike janë të nevojshme për të kuptuar më mirë speciet e kafshëve të përfshira në transmetimin dhe mirëmbajtjen e virusit, dhe për të informuar më tej masat parandaluese.

Qëllimi:Qëllimi i këtij studimi është të analizojë karakteristikat klinike, rrugët e transmetimit dhe mënyrat e kontrollit të përhapjes së virusit të lijes së majmunit, si dhe të vlerësojë masat parandaluese të zbatuara në nivel ndërkombëtar, ne vecanti të shpërthimi i lijes së majmunit në vitin 2022 ku virusi u përhapë edhe ne vendet joendemike te botës.

Materiali dhe Metodologjia: Ky studim perfaqëson një rishikim sistematik të literaturës përmes burimeve shkencore si PubMed, WHO, Scopus, Medline. Janë analizuar të dhëna epidemiologjike, studime klinike dhe raporte të shpërthimeve të fundit, me fokus në periudhën 2022–2024.

Rezultatet: Që nga fillimi i majit 2022, rastet e lijes së majmunit janë raportuar nga vende të shumta ku sëmundja nuk është endemike. Që nga 9 qershori 2022, më shumë se 1350 raste të konfirmuara në laborator të lijes së majmunit janë raportuar nga 31 vende joendemike në të gjithë botën, me afërsisht 60% të raportuara nga 3 vende: Portugalia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar. Që nga 9 qershori 2022, Qendrat e SHBA-së për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) raportuan 45 raste në 15 shtete dhe disa raste u raportuan edhe në Kolumbi. Shumica e rasteve të raportuara nuk kanë lidhje me udhëtimin me një vend endemik, dhe shumica e rasteve kanë qenë midis burrave që kanë marrëdhënie seksuale me burra, duke rritur mundësinë e transmetimit seksual. Ndërsa lija e majmunit nuk është një infeksion seksualisht i

transmetueshëm në kuptimin tipik, ajo mund të transmetohet lehtësisht gjatë kontaktit seksual dhe intim. Inokulimi i virusit në lëkurë dhe sipërfaqet mukozale ndodh me kontakt të drejtpërdrejtë, seksual ose lëkurë me lëkurë, dhe madje mund të përfshijë transmetimin nëpërmjet objekteve të tilla si peshqirët, shtrati. Në Kosovë më 27 dhjetor 2024 u raportua rasti i parë me Lijen e Majmunit, një mashkull 30 vjeçar i ardhur nga Afrika Përendimore.

Konkluzioni: Virusi i lijes së majmunit është një ortopoksvirus shumë ngjitës që aktualisht po shkakton një shpërthim global, kryesisht tek burrat që kryejnë marrëdhënie seksuale me burra. Kontrolli i këtij shpërthimi ndërkombëtar në rritje do të kërkojë koordinim të kujdesshëm midis zyrtarëve të shëndetit publik, mjekëve dhe komunitetit për të përhapur informacion, për të marrë teste të përshtatshme diagnostikuese, për të zbatuar gjurmimin e kontakteve dhe për të siguruar që individët e prekur të kenë qasje në kujdesin mjekësor.

Fjalë kyçe: Lija e Majmunit, Ortopoksvirus, zonë endemike, kontakt seksual, 2022-2024.

Incidence of MONKEYPOX in Europe during the period 2022–2024: A Literature Review

Fluturim Ramaj¹, Dr. Dardan Ismajli², Arianita Bytyqi¹

¹ Faculty of Medicine, University of Prishtina

² University Clinical Center of Kosovo, Clinic of Endocrinology

Abstract

Introduction: Monkeypox is a contagious zoonotic viral disease caused by the monkeypox virus, which belongs to the Poxviridae family, Chordopoxvirinae subfamily, and the Orthopoxvirus genus. The monkeypox virus was first isolated in 1958 from monkeys at the Statens Serum Institute in Copenhagen, Denmark. The first known human case of monkeypox was recorded in 1970 in the Democratic Republic of Congo. Clinical recognition, diagnosis, and prevention remain challenges in endemic areas with limited resources. The epidemiology of monkeypox has historically relied on studies conducted at the end of the smallpox eradication era; however, new assessments are now necessary due to the cessation of routine smallpox vaccination and a decline in population immunity. Additionally, fundamental ecological studies are needed to better understand the animal species involved in the transmission and maintenance of the virus and to inform further preventive measures.

Objective: The aim of this study is to analyze the clinical features, transmission pathways, and control strategies for the spread of monkeypox virus, and to evaluate international preventive measures, with particular emphasis on the 2022 outbreak, during which the virus spread to non-endemic countries.

Materials and Methods: The study represents a systematic review of the literature through scientific sources such as PubMed, WHO, Scopus, and Medline. Epidemiological data, clinical studies, and reports on recent outbreaks were analyzed, with a focus on the period from 2022 to 2024.

Results: Since early May 2022, monkeypox cases have been reported in multiple countries where the disease is not endemic. As of June 9, 2022, more than 1,350 laboratory-confirmed cases were reported across 31 non-endemic countries worldwide, with approximately 60% of cases reported from three countries: Portugal, Spain, and the United Kingdom. By the same date, the United States Centers for Disease Control and Prevention (CDC) had reported 45 cases across 15 states, and additional cases were reported in Colombia. Most reported cases had no travel links to endemic areas, and the majority occurred among men who have sex with men (MSM), suggesting the possibility of sexual transmission. While monkeypox is not a sexually transmitted infection in the

classical sense, it can be transmitted effectively through sexual and intimate contact. Viral inoculation on the skin and mucosal surfaces occurs through direct contact—sexual or skin-to-skin—and may also include transmission via contaminated objects such as towels or bedding. In Kosovo, the first confirmed case of monkeypox was reported on December 27, 2024, in a 30-year-old male who had returned from West Africa.

Conclusion: Monkeypox virus is a highly contagious orthopoxvirus currently causing a global outbreak, primarily affecting men who have sex with men. Containing this growing international outbreak will require careful coordination between public health officials, clinicians, and communities to disseminate information, ensure proper diagnostic testing, implement contact tracing, and guarantee access to appropriate medical care for affected individuals.

Keywords: Monkeypox, Orthopoxvirus, endemic area, sexual contact, 2022–2024.

- IV -

Sëmundjet jongjitëse

Non-communicable diseases

Të moshuarit me sëmundje kronike jongjitëse dhe malinje në Kosovë: Qasjet dhe sfidat e kujdesit

Naim Jerliu^{1,2}, Pranvera Krasniqi^{1,2}, Arlinda Jetishi¹, Heroida Ferati-Bytyçi¹, Mirë Linda Hatashi¹, Merita Berisha^{1,2}, Valbona Zhjeki^{1,2}

1. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

2. Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

Abstrakt

Hyrje: Në vitet e fundit, Kosova ka përjetuar një rritje të ndjeshme të popullsisë së moshuar. Në bazë të regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 në Kosovë, 10.94% e popullsisë i takon moshës mbi 65 vjeç. Moshimi i popullsisë dhe problemet shëndetësore të kësaj kategorie paraqesin sfida të rëndësishme për sistemin e kujdesit shëndetësor dhe mirëqenies sociale.

Metodat/Materiali: Ky studim bazohet në përpunimin e të dhënave të mbledhura nga Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës dhe sistemit shëndetësor 2022, si dhe raportet e sëmundjeve kronike jongjitëse dhe sëmundjeve malinje të vitit 2022-2023.

Rezultatet: Në regjistrin popullativ në Departamentin e Statistikave Shëndetësore në IKSHPK për vitin 2023 janë raportuar gjithsej 21,999 raste të pacientëve të moshës mbi 65 vjeç me sëmundje kronike jongjitëse, prej të cilëve 61.4% femra dhe 38.5% meshkuj, krahasuar me vitin 2022 që ishin raportuar gjithsej 13,564 raste prej të cilave 60.5% femra dhe 39.5% meshkuj. Dy diagnozat me përqindje më të lartë për vitin 2023 kanë qenë hipertensioni arterial primar (I10) me gjithsej 11,261 raste (51.1%) dhe diabeti melitus i pavarur nga insulina (E11) me gjithsej 5,489 raste (25.0%), krahasuar me vitin 2022 ku me hipertension arterial primar (I10) ishin gjithsej 8,537 raste (62.9%) dhe diabet melitus i pavarur nga insulina (E11) me gjithsej 4,243 raste (31.3%). Sa i përket prevalencës së sëmundjeve malinje të raportuara në regjistrin popullativ për vitin 2023 janë raportuar gjithsej 2,214 raste të pacientëve të moshës mbi 65 vjeç me sëmundje malinje, prej të cilëve 43.5% femra dhe 56.4% meshkuj, krahasuar me vitin 2022 që ishin raportuar gjithsej 1,772 raste prej të cilave 43.0% femra dhe 56.9% meshkuj. Në Kosovë, kujdesi për të moshuarit mbështetet nga sistemi publik i kujdesit shëndetësor dhe social, por sfidat ekonomike dhe strukturore kanë kufizuar shtrirjen e shërbimeve. Sistemi aktual i kujdesit për të moshuarit në Kosovë përballlet me disa sfida kyçe, përfshirë: mungesën e infrastrukturës së kujdesit afatgjatë, mungesën e personelit të specializuar, mbingarkesën e qendrave shëndetësore dhe mungesën e fondeve për programe të dedikuara enkas për të moshuarit. Shërbimet e kujdesit në shtëpi janë të limituara, ndërsa institucionet për kujdes afatgjatë nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat në rritje.

Konkluzione: Koordinimi midis shërbimeve shëndetësore dhe sociale për të moshuarit është ende një sfidë në Kosovë. Shërbimet janë të ndara dhe shpesh nuk ofrojnë një qasje gjithëpërfshirëse. Integrimi më i mirë i shërbimeve shëndetësore, mbështetëse dhe rehabilituese, do të përmirësonte cilësinë e jetës së të moshuarve dhe do të ulte barrën mbi familjet e tyre. Zgjidhjet novatore mund të përfshijnë zhvillimin e shërbimeve të kujdesit në komunitet, përdorimin e teknologjisë për të lehtësuar qasjen në kujdesin shëndetësor, si dhe përmirësimin e trajnimit të profesionistëve të kujdesit për të moshuarit. Investimi në programe parandaluese dhe kujdes afatgjatë është thelbësor për të përballuar rritjen e popullsisë së moshuar në mënyrë të qëndrueshme.

Fjalët kyçe: të moshuarit, sëmundjet kronike jongjitëse, sëmundjet malinje, Kosovë.

The Older Adults with Chronic Non-communicable and Malignant Diseases in Kosovo: Care Approaches and Challenges

Naim Jerliu^{1,2}, Pranvera Krasniqi^{1,2}, Arlinda Jetishi¹, Heroida Ferati-Bytyçi¹, Mirëllinda Hatashi¹, Merita Berisha^{1,2}, Valbona Zhjeki^{1,2}

1. National Institute of Public Health of Kosovo

2. Faculty of Medicine, University of Prishtina

Abstract

Introduction: In recent years, Kosovo has experienced a significant increase in its older adult population. According to the 2024 population census in Kosovo, 10.94% of the population is over 65 years old. The aging population and the health conditions of older adults present significant challenges for the healthcare and social welfare systems.

Methods/Materials: This study is based on data processing from the Health Status Analysis of the Population and Healthcare System 2022, as well as reports on chronic non-communicable diseases and malignant diseases from 2022-2023.

Results: According to the population registry in the Department of Health Statistics at the National Institute of Public Health of Kosovo (NIPHK) for the year 2023, a total of 21,999 cases of patients over 65 years old with chronic non-communicable diseases were reported, of which 61.4% were female and 38.5% male. This is compared to 2022, when 13,564 cases were reported, of which 60.5% were female and 39.5% male. The two most prevalent diagnoses for 2023 were primary arterial hypertension (I10) with a total of 11,261 cases (51.1%) and insulin-independent diabetes mellitus (E11) with a total of 5,489 cases (25.0%). In 2022, there were 8,537 cases of primary arterial hypertension (I10) (62.9%) and 4,243 cases of insulin-independent diabetes mellitus (E11) (31.3%). As for the prevalence of malignant diseases reported in the population registry for 2023, a total of 1,945 cases of patients over 65 years old with malignant diseases were reported, of which 40.8% were female and 59.2% male, while in 2022, there were 1,820 cases reported, of which 42.8% were female and 57.2% male. In Kosovo, care for older adults is supported by the public healthcare and social system, but economic and structural challenges have limited the expansion of services. The current system of care for older adults in Kosovo faces several key challenges, including the lack of long-term care infrastructure, shortage of specialized personnel, overcrowding of health centers, and insufficient funding for dedicated programs for older adults. Home care services are limited, while institutions for long-term care are insufficient to meet the growing needs.

Conclusions: Coordination between healthcare and social services for older people is still a challenge in Kosovo. Services are fragmented and often do not provide an integrated approach. Better integration of healthcare, supportive, and rehabilitative services would improve the quality of life for older adults and reduce the burden on their families. Innovative solutions may include the development of community-based care services, the use of technology to facilitate access to healthcare, and improving training for professionals caring for older adults. Investment in preventive programs and long-term care is essential to sustainably address the growing older population.

Keywords: older adults, chronic non-communicable diseases, malignant diseases, Kosovo.

“Maji, Muaji i Matjes së Presionit Arterial” në Shqipëri

Gentiana Qirjako^{1,2}, Rudina Çumashi², Romina Hala², Eugena Tomini^{1,2}, Genc Burazeri¹

¹ *Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri*

² *Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë, Shqipëri*

Abstrakt

Që prej vitit 2017, Shqipëria ka marrë pjesë në mënyrë aktive në fushatën globale May Measurement Month (MMM), një nismë ndërkombëtare e udhëhequr nga Shoqata Ndërkombëtare e Hipertensionit për të rritur ndërgjegjësimin mbi presionin e lartë të gjakut dhe për të promovuar masat parandaluese. Çdo vit, ekipi shqiptar bashkëpunon me profesionistë të shëndetit, studentë dhe institucione të shëndetit publik në të gjithë vendin për të zhvilluar matje masive të presionit arterial në mjedise komunitare, përfshirë qendra shëndetësore, universitete, vende pune dhe hapësira publike.

Fushata MMM në Shqipëri është zgjeruar në mënyrë të qëndrueshme si në shtrirje ashtu edhe në ndikim. Numri i pjesëmarrësve është rritur vit pas viti, nga afërsisht 1,700 individë të ekzaminuar në vitin 2017 në mbi 17,000 në vitin 2024. Fushata zbatohet në shkallë kombëtare përmes bashkëpunimit të ngushtë me specialistët e edukimit dhe promovimit shëndetësor në të gjithë vendin, duke theksuar rëndësinë e ndërgjegjësimit dhe matjes rutinë të presionit arterial si elementë thelbësorë të kujdesit parandalues.

Kjo nismë ofron një mundësi të veçantë për të angazhuar popullatën e gjerë, për të identifikuar individë me hipertension të padiagnostikuar ose të pakontrolluar, dhe për t'i udhëzuar drejt ndjekjes mjekësore dhe ndryshimeve në stilin e jetesës. Ajo shërben gjithashtu si një burim i vlefshëm i të dhënave epidemiologjike, duke promovuar një kulturë të kujdesit parandalues dhe edukimit shëndetësor në mbarë vendin. Fushata është shoqëruar nga një mbulim i gjerë mediatik çdo vit, duke përforcuar më tej mesazhin e saj në fushën e shëndetit publik.

Pjesëmarrja e vazhdueshme e Shqipërisë ndër vite nënvizon angazhimin e profesionistëve shqiptarë për parandalimin e sëmundjeve kardiovaskulare dhe thekson rëndësinë e veprimit të përbashkët në shëndetin publik për të adresuar sfidat globale shëndetësore.

Fjalë kyçe: presion i lartë i gjakut, fushatë, May Measurement Month (MMM), matje, deprimim

May Measurement Month campaign in Albania

Gentiana Qirjako^{1,2}, Rudina Çumashi², Romina Hala², Eugena Tomini^{1,2}, Genc Burazeri¹

¹ *Faculty of Medicine, University of Medicine, Tirana, Albania.*

² *Institute of Public Health, Tirana, Albania.*

Abstract

Since 2017, Albania has actively participated in the global May Measurement Month (MMM) campaign, an international initiative led by the International Society of Hypertension to raise awareness of high blood pressure and promote preventive health measures. Each year, the Albanian team collaborates with healthcare professionals, students, and public health institutions across the country to conduct widespread blood pressure screenings in community settings, including health centers, universities, workplaces, and public spaces.

The MMM campaign in Albania has steadily increased in both reach and impact. The number of participants has grown year by year, from approximately 1,700 individuals screened in 2017 to over 17,000 in 2024. The campaign is implemented nationwide through close collaboration with health education and promotion specialists across the country, emphasizing awareness and routine blood pressure measurement as essential components of preventive care.

This initiative provides a unique opportunity to engage with the general population, identify individuals with undiagnosed or uncontrolled hypertension, and guide them toward medical follow-up and lifestyle modifications. It also serves as a valuable source of epidemiological data while promoting a culture of preventive care and health education nationwide. The campaign has received strong media coverage each year, further amplifying its public health message.

Albania's consistent participation over the years underscores our commitment to cardiovascular disease prevention and highlights the importance of collaborative public health action in addressing global health challenges.

Keywords: high blood pressure, campaign, May Measurement Month (MMM), screening.

Sëmundjet malinje në Kosovë

*Sanije Hoxha-Gashi^{1,2}, Mirëllinda Hatashi¹, Besarta Hoxha¹, Raif Hasani¹, Kaltrina Xhekoviq¹
Kujtesa Emra¹, Mevlyde Uksmajli¹, Edita Kafexholli¹, Jeta Shagiri¹*

¹. *Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës*

². *Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"*

Abstrakt

Hyrje. Sëmundjet malinje dhe kanceret në përgjithësi janë në rritje të vazhdueshme duke e bërë shqetësim i madh për shëndetin publik. Në vitin 2022, Evropa regjistroi 4.47 milionë raste të reja me kancer, me një rrezik kumulativ prej 27.9% deri në moshën 75 vjeç. Kanceri pritet të mbetet njëri ndër shkaqet kryesore të vdekjeve në Evropë deri në vitin 2035.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të prezantohet incidenca, prevalenca e sëmundjeve malinje në Kosovë në vitin 2024.

Materiali dhe metodat. Për këtë hulumtim retrospektiv të dhënat janë marrë nga vjetari statistikor i Sëmundjeve malinje në Kosovë për vitin 2024 dhe statistikave demografike nga regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë REKos 2024 në Agjensinë e Statistikave të Kosovës.

Rezultatet. Në vitin 2024 në Kosovë janë raportuar 3644 raste të reja me neoplazmë grupi i dytë i diagnozave (C00-D48) sipas Klasifikimit të 10 Ndërkombëtar të Sëmundjeve (KNS 10). Nga ky numër (3644) vetëm një rast (0.03%) ishte tumorë benignë (D10-D36), katër raste ose 0.1% neoplazmë me tipare të pacakuara dhe të panjohura (D37-D48) kurse te tjerat 3639 ose 99.9% ishin neoplazmë malinje (C00-C97). Incidenca e sëmundjeve malinje ishte 227.1 raste në 100 000 banorë. Në vitin 2024 në Kosovë janë raportuar gjithsej 4620 raste me neoplazmë (C00-D48), prej të cilave vetëm pesë rast (0.1%) ishte tumorë benignë (D10-D36), katër raste ose 0.1% Neoplazmë me tipare të pacakuara dhe të panjohura (D37-D48), tre raste (0.1%) ishin Neoplazmë in situ (D00-D09), kurse te tjerat 4608 ose 99.7% ishin Neoplazmë malinje C00-C97. Prevalenca e sëmundjeve malinje ishte 288.3 raste në 100 000 banorë.

Përfundime. Prevalenca dhe incidence e sëmundjeve malinje në Kosovë është e lartë.

Fjalët kyçe: Sëmundjet malinje, Kosova, regjistrat popullativ

Malignant diseases in Kosovo

Sanije Hoxha-Gashi^{1,2}, Mirëllinda Hatashi¹, Besarta Hoxha¹, Raif Hasani¹, Kaltrina Xhekoviq¹, Kujtesa Emra¹, Mevlyde Uksmajli¹, Edita Kafexholli¹, Jeta Shaqiri¹

¹. National Institute of Public Health of Kosova

². Medical Faculty, University of Prishtina " Hasan Prishtina "

Abstract

Background. Malignant diseases and cancers in general are constantly increasing, making it a major public health concern. In 2022, Europe recorded 4.47 million new cases of cancer, with a cumulative risk of 27.9% by the age of 75. Cancer is expected to remain one of the leading causes of death in Europe until 2035.

Aim: The main goal of this research is to present the incidence and prevalence of malignant diseases in Kosovo in 2024.

Material and methods. For this retrospective research, data were taken from the statistical yearbook of Malignant Diseases in Kosovo for the year 2024 and demographic statistics from the last population census in Kosovo REKos 2024 at the Kosovo Agency of Statistics.

Results. In 2024, 3644 new cases of neoplasms (C00-D48), the second group of diagnoses according to the 10th International Classification of Diseases (ICD 10) were reported in Kosovo. Of this number (3644), only one case (0.03%) was benign tumors (D10-D36), four cases or 0.1% were neoplasms of unspecified and unknown features (D37-D48) and the remaining 3639 or 99.9% were malignant neoplasms (C00-C97). The incidence of malignant diseases was 227.1 new cases per 100,000 inhabitants. In 2024, a total of 4620 cases of neoplasms (C00-D48) were reported in Kosovo, of which only five cases (0.1%) were benign tumors (D10-D36), four cases or 0.1% were neoplasms of unspecified and unknown features (D37-D48), three cases (0.1%) were neoplasms in situ (D00-D09), while the remaining 4608 or 99.7% were malignant neoplasms C00-C97. The prevalence of malignant diseases was 288.3 cases per 100,000 inhabitants.

Conclusions. The prevalence and incidence of malignant diseases in Kosovo is high.

Keywords: Malignant diseases, Kosovo, population based registers

Studimi i vitit 2016/2021 për njohuritë, qëndrimet, praktikat dhe sjelljet e popullatës lidhur me sëmundjet jo-ngjitëse në Kosovë dhe përdorimi i gjetjeve në dizajnimin e fushatave ndërgjegjësuere

Elvira Rasimi¹, Mejreme Bajçinovci²

1. Projekti AQH, elvira.rasimi@aqhproject.org

2. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Sfondi dhe Qëllimi:

Projekti “kujdes shëndetësor i qasshëm dhe cilësor” në Kosovë i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim synon të përmirësojë shëndetin e popullatës kosovare përmes fuqizimit të ofruesve dhe menaxherëve të kujdesit shëndetësor për të plotësuar nevojat e pacientëve (veçanërisht grupeve të cenueshme) dhe duke i bërë pacientët më të vetëdijshëm për gjendjen, të drejtat dhe nevojat e tyre. Projekti realizoi këtë studim për të vlerësuar njohuritë, qëndrimet, praktikat dhe sjelljet e popullatës së përgjithshme, veçanërisht duke u përqendruar në grupet e cenueshme, lidhur me sëmundjet e përzgjedhura jo-ngjitëse (SJM) dhe të drejtat e qytetarëve në qasjen në shërbime shëndetësore.

Metodologjia:

Studimi i NJQPS-së përdori dy qasje për grumbullimin e të dhënave, vrojtimin sasior dhe hulumtimin cilësor. Për këtë studim u përdoren mostra të rastësishme, u përzgjedhën 1,200 në 2016 & 2,000 të anketuar (mosha 18 vjeç +) për t’iu përgjigjur një pyetësori sasior, ndërsa të dhënat sasiore u mbledhën nëpërmjet 12/20 diskutimeve në fokus grup.

Rezultatet:

Gjetjet kyçe përfshijnë: 70% në 2016 dhe 45% në 2021 e duhanpirësve, konsumojnë duhanin brenda ambienteve të mbyllura. 65% në 2016 dhe 67% në 2021 e popullatës përdor produkte me sheqer dhe pothuajse gjysma 21% deri 27% shton kripë ose salcë të kripur në ushqim përpara se ta konsumojë atë. 46% në 2016 dhe 31% në 2021 e popullsisë nuk i përmbush rekomandimet e OBSH-së për aktivitetin fizik për shëndetin, me diferencë të madhe mes gjinive. Shumica e popullsisë (75 deri 95%) kanë dëgjuar për diabetin, sëmundjet kardiovaskulare, sëmundjet kronike të frymëmarrjes dhe diarrenë, por njohuritë e tyre rreth faktorëve të rrezikut, shenjat e hershme dhe masat parandaluese janë shumë të ulëta (15-30%). Vetëm (44% në 2016 dhe 47.4% në 2021) e popullatës së përgjithshme dinë për ekzistencën e të drejtave të pacientëve në Kosovë. Kanalet kryesore të komunikimit/informacionit: 52% në 2021 – stafi shëndetësor, të pasuar nga TV/interneti. Këto të gjetura kanë përcaktuar zhvillimin e fushatave dhe intervenimet e projektit, si: lloji i informacionit të dhënë, temat e fushatave/ndërhyrjeve, audiencën/target grupin, përcjellësit të mesazheve, kanalet e komunikimit, etj.

Përfundimet:

Përkundër faktit se shumica e popullsisë ka dëgjuar për një ose më shumë nga sëmundjet kronike, ka një nivel shumë të ulët të kuptimit të faktorëve të rrezikut, shenjat e hershme dhe masat parandaluese. Gjetjet nga këto dy studime kanë qenë udhërefyes në dizajnimin e fushatave dhe intervenimeve të projektit për ndërgjegjësim dhe ndryshim të sjelljeve të popullatës. Duhet të intensifikohen aktivitetet për të ngriur vetëdijen e popullatës lidhur me faktorët e rrezikut, shenjave të hershme dhe masave preventive për SJN-të, gjithmonë duke u bazuar në të gjetura.

2016/2021 Study on Knowledge, Attitudes, Practices and Behaviors of the Population Regarding Non-Communicable Diseases in Kosovo and the Use of Findings in the Design of Awareness Campaigns

Elvira Rasimi¹, Mejreme Bajcinovci²

- 1. AQH Project, elvira.rasimi@aqhproject.org*
- 2. National Institute of Public Health of Kosova*

Background & Aim:

The Accessible Quality Healthcare project in Kosovo funded by the Swiss Agency for Development and Cooperation aims to improve health of the Kosovar population through strengthening healthcare providers and managers to meet the needs of the patients (especially vulnerable groups) and making patients more aware of their rights and needs. The project commissioned this study to assess the knowledge, attitude, practice and behaviour of general population, particularly focusing on vulnerable groups, regarding selected non-communicable diseases (NCDs) and citizens' rights to health.

Methodology:

The KAPB Study used two approaches for data collection, quantitative survey and qualitative research. Using multi-staged random sampling, 1,200 in 2016 & 2,000 in 2021 respondents (age 18 years+) were selected to answer a quantitative questionnaire, with qualitative data collected via 12/20 focus group discussions.

Results:

Key findings include: 70% in 2016 and 45% in 2021 of smokers' smoke indoors. 65% in 2016 and 67% in 2021 of the population use sugary products and almost half (21% to 27%) add salt or salty sauce to food before consuming it. 46% in 2016 and 31% in 2021 of the population do not meet WHO recommendations for physical activity for health, with a large difference between genders. Most of the population (75 to 95%) have heard of diabetes, cardiovascular diseases, chronic respiratory diseases and diarrhea, but their knowledge about risk factors, early signs and preventive measures is very low (15-30%). Only (44% in 2016 and 47.4% in 2021) of the general population knows about the existence of patients' rights in Kosovo. Main communication/information channels: 52% in 2021 – healthcare staff, followed by TV/internet. These findings have determined the development of campaigns and project interventions, such as: type of information provided, campaign/intervention topics, audience/target group, message carriers, communication channels, etc.

Conclusions:

Despite the fact that most of the population has heard of one or more chronic diseases, there is a very low level of understanding of risk factors, early signs and preventive measures. The findings from these two studies have been guiding the design of campaigns and interventions of the project for awareness and behavior change of the population.

Activities should be intensified to raise the awareness of the population regarding risk factors, early signs and preventive measures for NCDs, always based on the findings.

Vdekshmëria nga sëmundjet kardiovaskulare në Kosovë

Musli Gashi^{1,3}, Sanije Hoxha-Gashi^{1,2}

1. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës;

2. Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina";

3. Klinika Emergjente, Qendra Klinike Universitare e Kosovës;

musli.gashi@uni-pr.edu

Abstrakt

Hyrje. Sëmundjet kardiovaskulare janë aktualisht shkaku kryesor i vdekjeve dhe paaftësisë së parakohëshme në mbarë botën. Incidenca e tyre ka trend të rritjes globale dhe trend të njëjtë të rritjes ka edhe i rasteve me sindromë akute koronare që paraqiten për trajtim në qendrat emergjente.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të prezantohet trendi i vdekshmërisë nga sëmundjet kardiovaskulare në Kosovë për periudhën 2012-2021.

Materiali dhe metodat. Ky hulumtim i tipit retrospektiv si material pune ka shfytëzuar publikimet e vjetarëve statistikor të Agjensisë së Statistikave të Kosovës dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës për shkaqet e vdekjeve në Kosovë për periudhën 2012-2021.

Rezultatet. Për periudhën 10 vjeqare 2012-2021 sëmundjet kardiovaskulare janë ranguar si të parat në mesin e shkaqeve të vdekjeve të popullata e Kosovës. Në Kosovë në vitin 2012 janë regjistruar 3393 raste të vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare ose 43.2% e numrit total të vdekjeve atë vit (n=7858). Nga viti në vit kemi pasur rritje të numri të vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare, në vitin 2013 janë raportuar 3549 raste të vdekjeve me rritje prej 4.6% në krahasim me vitin 2012. Në vitin 2021 janë raportuar 4531 raste të vdekjeve nga SKV, 33.5% më shumë se në vitin 2012 (Indeksi bazë 133.5).

Përfundime. Vdekshmëria nga sëmundjet kardiovaskulare në Kosovë ka tendencë të rritjes nga viti në vit prandaj duhet forcuar shërbimet emergjente dhe masat për prevenimin e këtyre sëmundjeve.

Fjalët kyçe: Sëmundjet kardiovaskulare, vdekshmëria, Kosova,

Mortality from cardiovascular diseases in Kosovo

Musli Gashi^{1,3}, Sanije Hoxha-Gashi^{1,2}

1. National Institute of Public Health of Kosova;

2. Medical Faculty, University of Prishtina "Hasan Prishtina";

3. Emergency Clinic, University Clinical Centre of Kosova;

musli.gashi@uni-pr.edu

Abstract

Background: Cardiovascular diseases are currently the leading cause of premature death and disability worldwide. Their incidence is on a global rise, as is the number of cases of acute coronary syndrome presenting for treatment in emergency departments.

Aim: The main purpose of this research is to present the trend in mortality from cardiovascular diseases in Kosovo for the period 2012-2021.

Material and methods: This retrospective research used as working material the statistical yearbooks of the Kosovo Agency of Statistics and the National Institute of Public Health of Kosovo on the Causes of Death in Kosovo for the period 2012-2021.

Results: For the 10-year period 2012-2021, cardiovascular diseases have ranked first among the causes of death in the population of Kosovo. In Kosovo, in 2012, were registered 3393 cases of deaths from cardiovascular diseases or 43.2% of the total number of deaths that year (n=7858). From year to year, we have had an increase in the number of deaths from cardiovascular diseases, in 2013, 3549 cases of deaths were reported with an increase of 4.6% compared to 2012. In 2021, 4531 cases of deaths from CVD were reported, 33.5% more than in 2012 (Base Index 133.5).

Conclusions: Mortality from cardiovascular diseases in Kosovo tends to increase from year to year, therefore emergency services and measures to prevent these diseases must be strengthened.

Keywords: Cardiovascular diseases, Mortality, Kosovo

Vlerësimi i ndërhyrjeve për ndryshimin e sjelljeve shëndetësore përmes Kohortës së Sëmundjeve Kronike Jo-Ngjitëse në Kosovë

Ariana Bytyci Katanolli^{1 2} Naim Jerliu^{2 3} Jana Gerold^{4 5} Valbona Zhjeqi^{2 3} Nicu Fota¹ Iliriana Miftari⁶ Emmanuel Schaffner⁷ Diellza Thaci Bacaj^{2 3} Nicole Probst Hensch^{5 7}

1 Projekti Accessible Quality Healthcare (AQH), Prishtinë, Kosovë

2 Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), Prishtinë, Kosovë

3 Univerziteti i Prishtinës (UP), Fakulteti i Mjekësisë, Prishtina, Kosovo

4 Qendra Zvicerane për Shëndetësi Ndërkombëtare, Swiss Tropical and Public Health Institute (Swiss TPH), Allschwil, Zvicër

5 Univerziteti i Bazelit, Bazel, Zvicër

6 Univerziteti i Prishtinës (UP), Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Prishtinë, Kosovë

7 Departamenti i Epidemiologjisë dhe Shëndetësisë Publike, Swiss Tropical and Public Health Institute (Swiss TPH), Allschwil, Zvicër

Abstrakti

Hyrje: Kohorta e Sëmundjeve Kronike Jo-Ngjitëse në Kosovë (KOSCO), një hulumtim bashkëpunues ndërmjet Swiss TPH, IKSHPK-së dhe UP-së, zbatohet në Kosovë që nga viti 2019.

Qëllimi: Ky hulumtim vlerëson ndikimin e ndërhyrjeve për ndryshimin e sjelljeve shëndetësore në aktivitet fizik, ushqyeshëri, konsumim të duhanit dhe konsumim të alkoholit; janë vlerësuar fazat e ndryshimit të sjelljeve shëndetësore, dhe janë vlerësuar barrierat kryesore ndaj sjelljeve shëndetësore.

Materiali dhe metodat: Ky hulumtim me metodologji mikse është pjesë e hulumtimit KOSCO. Së pari, kemi vlerësuar në mënyrë kuantitative sjelljet shëndetësore dhe fazat e ndryshimit të sjelljeve shëndetësore bazuar në Modelin e Fazave të Ndryshimit. Gjithashtu, janë zhvilluar intervista qualitative me 26 pjesëmarrës të hulumtimit të cilët kanë pranuar këshillim motivues. Të dhënat u analizuan duke përdorur metodën kornizë ‘Framework’ për të përshkruar përvojat dhe perceptimet.

Rezultatet: Hulumtimi kuantitativ: 13% e pjesëmarrësve të hulumtimit janë duhanpirës, 86% nuk u përmbahen rekomandimeve të OBSH-së për aktivitet fizik, 93% nuk konsumojnë fruta dhe perime bazuar në rekomandimet e OBSH-së dhe 61% janë obezë. Studimi kualitativ: Barrierat kryesore për sjelljet e aktivitetit fizik janë: mungesa e ambienteve të jashtme për aktivitet fizik; gjendje e dobët shëndetësore; dhe njohuri e pamjaftueshme për llojet e ushtrimeve fizike.

Përfundimi: Për të përmirësuar sjelljet shëndetësore, sugjerohen këto qasje: a) mekanizëm më i mirë i referimit; b) shërbime të specializuara për ndërprerjen e duhanit; si dhe d) ‘Shëndeti në të gjitha politikat’ për të përmirësuar sjelljet shëndetësore.

Fjalët kyçe: Sëmundjet kronike jo-ngjitëse; sjelljet shëndetësore; kujdesi parësor shëndetësor

Assessment of Behaviour Change Interventions through Kosovo Non-Communicable Disease Cohort Study

Ariana Bytyci Katanolli^{1 2} Naim Jerliu^{2 3} Jana Gerold^{4 5} Valbona Zhjeki^{2 3} Nicu Fota¹ Iliriana Miftari⁶ Emmanuel Schaffner⁷ Diellza Thaci Bacaj^{2 3} Nicole Probst Hensch^{5 7}

1 Accessible Quality Healthcare (AQH) Project, Prishtina, Kosovo

2 National Institute of Public Health of Kosovo (NIPHK), Prishtina, Kosovo

3 University of Prishtina (UP), Medical Faculty, Prishtina, Kosovo

4 Swiss Centre for International Health, Swiss Tropical and Public Health Institute (Swiss TPH), Allschwil, Switzerland

5 University of Basel, Basel, Switzerland

6 University of Prishtina (UP), Faculty of Agriculture and Veterinary, Prishtina, Kosovo

7 Department of Epidemiology and Public Health, Swiss Tropical and Public Health Institute (Swiss TPH), Allschwil, Switzerland

Abstract

Introduction: The Kosovo Non-Communicable Disease Cohort (KOSCO), a collaborative study between the Swiss TPH, NIPHK, and UP, has been implemented in Kosovo since 2019.

Purpose: The AQH project in collaboration with NIPHK are implementing behaviour change interventions to facilitate improvement in lifestyle behaviours. This study assesses the impact of behaviour change interventions on physical activity, nutrition, smoking and alcohol onsumption; participants' stages of health behaviour change, as well as assess the main barriers towards health behaviours.

Materials and methods: This mixed methods study is part of the KOSCO cohort. First, we quantitatively assessed health behaviors, and stages of health behavior change based on the Stages of Change Model. Secondly, qualitative interviews were conducted with 26 cohort participants who received motivational counselling. Data was analyzed using the Framework method to describe experiences and perceptions.

Results: Quantitative study: 13% of study participants are smokers, 86% do not adhere to WHO recommendations for physical activity, 93% do not consume fruits and vegetables based on WHO recommendations, and 61% are obese. Qualitative study: Main barriers for physical activity behaviors are: lack of outdoor facilities for physical activity, weak health conditions, and insufficient knowledge on types of exercises.

Conclusions: To improve the health behaviours, the following tailored approaches are suggested: a) strengthened referral mechanism b) specialized services for smoking cessation; d) 'Health in All Policies' to facilitate health behaviors.

Keywords: non-communicable diseases, lifestyle behaviours, primary healthcare

Kuptimi dhe Menaxhimi: Njohuritë Shëndetësore dhe Menaxhimi i Sëmundjeve Kronike tek të Moshuarit që Vizitojnë Qendrat Komunitare dhe OJQ-të në Prishtinë, Kosovë

Volders, N.J.

Regjistruar në: Fakultetin e Shëndetit, Mjekësisë dhe Shkencave të Jetës, Universiteti i Maastrichtit, Holandë

Praktikë në: Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

naud.volders@gmail.com

Abstrakt

Hyrje: Njohuritë shëndetësore janë një faktor kritik në vetëmenaxhimin efektiv të sëmundjeve kronike, veçanërisht tek të moshuarit të cilët shpesh përdorin sisteme komplekse të kujdesit shëndetësor. Në Kosovë, ku qasja në kujdesin shëndetësor dhe edukimi i pacientëve mund të jenë të kufizuara, të kuptuarit e kësaj marrëdhënieje është jetik për zhvillimin e ndërhyrjeve që i përgjigjen nevojave.

Qëllimi: Ky studim synon të shqyrtojë marrëdhënien midis njohurive shëndetësore dhe menaxhimit të sëmundjeve kronike tek të moshuarit (60 vjeç e lart) në Prishtinë, Kosovë.

Materiali dhe Metodat: Zbatohet një model sasior i prerjes tërthore. Mbledhja e të dhënave është duke vazhduar dhe përdor dy instrumente të validuara: Pyetësin Evropian të Anketës së Njohurive Shëndetësore me 16 pika (HLS-EU-Q16) dhe Inventarin e Vetëkujdesit për Sëmundjet Kronike (SC-CII v3a), i cili përfshin 20 pika. Mostra përfshin afërsisht 100 pjesëmarrës të rekrutuar nëpërmjet OJQ-ve lokale dhe qendrave komunitare. Përveç kësaj, përdoren tre pyetje të hapura për të kapur njohuri cilësore mbi përvojat e pjesëmarrësve me aksesin në kujdesin shëndetësor, kuptimin e menaxhimit të sëmundjeve kronike dhe mbështetjen nga OJQ-të ose qendrat komunitare.

Rezultatet: Rezultatet nuk janë ende finalizuar. Megjithatë, të dhënat e kombinuara sasiore dhe cilësore pritet të ofrojnë njohuri të vlefshme mbi marrëdhënien midis njohurive shëndetësore dhe vetëmenaxhimit të sëmundjeve kronike.

Përfundim: Ky studim do të kontribuojë në kuptimin se si njohuritë shëndetësore ndikojnë në menaxhimin e sëmundjeve kronike tek popullatat e moshuara në Kosovë. Gjetjet mund të udhëheqin përpjekjet mbështetëse të udhëhequra nga OJQ-të dhe të informojnë strategjitë e shëndetit publik në kontekste të ngjashme me burime të ulëta.

Fjalët kyçe: njohuri shëndetësore, sëmundje kronike, të rritur të moshuar, Kosovë, OJQ, metoda të përziera

Temat: Faktorët përcaktues socialë të shëndetit, Sëmundjet jo-ngjitëse (NCDs), Komunikimi shëndetësor dhe Teknologjia e informacionit shëndetësor

Understanding and Managing: Health Literacy and Chronic Disease Management Among Older Adults Visiting Community Centres and NGOs in Prishtina, Kosovo

Volders, N.J.

Enrolled at: Faculty of Health, Medicine & Life Sciences, Maastricht University, Netherlands

Internship at: Faculty of Medicine, University of Prishtina, Kosovo

naud.volders@gmail.com

Abstract

Introduction: Health literacy is a critical factor in effective chronic disease self-management, especially among older adults who often navigate complex healthcare systems. In Kosovo, where healthcare access and patient education may be limited, understanding this relationship is vital for developing responsive interventions.

Purpose: This study aims to examine the relationship between health literacy and chronic disease management among older adults (aged 60 and above) in Prishtina, Kosovo.

Material and Methods: A quantitative cross-sectional design is applied. Data collection is ongoing and uses two validated instruments: the 16-item European Health Literacy Survey Questionnaire (HLS-EU-Q16) and the Self-Care of Chronic Illness Inventory (SC-CII v3a), which includes 20 items. The sample includes approximately 100 participants recruited via local NGOs and community centres. Additionally, three open-ended questions are used to capture qualitative insights into participants' experiences with healthcare access, understanding of chronic disease management, and support from NGOs or community centres.

Results: Results are not yet finalized. However, the combined quantitative and qualitative data are expected to provide valuable insights into the relationship between health literacy and self-management of chronic illness.

Conclusion: This study will contribute to understanding how health literacy influences chronic disease management in older populations in Kosovo. The findings may guide NGO-led support efforts and inform public health strategies in similar low-resource contexts.

Keywords: health literacy, chronic illness, older adults, Kosovo, NGOs, mixed methods

Themes: Social Determinants of Health, Non-Communicable Diseases (NCDs), Health Communication and Health Information Technology

Sëmundjet kronike jongjitëse të raportuara në regjistrin popullativ në Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik- Gjakovë

Besarta Hoxha¹, Sanije Hoxha-Gashi^{2,3}, Mirëllinda Hatashi³

1. Qendra Rajonale e Shëndetit Publik në Gjakovë,

2. Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës” Hasan Prishtina”;

3. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës;

Hyrje: Trendet aktuale në rritjen e popullsisë, shpërndarjen e moshës, dhe dinamikën e sëmundjes parashikojnë rritje në përhapjen e sëmundjeve kronike, gjendjeve të tjera kronike, dhe kombinime të sëmundjeve kronike.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të prezantohet mbikëqyrja e sëmundjeve kronike jo ngjitëse nga prizma e shëndetësisë publike, roli i regjistrit popullativ në mbikëqyrjen e këtyre sëmundjeve dhe shkalla e raportimit të tyre në njësinë e SISH në Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik (QRSHP) në Gjakovë.

Materiali dhe metodat: Ky hulumtim i tipit deskriptiv-analitik ka shfrytëzuar si material pune fletëparaqitjen e sëmundjeve kronike jongjitëse. Gjithashtu është shfletuar literatura dhe webfaqja e OBSH për të analizuar hulumtimet tjera shtesë që bëhen për menaxhimin e sëmundjeve kronike jo ngjitëse. Pjesa e tjetër e hulumtimit është retrospektive dhe ka shfrytëzuar të dhënat për vitin 2023 dhe 2024 të sëmundjeve kronike jo ngjitëse të raportuara nga institucionet shëndetësore publike dhe private të komunës së Gjakovës në QRSHP - Gjakovë.

Rezultatet: Në Kosovë fletëparaqitja e sëmundjeve kronike jo ngjitëse raportohet në regjistrin popullativ për sëmundje kronike jo ngjitëse. Ekziston strukturë menaxhuese qartë e definuar në IKSHPK përmes regjistrit popullativ në Departamentin e SISH në IKSHPK dhe njësive të SISH në gjashtë QRSHP. Mungon infrastruktura softuerike adekuate për menaxhimin më të lehtë dhe me të dhëna të plota. Ndonëse kemi rritje të shkallës së raportimit në vitin 2024 në krahasim me 2023 të SKJN në njësinë e SISH në QRSHP Gjakovë akoma nuk jemi të kënaqur me shkallën e raportimit. Në vitin 2023 janë raportuar 5512 raste me sëmundje kronike nga komuna e Gjakovës prej të cilave 3168 ose 57.5% të gjinisë femërore dhe 2344 ose 42.5% të gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës më shumë se gjysma 52.7% ishin të grup-moshës 40-64 vjet dhe 38.8% të 65 e më shumë vjet. Me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe gjinisë nuk kemi fituar dallim me sinifikancë të rëndësishme statistikore ($P>0.05$). Në vitin 2024 janë raportuar 6030 raste me sëmundje kronike prej të cilave 3437 ose 57.0% të gjinisë femërore dhe 2593 ose 43.0% të gjinisë mashkullore. Sipas grup-moshës më shumë se gjysma 53.6% ishin të grup-moshës 40-64 vjet dhe 37.6% të 65 e më shumë vjet. Me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe gjinisë nuk kemi fituar dallim me sinifikancë të rëndësishme statistikore ($P>0.05$).

Përfundime. Sëmundjet kronike jongjitëse janë prezente te popullata e komunës së Gjakovës dhe nevojiten aksione urgjente për prevenimin e tyre.

Fjalët kyçe: Sëmundjet Kronike Jongjitëse, regjistri popullativ, Gjakovë

Chronic non-communicable diseases reported in the population-based registry at the Regional Center for Public Health – Gjakova

Besarta Hoxha¹, Sanije Hoxha-Gashi^{2,3}, Mirëllinda Hatashi³

1. Regional Center for Public Health – Gjakova;

2. Medical Faculty, University of Prishtina” Hasan Prishtina”;

3. National Institute of Public Health of Kosovo;

Background. Current trends in population growth, age distribution, and disease dynamics predict an increase in the prevalence of chronic diseases, other chronic conditions, and combinations of chronic diseases. Such trends threaten both public health and the financial health of a country. **Aim:** The main goal of this research is to present the surveillance of chronic non-communicable diseases from the perspective of public health, the role of the population registry in the surveillance of these diseases and the rate of their reporting to the HIS unit at the Regional Center for Public Health (RCPH) in Gjakova.

Material and methods. This descriptive-analytical research used as working material the chronic non-communicable diseases form. Literature and the WHO website were also reviewed to analyze other additional research conducted on the management of chronic non-communicable diseases. The rest of the research is retrospective and used data for 2023 and 2024 on chronic non-communicable diseases reported by public and private health institutions of the municipality of Gjakova in the QRSHP in Gjakova.

Results. In Kosovo, the presentation of chronic non-communicable diseases is reported in the population-based registry for chronic non-communicable diseases. There is a clearly defined management structure in the NIPHK through the population registry in the Department of SISH in the NIPHK and the HIS units in the six RCPH. There is a lack of adequate software infrastructure for easier management and complete data. Although we have an increase in the reporting rate in 2024 compared to 2023 of the NCD in the HIS unit in the RCPH Gjakova, we are still not satisfied with the reporting rate. In 2023, 5512 cases of chronic diseases were reported from the municipality of Gjakova, of which 3168 or 57.5% were female and 2344 or 42.5% were male. By age group, more than half, 52.7%, were in the 40-64 age group and 38.8% were 65 and over. With the distribution of cases by age group and gender, we did not obtain a statistically significant difference ($P>0.05$). In 2024, 6030 cases of chronic diseases were reported, of which 3437 or 57.0% were female and 2593 or 43.0% were male. By age group, more than half, 53.6%, were 40-64 age group and 37.6% were 65 and over. By distributing cases by age group and gender, we did not obtain a statistically significant difference ($P>0.05$).

Conclusions. Risk factors for chronic non-communicable diseases are present in the population of the municipality of Gjakova and urgent actions are needed to prevent them.

Keywords: Chronic Non-Communicable Diseases, population-based registry, Gjakova

Aktivitetet fizike inovative në humbjen e peshës, djegien e yndyrës trupore dhe synimin për zemër sportive

Bahri Sopa

Abstrakt

Ndikimi i aktiviteteve fizike inovative në humbjen e peshës, djegien e yndyrës trupore dhe synimin e shëndrrimit të muskulaturës kardiake në atë sportive. Ndikimi i aktivitetit fizik i kombinuar me një ushqim të balansuar natyral dhe mbështetje emocionale është shumë e rëndësishme për arritjen e suksesit për një shoqëri të shëndetshme.

Kjo punë hulumtuese ka dëshmuar se aktiviteti fizik inovativ 2 deri 4 minuta të cilat i përgjigjen 30 minutave ecje në kalori, por me përfitime më të mëdha shëndetësore sepse ky aktivitet është edhe me rritje të pulsit që ka qenë faktor kryesor në punën e institucionit legal që individët të humbin peshë, djegin yndyrën trupore dhe të krijojnë kushte për një zemër sportive.

Hulumtimet janë realizuar me metodën kuantitative tek 800 individ të moshës 18 deri 85 vjet për humbjen e peshës dhe 607 persona për djegien e yndyrës trupore, matjet janë realizuar me aparatin Tanita InnerScanV BC-545N, ndërsa transformimi i muskulaturës normale kah ajo sportive është realizuar tek 980 që nga mosha 4 vjeçe deri 85 vjeç me metodën mekanike të matjes së pulsit me gishtërinjë.

Rezultatet e hulumtimit treguan lidhjen e aktivitetit fizik inovativ me kohë të shkurtër me ushqime natyrale dhe mbështetje emocionale ka përfitime të mëdha shëndetësore pasi që trupi jonë forcohet aq sa ka nevojë. Aktivitetet fizike inovative janë ofertë e mirë për popullatën gjithashtu rekomandim i OBSH-së.

Fjalët kyqe: Aktivitet fizik inovativ, peshë, yndyrë

Innovative physical activities in losing weight, burning body fat and aiming for a sporty heart

Bahri Sopa

Abstract

The impact of innovative physical activities on weight loss, burning body fat and aiming to transform cardiac muscle into sports muscle. The impact of physical activity combined with a balanced natural diet and emotional support is very important for achieving success for a healthy society.

This research work has proven that innovative physical activity 2 to 4 minutes which correspond to 30 minutes of walking in calories, but with greater health benefits because this activity is also with increased pulse which has been a key factor in the work of the legal institution for individuals to lose weight, burn body fat and create conditions for a sports heart.

The research was conducted using a quantitative method on 800 individuals aged 18 to 85 years for weight loss and 607 people for body fat burning, measurements were taken with the Tanita InnerScanV BC-545N device, while the transformation of normal to athletic musculature was carried out on 980 from the age of 4 to 85 years with the mechanical method of measuring the pulse with fingers.

The results of the research showed that the connection of innovative physical activity with short periods of time with natural foods and emotional support has great health benefits since our body is strengthened as much as it needs. Innovative physical activities are a good offer for the population and are also recommended by the WHO.

Keywords: Innovative physical activity, weight, fat

Njohuritë e popullatës për diagnostifikimin e hershëm të sëmundjeve malinje

Fatjona Elshani ¹, Rina Hoxha ^{1,2}, Mejreme Bajçinovci ^{1,2}

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

² Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

fatjona.elshani1@student.uni-pr.edu

Abstrakt

Hyrja: Sëmundja malinje nënkupton ndarjen e pakontrolluar të qelizave anormale, që mund të invadojnë në indet përreth dhe në pjesë të tjera të trupit përmes gjakut dhe sistemit limfatik. Zbulimi i hershëm ulë vdekshmërinë nga kanceri duke mundësuar trajtim më efektiv.

Qëllimi: Qëllimi i këtij hulumtimi është të vlerësohet niveli i njohurive të popullatës mbi diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve malinje, duke theksuar rëndësinë e tij në trajtim dhe parandalim.

Materiali dhe metodologjia: Hulumtimi i tipit Transversal Cross - sectional duke përdorur metodën deskriptive të të dhënave, dhe realizuar përmes platformës së Google Form me gjithsej 13 pyetje. Në hulumtim kanë marrë pjesë 50 persona të moshave të ndryshme nga 100 të planifikuar. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar dhe organizuar nga Excel, si dhe janë prezantuar në formë të grafikoneve dhe tabelave të ndryshme, ndërsa të dhënat janë testuar me χ^2 -test për nivelin e besueshmërisë së përgjigjeve të dhëna $p < 0.5$ dhe $p < 0.01$.

Rezultatet: Sipas të dhënave të mbledhura, 90% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se janë të njohur me termin “Diagnostikim i hershëm i sëmundjeve malinje”, ndërsa një përqindje dukshëm më e ulët, prej 10%, nuk kanë dëgjuar më parë për këtë term. Nga pjesëmarrësit, 6% nuk janë të informuar mbi simptomat e hershme të sëmundjeve malinje, ndërsa 94% kanë njohuri lidhur me to, ku 72% e tyre vlerësojnë se simptoma kryesore është “Lodhja e vazhdueshme”. Nga gjithsej 50 pjesëmarrës, 16% e tyre kanë deklaruar se “Nuk dine” për metodat diagnostike për zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje, ndërsa 84% e tyre kanë njohuri rreth këtyre metodave. Ndër metodat diagnostike, “Mamografia” rezulton të jetë më e njohura, e përmendur nga 74% e pjesëmarrësve.

Konkluzioni: 90% e pjesëmarrësve të anketuar kanë deklaruar se janë të njohur me termin “Diagnostikim i hershëm i sëmundjeve malinje”.

Fjalët kyçe: Sëmundje malinje, diagnostikim i hershëm, pjesëmarrës, njohuritë.

Knowledge of the population for early diagnosis of malignant diseases

Fatjona Elshani¹, Rina Hoxha^{1,2}, Mejreme Bajcinovci^{1,2}

¹Faculty of Medicine, University of Prishtina

²National Institute of Public Health of Kosova

fatjona.elshani1@student.uni-pr.edu

Abstract

Introduction: Malignant disease refers to the uncontrolled division of abnormal cells, which can invade surrounding tissues and spread to other parts of the body through the blood and lymphatic system. Early detection reduces cancer mortality by enabling more effective treatment.

Objective: The aim of this research is to assess the population's level of knowledge regarding the early diagnosis of malignant diseases, emphasizing its importance in treatment and prevention.

Materials and Methodology: This is a cross-sectional study utilizing a descriptive method for data collection, conducted through the Google Forms platform with a total of 13 questions. Fifty individuals of different ages participated in the study out of the 100 initially planned. The collected data were processed and organized using Excel and presented in the form of various graphs and tables. The data were analyzed using the Chi-square (χ^2) test to determine the reliability level of the given responses, with significance levels set at $p < 0.5$ and $p < 0.01$.

Results: According to the collected data, 90% of the participants stated that they are familiar with the term "Early Diagnosis of Malignant Diseases," while a significantly lower percentage, 10%, reported that they had not heard of the term before. Among the participants, 6% were not informed about the early symptoms of malignant diseases, whereas 94% demonstrated knowledge in this area, with 72% identifying "persistent fatigue" as the main symptom. Out of the 50 participants, 16% declared that they "do not know" about the diagnostic methods for early detection of malignant diseases, while 84% reported being aware of such methods. Among the diagnostic methods, "Mammography" was found to be the most recognized, mentioned by 74% of participants.

Conclusion: 90% of the surveyed participants reported being familiar with the term "Early Diagnosis of Malignant Diseases."

Keywords: Malignant disease, early diagnosis, participants, knowledge.

izimi i rasteve me skizofreni në Qendrën e Shëndetit Mendor në Ferizaj gjatë vitit 2024

Rita Reçica ¹

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

rita.recica2@student.uni-pr.edu

Abstrakt

Hyrja: Skizofrenia është sëmundje kronike e trurit. Është sëmundje aktuale që përfshinë 0.5% deri 1% të popullatës në botë. Sipas OBSH skizofrenia prek 1 në 300 njerëz(0.32%) në tërë globin. Ndryshe për emrin skizofreni përdoret terminologjia “dementia praecox”.

Qëllimi: Qëllimi i këtij hulumtimi është analizimi i rasteve me diagnozën e skizofrenisë të trajtuara në QSHM në Ferizaj për vitin 2024 dhe atë sipas gjinisë dhe moshës.

Materiali dhe Metodologjia: Hulumtimi është raport i rasteve me komponentën deskriptive. Të dhënat janë marr nga arkiva e QSHM në Ferizaj për rastet e trajtuara në vitin 2024. Përpunimi I të dhënave është bërë me programin excel dhe janë prezantuar me tabela dhe grafikone perkatëse.

Rezultatet: Raporti i rasteve në mes gjinisë femër dhe mashkull është 1.52:1 respektivisht 60.26% (890) raste tek meshkujt dhe 39.74%(587)raste tek femrat. Grup mosha që ka vlerë më të larta të rasteve të skizofrenisë është 45-54vjet me 45.77%(676) kurse vlera më të ulëta të rasteve është grup moshat 20-24 me 3.11% (46). Analizuar sipas muajve numri me i lartë është regjistruar tek femrat në muajin janar me 5.62% (83), tek meshkujt me tepër në muajin korrik me 6.57%(97).

Përfundimi: Në bazë të rezultatet e fituar duke analizuar rastet e skizofrenisë sipas gjinisë dhe grupmoshën në vitin 2024, shohim se rastet e skizofrenisë janë relativisht të larta për komunën e Ferizajit andaj duhet te fuqizohen komunitetet e shëndetshme në parandalimin e kesaj semundje.

Fjalët kyqe: Skizofrenia, Qendra e Shendetit Mendor, Ferizaj

Analysis of schizophrenia at the mental health center in Ferizaj during 2024

Rita Reçica ¹

¹ Faculty of Medicine, University of Prishtina

rita.recica2@student.uni-pr.edu

Abstract

Introduction: Schizophrenia is a chronic brain disease. It is a current disease that affects 0.5% to 1% of the world's population. According to the WHO, schizophrenia affects 1 in 300 people (0.32%) worldwide. This terminology “dementia praecox” is used alternatively for the name schizophrenia.

Purpose: The purpose of this research is to analyze cases with diagnosis of schizophrenia treated at the Ferizaj Mental Health Center for the year 2024, according to gender and age.

Material and methodology: This research is a case report with a descriptive component. This data were taken from the archive of the Mental Health Center in Ferizaj for cases treated in 2024. The data were processed with excel program and presented with relevant tables and graphs.

Results: The ratio of cases between the female and male genders is 1.52:1 respectively 60.92% (890) cases in males and 39.74% (587) cases in females. The age group with highest number of schizophrenia cases is 45-54 years with 45.77% (676) while the lowest number of cases is the age group 20-24 with 3.11% (46). The highest number of cases presented in females is in January with 5.62% (83), while in males the highest number of cases is in July with 6.57% (97).

Conclusion: Based on the results obtained by analyzing schizophrenia cases by gender and age group, in 2024 we see that schizophrenia cases are relatively high for the municipality of Ferizaj, therefore health communities must be empowered to prevent this disease.

Keywords: Schizophrenia, Mental Health Center, Ferizaj

- V -

Faktorët e rriskut dhe komunikimi

Risk Factors and communication

Parandalimi i sëmundjeve jo të transmetueshme në Kosovë: Vlerësimi i sesioneve këshilluese motivuese për stile të jetesës më të shëndetshme në kujdesin parësor shëndetësor

Naim Jerliu^{1,2}, Ariana Bytyçi Katanolli^{2,3}, Jana Gerold^{4,5}, Nicu Fota³, Pranvera Krasniqi², Valbona Zhjeki^{1,2}, Diellza Thaçi Bacaj^{1,2}, Probst Hensch Nicole^{5,6}

¹ Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë, Kosovë

² Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, Prishtinë, Kosovë

³ Projekti për Kujdes Shëndetësor të Qashtëm dhe Cilësor, Prishtinë, Kosovë

⁴ Qendra Zvicerane për Shëndet Ndërkombëtar, Instituti Zviceran për Shëndet Tropikal dhe Publik (Swiss TPH), Allschwil, Zvicër

⁵ Universiteti i Bazelit, Bazel, Zvicër

⁶ Departamenti i Epidemiologjisë dhe Shëndetit Publik, Instituti Zviceran për Shëndet Tropikal dhe Publik (Swiss TPH), Allschwil, Zvicër

Hyrje: Pirja e duhanit, mungesa e aktivitetit fizik, konsumimi i ulët i frutave dhe perimeve, si dhe obeziteti janë të zakonshme në Kosovë. Qendrat e kujdesit parësor shëndetësor në Kosovë janë duke zbatuar një ndërhyrje në të cilën infermierët ofrojnë seanca individuale këshillimi motivues për pacientët për një stil jete më të shëndetshëm.

Qëllimi: Ky studim vlerëson përfshirjen në këshillimin motivues dhe ndikimin në përmbytjen ndaj sjelljeve shëndetësore dhe fazat e ndryshimit të sjelljeve shëndetësore të pjesëmarrësve. Për më tepër, studimi synon të përshtatë qasjet për përmirësimin e sjelljeve shëndetësore të shfytëzuesve të kujdesit parësor dhe të ofrojë dëshmi për zgjerimin e ndërhyrjes në nivel të kujdesit parësor shëndetësor.

Material dhe metodat: Pjesëmarrësit në studim (n=891) u rekrutuan nga 12 komuna pjesëmarrëse në studimin e Kohortës së Sëmundjeve Jo të Transmetueshme në Kosovë (KOSCO). U vlerësua në mënyrë sasiore përfshirja në këshillimin motivues, sjelljet shëndetësore dhe fazat e ndryshimit të sjelljeve shëndetësore. Secili pjesëmarrës dha deri në katër vetë-raportime mbi ushqimin dhe aktivitetin fizik.

Rezultatet: U vërejt një shkallë e lartë e obezitetit (53.1%), si dhe nivele të larta të diagnozave të vetë-raportuara me diabet (57.1%) dhe hipertension (62.6%). Vetëm 22% e pjesëmarrësve të kualifikuar në komunat me ndërhyrje morën këshillim motivues. 19.2% e mostrës së studimit ishin duhanpirës, dhe nga ata, 55.5% ishin në fazën e paramendimit (precontemplation) për ndryshimin e sjelljes ndaj pirjes së duhanit. 63.1% e mostrës së studimit nuk përmbytshin rekomandimet e OBSH-së për aktivitet fizik, nga të cilët 65.6% e grave nuk i zbatojnë këto rekomandime.

Përfundim: Rezultatet ofrojnë dëshmi mbi efektin e ndërhyrjes për ndryshimin e sjelljes në promovimin e aktivitetit fizik dhe sjelljeve ushqimore në kontekstin e Kosovës.

Fjalë kyçe: kujdesi parësor shëndetësor, sëmundjet jo të transmetueshme, ndërhyrje për ndryshim të sjelljes

Non-communicable disease prevention in Kosovo: assessment of motivational counselling sessions for healthier lifestyles in primary healthcare

Naim Jerliu^{1,2} Ariana Bytyci Katanolli^{2,3} Jana Gerold^{4,5} Nicu Fota³ Pranvera Krasniqi² Valbona Zhjeqi^{1,2} Diellza Thaci Bacaj^{1,2} Probst Hensch Nicole^{5,6}

¹ University of Prishtina, Medical Faculty, Prishtina, Kosovo

² National Institute of Public Health Kosovo, Prishtina, Kosovo

³ Accessible Quality Healthcare Project, Prishtina, Kosovo

⁴ Swiss Centre for International Health, Swiss Tropical and Public Health Institute (Swiss TPH), Allschwil, Switzerland

⁵ University of Basel, Basel, Switzerland

⁶ Department of Epidemiology and Public Health, Swiss Tropical and Public Health Institute (Swiss TPH), Allschwil, Switzerland

Introduction: Smoking, physical inactivity, low fruit and vegetable consumption, and obesity are common in Kosovo. Primary healthcare centres in Kosovo are implementing an intervention where nurses deliver one-on-one motivational counselling sessions to patients for healthier lifestyles.

Purpose: This study assesses the uptake of motivational counselling and the impact on adherence to health behaviors and participants' stages of health behavior change. In addition, this study aims to tailor approaches for improving health behaviours of PHC users and provide evidence to scale up the PHC intervention.

Material and Methods: Study participants (n=891) were recruited from 12 municipalities participating in the Kosovo Non-Communicable Disease Cohort (KOSCO) study. We quantitatively assessed the uptake of motivational counselling, health behaviors, and stages of health behavior change. Each participant contributed up to four self-reports of nutrition and physical activity.

Results: There was a high rate of obesity 53.1%, and high rates of self-reported diagnoses of diabetes 57.1% and hypertension 62.6%. Motivational counselling was received by only 22% of the eligible participants in the intervention municipalities. 19.2% of the study sample were smokers, and among those, 55.5% were in the precontemplation stage for changing smoking behavior. 63.1% of the study sample do not adhere to WHO recommendations for physical activity, of which 65.6% of women do not comply with these recommendations.

Conclusion: The results show evidence of the effect of behaviour change intervention in promoting physical activity and nutritional behaviour in the Kosovo context.

Keywords: primary healthcare, non-communicable diseases, behaviour change intervention

“Tetori Rozë” në Shqipëri – Fuqizimi i Komuniteteve përmes Edukimit Shëndetësor dhe Shqyrtimit Mobil të Kancerit të Gjirit

Rudina Çumashi¹, Romina Hala¹, Gentiana Qirjako^{1,2}

¹*Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë, Shqipëri.*

²*Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri.*

Kanceri i gjirit është kanceri më i zakonshëm tek gratë dhe një shqetësim i madh për shëndetin publik. Zbulimi i hershëm përmirëson ndjeshëm rezultatet, megjithatë qasja në shqyrtim mbetet e kufizuar në shumë fusha. Objektivi i fushatës “Tetori Rozë” është të rrisë ndërgjegjësimin dhe të promovojë zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit përmes edukimit dhe shërbimeve falas të mamografisë mobile.

Që nga viti 2015, Instituti i Shëndetit Publik, në bashkëpunim me profesionistë lokalë të edukimit dhe promovimit shëndetësor, ka zbatuar fushatën “Tetori Rozë” çdo tetor. Fushata përfshin vendosjen e njësisë të mamografisë mobile në rajone të pashërbyera, duke synuar gratë e moshës 50+ dhe ato me faktorë rreziku. Aktivitetet edukative dhe fushatat mediatike plotësojnë përpjekjet e shqyrtimit për të rritur ndërgjegjësimin publik.

Ekzaminimi i hershëm përmirëson shkallën e mbijetesës, por pjesëmarrja shpesh ndikohet nga faktorët e sjelljes dhe kulturës, siç janë besimet dhe normat shoqërore. Të kuptuarit e këtyre faktorëve është çelësi për zhvillimin e strategjive që rrisin pjesëmarrjen në ekzaminim dhe zvogëlojnë pabarazitë në rezultate. Për të eksploruar këtë aspekt, ne kryem një studim tërthor duke përdorur një pyetësor online për të vlerësuar faktorët e sjelljes dhe kulturës që ndikojnë në përfshirjen e ekzaminimit të kancerit të gjirit tek gratë.

Fushata ka çuar në një rritje vjetore të numrit të grave që i nënshtrohen mamografisë dhe atyre që janë informuar rreth faktorëve të rrezikut të kancerit të gjirit dhe sjelljeve parandaluese. Ajo ka mundësuar aksesin në ekzaminimin e hershëm në zonat e largëta dhe ka forcuar bashkëpunimin midis strukturave shëndetësore kombëtare dhe lokale. Angazhimi i medias ka amplifikuar shtrirjen e mesazheve të shëndetit publik.

"Tetori Rozë" është një model efektiv për fuqizimin e komunitetit përmes edukimit të integruar shëndetësor dhe ofrimit të shërbimeve. Ai demonstroi se si përpjekjet e synuara, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme mund të rrisin zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit dhe të promovojnë praktikatat shëndetësore parandaluese.

Kyçet kyçe: edukim shëndetësor, kanceri i gjirit, zbulimi i hershëm, fuqizimi i komunitetit

“Pink October” in Albania – Empowering Communities through Health Education and Mobile Breast Cancer Screening

Rudina Çumashi², Romina Hala², Gentiana Qirjako^{1,2}

¹Institute of Public Health, Tirana, Albania.

²Faculty of Medicine, University of Medicine, Tirana, Albania.

Breast cancer is the most common cancer among women and a major public health concern. Early detection significantly improves outcomes, yet access to screening remains limited in many areas. The objective of the “Pink October” campaign is to raise awareness and promote early breast cancer detection through education and free mobile mammography services.

Since 2015, the Institute of Public Health, in collaboration with local health education and promotion professionals, has implemented the “Pink October” campaign each October. The campaign involves deploying mobile mammography units to underserved regions, targeting women aged 50+ and those with risk factors. Educational activities and media campaigns complement screening efforts to raise public awareness.

Early screening improves survival rates, but participation is often influenced by behavioural and cultural factors, such as beliefs and societal norms. Understanding these factors is key to developing strategies that increase screening participation and reduce disparities in outcomes. To explore this aspect, we conducted a cross-sectional study using an online questionnaire to assess behavioural and cultural factors influencing breast cancer screening uptake among women.

The campaign has led to a yearly increase in the number of women undergoing mammography and those informed about breast cancer risk factors and preventive behaviors. It has enabled access to early screening in remote areas and has strengthened collaboration between national and local health structures. Media engagement has amplified the reach of public health messages.

“Pink October” is an effective model for community empowerment through integrated health education and service delivery. It demonstrates how targeted, inclusive, and sustained efforts can increase early detection of breast cancer and promote preventive health practices.

Keywords: health education, breast cancer, early detection, community empowerment

Edukimi shëndetësor dhe mjedisor i Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian

*Adnora Nurboja, Lendita Krasniqi, Elvana Krasniqi, Art Nurboja
Qendra Rajonale e Shëndetit Publik Pejë, QKMF Pejë, IKSHPK
Adnora.Nurboja@rks-gov.net adnoranurboja@hotmail.com*

Abstrakt

Hyrje: Projekti “Edukimi Mjedisor dhe Shëndetësor për Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian në lagjen 7 Shtatori” është realizuar në vitin 2023 i financuar nga SIDA, u përkrah nga Danish Refugee Council dhe u impementua nga OJQ “Let’s do it Pejë” dhe QRSHP Pejë, në Lagjen “7 Shtatori”, në qytetin e Pejës.

Qëllimi: Qëllimi i punimit është rritja e vetëdijes për shëndetin e mjedisit, shëndetin në përgjithësi dhe përmirësimin e qasjes në shërbimet shëndetësore për familjet e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që jetojnë në Lagjen “7 Shtatori” në Pejë, dhe përmes aktiviteteve të kontribuohet në përmirësimin e mjedisit jetësor të tyre.

Materiali dhe metodat: Është përdorur një pyetësor gjysëm të strukturuar. Janë anketuar 67 familje me gjithsej 371 anëtarë të familjeve, nga ku një familje ka refuzuar anketimin. Përgjigjet janë marrë nga kryefamiljarët, pra janë plotësuar për familje. Pas përpunimit të të dhënave nga pyetësorët, janë realizuar 12 aktivitete të ndryshme si ligjërata dhe trainime duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e tyre si: Rreziku nga ndotja e ajrit dhe nga mbeturinat, Mbrojtja e mjedisit shtëpiak dhe sanitar, Vaksinimi, Parandalimi i IST/SST dhe shtatëzënive të hershme, Qasje në institucione publike shëndetësore. Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave është bërë në QRSHP Pejë.

Rezultatet: Nga të anketuarit (kryefamiljarët) 53% janë meshkuj e 47% janë femra. 81% janë të papunë e 19% të punësuar. 64% kanë shumë pak informata për sistemin e shërbimeve shëndetësore, 36% kanë mjaftueshëm informata. 62% prej tyre nuk i shfrytëzojnë institucionet publike shëndetësore, 90% kanë deklaruar se kanë probleme të ndryshme shëndetësore. Vetëm 41% e fëmijëve janë të vaksinuar. 19% punojnë si mbledhës të mbeturinave, prej të cilëve 69% përdorin masa mbrojtëse.

Përfundim: Shqetësuese është vetëdijësimi i ultë dhe edukimi shëndetësor i ultë në përgjithësi në të gjitha temat e trajtuara shëndetësore dhe mjedisore e që drejtperdrejtë reflekton në cilësinë e jetës dhe mjedisit në të cilin jetojnë. Siguria e ujit është e kënaqshme pasi që furnizohen nga ujësjellësi, pra uji është i kontrolluar. Vaksinimi si term është i njohur, por nuk kanë njohuri për rëndësinë e vaksinimit. IST/SST dhe shëndeti para lindjes janë tema tabu për të cilat nuk diskutojnë fare dhe nuk kanë informata për parandalim.

Fjalët kyqe: komunitet, edukim shëndetësor, mjedis

Health and Environmental Education of the Roma, Ashkali and Egyptian Community

Adnora Nurboja, Lendita Krasniqi, Elvana Krasniqi, Art Nurboja
Regional Center of Public Health of Peja, MFHC Peja, NIPH of Kosova
Adnora.Nurboja@rks-gov.net adnoranurboja@hotmail.com

Abstract

Introduction: The project "Environmental and Health Education for the Roma, Ashkali and Egyptian Communities in the "7 Shtatori Neighborhood" was carried out in 2023, funded by SIDA, supported by the Danish Refugee Council and implemented by the NGO "Let's do it Peja" and RCPH Peja, in the "7 Shtatori" Neighborhood, in the city of Peja.

Purpose: The purpose of this paper is to increase awareness of environmental health, health in general and to improve access to health services for families of the Roma, Ashkali and Egyptian communities living in the "7 Shtatori" Neighborhood in Peja, and through activities to contribute to the improvement of their living environment.

Material and method: We used a semi-structured questionnaire. 67 families with a total of 371 family members were surveyed, of which one family refused the survey. The answers were obtained from the householders, so they were completed for each family. After processing the data from the questionnaires, 12 different activities were carried out, such as lectures and trainings, based on their requests and needs, such as: Risk from air pollution and waste, Protection of the home and sanitary environment, Vaccination, Prevention of STI/STD and early pregnancies, Access to Public Health institutions. Data collection and processing was done at the Regional Center of Public Health in Peja.

Results: Of the respondents (householders), 53% are male and 47% are female. 81% are unemployed and 19% are employed. 64% have very little information about the health service system, 36% have sufficient information. 62% of them do not use public health institutions, 90% have declared that they have various health problems. Only 41% of children are vaccinated. 19% work as garbage collectors, of which 69% use protective measures.

Conclusion: The low awareness and low health education in all health and environmental topics addressed, is worrying and directly reflects on the quality of life and the environment in which they live. Water safety is satisfactory since they are supplied by the water supply, so the water is controlled. Vaccination as a term is known, but they do not have knowledge about the importance of vaccination. STI/STD and prenatal health are taboo topics that they do not discuss at all and do not have information about prevention.

Keywords: community, health education, environment

Cilësia e ajrit të brendshëm në amvisëritë e Komunës së Prishtinës

Ukëhaxhaj. A¹, Binçe. E¹, Zogaj. D¹, Jaka. A¹, Sutaj. B¹, Krasniqi. K¹, Zuka. A¹, Halimi. B¹

¹Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, Prishtinë

Antigona.ukëhaxhaj@rks-gov.net

Abstrakt

Hyrje: Në shekullin e 21-të, 2.8 miliardë njerëz ende mbështeten në lëndët djegëse të ngurta duke përdorur stufa të thjeshta për gatim dhe ngrohje, duke shkaktuar rreth 4 milionë vdekje të parakohshme në vit mes fëmijëve dhe të rriturve nga sëmundjet e frymëmarrjes, kardiovaskulare dhe kanceri. Afro 3 miliardë njerëz në mbarë botën, i nënshtrohen emetimeve të substancave të rrezikshme nga ndërtesat, materialet e ndërtimit dhe pajisjet e ndërtimit ose pirja e duhanit, sistemet e ventilimit, dhe mobiljet.

Qëllimi: Të identifikoj ekspozimin ndaj ndotjes së ajrit brenda amvisërive në Komunën e Prishtinës.

Materiali dhe metodat: Mostrat u morën në 20 amvisëri, gjatë muajve janar - mars 2025 në komunën e Prishtinës.

Rezultatet: Bazuar në gjetjet tona, lloji i ngrohjes kishte një efekt më të fortë në dimër. Vlerat e NO₂ jashtë ishin minialet 20.1 µg/ m³ deri në 123 µg/ m³, përqendrime të fomaldehideve ishin maksimale 21.8 µg/ m³ jashtë dhe 26.2 µg/ m³ brenda, ndërsa mesataret miniale për PM_{2.5} ishin 10.1 µg/ m³ deri në 103 µg/ m³ si mesataret maksimale të tyre.

Përfundimi: Ndotja e ajrit është një çështje e rëndësishme në Kosovë, dhe barra e sëmundjeve e lidhur me ekspozimin ajrit të brendshëm është një shqetësim në rritje si në Kosovë ashtu edhe në mbarë botën. Prandaj, programet sistematike të monitorimit dhe mbikëqyrjes duhet të zhvillohen në të gjithë vendin për të përmirësuar cilësinë e ajrit të brendshëm.

Fjalët kyçe: amvisëritë, ajri i brendshëm, ndotësit

Indoor air quality in households in the Municipality of Pristina

Ukëhaxhaj. A¹, Binçe. E¹, Zogaj. D¹, Jaka. A¹, Sutaj. B¹, Krasniqi. K¹, Zuka. A¹, Halimi. B¹

¹National Institute of Public Health, Pristina

Antigona.ukëhaxhaj@rks-gov.net

Abstract

Introduction: In the 21st century, 2.8 billion people still rely on solid fuels using simple stoves for cooking and heating, causing an estimated 4 million premature deaths per year among children and adults from respiratory, cardiovascular and cancer diseases. Nearly 3 billion people worldwide are exposed to emissions of hazardous substances from buildings, construction materials and construction equipment or from smoking, ventilation systems and furniture.

Purpose: To identify exposure to air pollution within households in the Municipality of Pristina.

Material and methods: Samples were taken from 20 households, during the months of January - March 2025 in the Municipality of Pristina.

Results: Based on our findings, the type of heating had a stronger effect in winter. Outdoor NO₂ values were minimum 20.1 µg/ m³ to 123 µg/ m³, formaldehyde concentrations were maximum 21.8 µg/ m³ outdoors and 26.2 µg/ m³ indoors, while minimum averages for PM_{2.5} were 10.1 µg/ m³ to 103 µg/ m³ as their maximum averages.

Conclusion: Air pollution is a significant issue in Kosovo, and the burden of disease associated with indoor air exposure is a growing concern both in Kosovo and worldwide. Therefore, systematic monitoring and surveillance programs should be developed across the country to improve indoor air quality.

Keywords: households, indoor air, pollutants

Hezitimi ndaj vaksinave: Ndikimi i medias dhe strategjitë për luftën kundër dezinformimit në Shëndetin Publik

Vlera Haxhishabani ¹, Afrim Sylejmani²

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

² Spitali Rajonal Gjakovë, Reparti i Sëmundjeve ngjitëse

dr.vlerahaxhishabani@gmail.com

afrimsylejmani1@gmail.com

Abstrakti

Hyrje: Vaksinat janë ndër arritjet më të mëdha që ka sjellë shkenca mjekësore, duke shpëtuar jetë dhe parandaluar përhapjen e shumë sëmundjeve të rrezikshme.

Në kohët e sotme, ku informacioni shpërndahet me shpejtësi përmes internetit dhe rrjeteve sociale, është bërë shumë e lehtë për lajmet e rreme dhe teoritë e konspiracionit të ndikojnë tek mendimet e njerëzve. Kjo ka bërë që shumë prej tyre të hezitojnë të vaksinohen, edhe kur vaksinat janë të sigurta dhe lehtësisht të qasshme.

Qëllimi: Ky rishikim i literaturës ka për qëllim të shqyrtojë rolin e keqinformimit në rrjetet sociale që ndikojnë në përhapjen e hezitimit ndaj vaksinimit për të gjitha vaksinat, dhe jo vetëm vaksinat e COVID-19.

Materiali dhe Metoda: Rishikimi i literaturës, duke u mbështetur në literaturën më të fundit shkencore të publikuar në burime të indeksuara si PubMed dhe Google Scholar.

Rezultatet: Faktorët kryesorë që kontribojnë në hezitimin ndaj vaksinave përfshijnë përhapjen e informacionit të gabuar, mosbesimin ndaj institucioneve, dhe ndikimin e mediave sociale.

Përfundimi: Një nga sfidat më urgjente të shëndetit publik sot është hezitimi ndaj vaksinimit, i cili vazhdon të ndikojë drejtpërdrejtë në përpjekjet globale për të kontrolluar përhapjen e sëmundjeve të parandalueshme me vaksina. Ky fenomen bashkëkohor është i ndërlikuar dhe dinamik, i formësuar nga një ndërveprim kompleks faktorësh personalë, shoqërorë, kulturorë, psikologjik dhe institucional. Kapërcimi i këtre barrierave kërkon një strategji ndërdisiplinore dhe gjithëpërfshirëse. Bashkëpunimi midis profesionistëve të shëndetësisë, politikbërësve, përfaqësuesve të mediave, studiuesve dhe vetë komunitetit është i domosdoshëm.

Fjalë kyçe: vaksinimi, dezinformimi, shëndeti publik, edukimi shëndetësor

Vaccine Hesitation: The Influence of the Media and Strategies for Combating Misinformation in Public Health

Vlera Haxhishabani ¹, Afrim Sylejmani²

¹ Medical Faculty, University of Prishtina

² Regiona Hospital of Gjakova, Infectious Diseases Department

dr.vlerahaxhishabani@gmail.com

afrimsylejmani1@gmail.com

Abstract

Introduction: Vaccines are among the greatest achievements that medical science has brought, saving lives and preventing the spread of many dangerous diseases.

In today's times, where information is rapidly distributed via the internet and social networks, it has become very easy for fake news and conspiracy theories to influence people's opinions. This has made many of them hesitant to get vaccinated, even when vaccines are safe and easily accessible.

Purpose: This literature review aims to examine the role of misinformation on social networks in influencing the spread of vaccination hesitancy for all vaccines, and not just COVID-19 vaccines.

Material and Methods: Literature review, based on the latest scientific literature published in indexed sources such as PubMed and Google Scholar.

Results: The main factors contributing to vaccine hesitancy include the spread of misinformation, distrust of institutions, and the influence of social media.

Conclusion: One of the most pressing public health challenges today is vaccination hesitancy, which continues to directly impact global efforts to control the spread of vaccine-preventable diseases. This contemporary phenomenon is complex and dynamic, shaped by a complex interplay of personal, social, cultural, psychological, and institutional factors. Overcoming these barriers requires an interdisciplinary and comprehensive strategy. Collaboration among health professionals, policymakers, media representatives, researchers, and the community itself is essential.

Keywords: vaccination, disinformation, public health, health education.

Vlerësimi i besimit të publikut në autoritet e shëndetit publik dhe komunitetin mjekësor për të menaxhuar krizën COVID-19, Kosovë, Shtator-Tetor 2022

Donjet Bislimi ^{1,2,3,6} *, Naser Ramadani ^{1,4}, Donart Bislimi, Ariana Kalaveshi ^{1,4}, Isme Humolli^{4,5}, Pranvera Kaqaniku ¹, Redon Jashari ³, Michal Gregus ⁶, Merita Berisha ^{1,4}, Florie Miftari Basholli ^{1,2,4}, Albiona Rashiti Bytyçi ^{1,7}, Besfort Kryeziu ^{1,4}

1. National Institute of Public Health of Kosovo, Prishtina, Kosovo

2. Mediterranean and Black Sea Programme in Intervention Epidemiology Training (MediPIET), European Centre for Disease Prevention and Control (ECDC), Stockholm, Sweden

3. Universum International College, Prishtina, Kosovo

4. University of Prishtina, Prishtina, Kosovo

5. WHO – Office in Prishtina, Prishtina, Kosovo

6. Comenius University Bratislava, Bratislava, Slovakia

7. Alma Mater Europea Campus College Rezonanca

*Corresponding author

Sfondi: Besimi i publikut në menaxhimin efektiv të krizës COVID-19 është kritik, veçanërisht në zbatimin e masave të shëndetit publik si karantina, distancimi, vaksinimi dhe rregulloret e sigurisë. Ne synojmë të studiojmë besimin tek autoritetet e shëndetit publik dhe komuniteti mjekësor.

Metodat: Studim retrospektiv, ndër-seksional të popullsisë bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë valës VI të Vështrimeve të Sjelljes, të paraqitura nga 14/09/2022 deri më 05/10/2022. Anketat u kryen duke përdorur intervistën telefonike të asistuar nga kompjuteri (CATI), në një mostër prej 1,005 në mesin e kosovarëve të rritur që pranuan pjesëmarrjen e tyre. Duke përdorur R, u krye një analizë përshkuese për të gjithë kampionin duke përdorur peshat për të llogaritur probabilitetet e pabarabarta të përzgjedhjes në kampionin e studimit. Modelet e regresionit logjistik duke përdorur peshat u përdorën për të ekzaminuar veçmas ndikimet e përcaktuesve të ndryshëm në rezultatet e besimit në komunitetin mjekësor.

Rezultatet: Ka pasur një korrelacion statistikisht domethënës dhe pozitiv të besimit tek komuniteti mjekësor si mjekët e familjes për menaxhimin e krizës COVID-19. Gjithashtu, kemi gjetur besim të konsiderueshëm të besimit të publikut ndaj MSH dhe IKSHPK. Ne zbuluam se besimi në komunitetin mjekësor dhe informacionin e shëndetit publik lidhej me moshën, gjininë, shkrimleximin shëndetësor, shpeshësinë e kërkimit dhe aksesin në informacion dhe perceptimin e reklamave mediatike.

Konkluzione: Si përfundim, konstatuam se besimi i popullatës kosovare ndaj komunitetit mjekësor, profesionistëve mjekësorë dhe autoriteteve të shëndetit publik si Ministria e Shëndetësisë dhe IKSHPK është dukshëm i lartë, pavarësisht nga grupmosha, edhe në bazë të njohurive të tyre shëndetësore për COVID-19, vaksinimi dhe faktorë të tjerë si perceptimi i zhurmës mediatike dhe shpeshësia e kërkimit të informacionit.

Fjalë kyçe: besimi publik, autoritetet e shëndetit publik, Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, COVID-19, Kosovë

Assessment of public trust in public health authorities and the medical community to manage the COVID-19 crisis, Kosovo, September-October 2022

Donjet Bislimi ^{1,2,3,6} *, Naser Ramadani ^{1,4}, Donart Bislimi, Ariana Kalaveshi ^{1,4}, Isme Humolli^{4,5}, Pranvera Kaqaniku ¹, Redon Jashari ³, Michal Gregus ⁶, Merita Berisha ^{1,4}, Florie Miftari Basholli ^{1,2,4}, Albiona Rashiti Bytyçi ^{1,7}, Besfort Kryeziu ^{1,4}

1. National Institute of Public Health of Kosovo, Prishtina, Kosovo

2. Mediterranean and Black Sea Programme in Intervention Epidemiology Training (MediPIET), European Centre for Disease Prevention and Control (ECDC), Stockholm, Sweden

3. Universum International College, Prishtina, Kosovo

4. University of Prishtina, Prishtina, Kosovo

5. WHO – Office in Prishtina, Prishtina, Kosovo

6. Comenius University Bratislava, Bratislava, Slovakia

7. Alma Mater Europea Campus College Rezonanca

*Corresponding author

Background: Public trust in the effective management of the COVID-19 crisis is critical, especially in the implementation of public health measures such as quarantine, distancing, vaccination, and safety regulations.

Aim: We aim to study trust in public health authorities and the medical community. Methods Retrospective, cross-sectional population study based on data collected during wave VI of the Behavioural Surveys, conducted from 14/09/2022 to 05/10/2022. Surveys were conducted using computer-assisted telephone interviewing (CATI), on a sample of 1,005 adult Kosovars who agreed to participate. Using R, a descriptive analysis was conducted for the entire sample using weights to account for unequal selection probabilities in the study sample. Logistic regression models using weights were used to separately examine the impacts of different determinants on the outcomes of trust in the medical community.

Results: There was a statistically significant and positive correlation of trust in the medical community, such as family doctors, for managing the COVID-19 crisis. We also found significant public trust in the MoH and NIPHK. We found that trust in the medical community and public health information was associated with age, gender, health literacy, frequency of research and access to information, and perception of media advertising.

Conclusions: In conclusion, we found that the trust of the Kosovar population in the medical community, medical professionals, and public health authorities such as the Ministry of Health and the National Institute of Public Health is significantly high, regardless of age group, also based on their health knowledge about COVID-19, vaccination, and other factors such as perception of media noise and frequency of information seeking.

Keywords: public trust, public health authorities, Ministry of Health, National Institute of Public Health, COVID-19, Kosovo

Çrregullimet e gjumit gjatë kemioterapisë te pacientët me kancer

Vlora Ejupi ^{1,2}, MSc., PhD cand.

¹Fakulteti i Kujdesit Shëndetësor “Angela Boškin”, Spodnji Plavž 3, 4270 Jesenicë.

²Oda e Infermierëve të Kosovës, Holger Petersen, Prishtinë 10000.

Abstrakt

Hyrje: Numri i rasteve me kancer është në rritje në mbarë botën, duke u bërë kështu një nga shkaktarët kryesorë të vdekjes. Kimioterapia, si një nga format më të zakonshme të trajtimit të pacientët me kancer, shoqërohet me shumë simptoma, ndër të cilat çrregullimet e gjumit kanë një frekuencë të lartë dhe ndikojnë në cilësinë e gjumit.

Qëllimi: Ishte të vlerësohej literatura aktuale mbi çrregullimet e gjumit dhe faktorët e lidhur me to te pacientët me kancer gjatë fazës së kimioterapisë.

Metodologjia: Kërkimi në literaturë u bë në bazat e të dhënave PubMed dhe CINAHL. Përmes fjalëve kyçe në gjuhën angleze, janë identifikuar dhe përzgjedhur studime të 10 viteve të fundit.

Rezultatet: Çrregullimet e gjumit përfshijnë një shumëllojshmëri simptomash si vështirësi në të fjetur, zgjime herët në mëngjes, përgjumje gjatë ditës, zgjime të shpeshta dhe vështirësi në rikthimin në gjumë. Gjetjet treguan një prevalencë të lartë të çrregullimeve të gjumit (30%-60%), përgjigje të dobët ndaj trajtimit, përparim afatshkurtër dhe mbijetesë të përgjithshme të reduktuar. Lodhja, dhimbja, ankthi dhe depresioni kanë një lidhje të konsiderueshme me çrregullimet e gjumit.

Përfundimi: Kimioterapia shoqërohet me simptoma të shumta, ndër të cilat çrregullimet e gjumit lidhen me uljen e cilësisë së gjumit. Identifikimi i hershëm i çrregullimeve të gjumit dhe menaxhimi i duhur ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së gjumit.

Fjalë kyçe: kanceri, kimiioterapia, simptomat, çrregullimet e gjumit, cilësia e gjumit.

Sleep disorders during chemotherapy in cancer patients

Vlora Ejupi ^{1,2}, MSc., PhD cand.

¹Angela Boškin Faculty of Health Care, Spodnji Plavž 3, 4270 Jesenice.

²Kosovo Nurses Chamber, Holger Petersen, Pristina 10000.

Abstract

Introduction: The number of cancer cases is increasing worldwide, thus becoming one of the main causes of death. Chemotherapy, as one of the most common forms of treatment in cancer patients, is associated with many symptoms, among which sleep disorders have a high frequency and affect the quality of sleep.

Aim: It was to evaluate the current literature on sleep disorders and factors related to it among cancer patients during the chemotherapy phase.

Methodology: Literature search was done in PubMed and CINAHL databases. Through keywords in the English language, studies in the last 10 years have been identified and selected.

Results: Sleep disorders include a variety of symptoms such as difficulty falling asleep, early morning awakening, daytime sleepiness, frequent awakenings, and difficulty returning to sleep. Findings showed a high prevalence of sleep disorders (30%-60%), poor response to treatment, short-term progression and decreased overall survival. Fatigue, pain, anxiety and depression have a significant correlation with sleep disorders.

Conclusion: Chemotherapy is accompanied by numerous symptoms, among which sleep disorders are related to the reduction of sleep quality. Early identification of sleep disorders and proper management affect the improvement of sleep quality.

Keywords: cancer, chemotherapy, symptoms, sleep disorders, sleep quality.

Si ndikon aktiviteti fizik në peshën e të rinjëve

Edi Vitia ¹, Lena Gashi

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

vitiaedi@gmail.com

Abstrakt

Hyrja. Trendet statistikore, sinjalizojnë rritje të peshës nga fëmijët [1] deri në adult [2]. Ekzistojnë punime shkencore mbi aktivitetin fizik dhe peshës në adult, Shumë më pak në mosha të reja.

Qëllimi: Qëllimi i punimit është vlersimi i aktivitetit fizik dhe peshës trupore të të rinjëve. Punimi ka synim evidentimin e ndërlidhjes mes niveleve të aktivitetit fizik dhe indeksit të masës trupore (BMI).

Materiali dhe metodologjia: Hulumtimi është i tipit transversal. Hulumtimi është realizuar përmes pyësorit. Pyësori është zhvilluar online, me gjithësej 10 pyetje. Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 110 participant .

Rezultati: 68.2% e të anketuarëve kanë peshë normale, 10% mbi peshë pa rreziqe shëndetësore, 16.4% nënpeshë dhe 5.5% mbipeshë me rreziqe shëndetësore. 68.2% raportojnë se merren me aktivitet të rregullt fizik, më së shumti ecje ku 72.7% të të anketuarëve raportojnë se bëjnë ecje të rregullt dhe 41.8% bëjnë ushtrime në ftines (gym). Aktivitete të tjera përfshijnë: ushtrime në shtëpi 23.6%, sporte 21.8%, vrapim 15.5%. 65.5% merren me aktivitete të rënda fizike (ngritje peshe), nga këta 36,4% 1-3 ditë në javë, 22.7% 3-5 dhe 6.4% 5-7. Nga këta dhe të tjerët, 18.8% merren me aktivitete të moderuara fizike. 8.29% e femrave raportuan se janë mbipeshë pa rreziqe shëndetësore, 2.89% merren me aktivitet fizik, 7.2% mbipeshë me rreziqe shëndetësore që merren me aktivitet fizik. 12.19% meshkujve mbipeshë pa rreziqe shëndetësore që mirren me aktivitet fizik, 4.8% mbipeshe me rreziqe shëndetësore që mirren me aktivitet fizik. Nga personat me peshë normale, 72.36% merren me aktivitet të rregullt fizik.

Përfundimi: Aktiviteti fizik luan një rol kyç në mbajtjen e një bilanci të shëndetshëm të peshës trupore në gjeneratat e reja. Aktiviteti fizik ulë gjasat e obeziteit dhe është e rëndësishme që rinia të edukohet dhe të ju promovohet aktiviteti fizik.

Fjalë kyçe: aktivitet fizik, BMI, nënpeshë, mbipeshë, rreziqe shëndetësore.

How does physical activity impact the weight of young people

Edi Vitia¹, Lena Gashi

¹ Faculty of Medicine, University of Prishtina

vitiaedi@gmail.com

Abstract

Introduction: A main factor in a person's weight is physical activity. Statistical trends show an increase in weight in the population from childhood to adulthood. There are scientific studies on physical activity and adult weight, much less in young people.

Purpose: The purpose of the study is to assess the physical activity and body weight of young people. The study aims to identify the relationship between physical activity levels and body mass index (BMI).

Material and methodology: The study is the cross-sectional type and was carried out through a questionnaire. The questionnaire was done online, with a total of 10 questions. 110 participants participated in this research. Data processing was carried out in Microsoft Excel, and statistical analysis was performed using the Chi-square test. The χ^2 values and p-values were reported, with results considered significant at $p < 0.05$.

Results: 68.2% of respondents are of normal weight, 10% overweight without health risks, 16.4% underweight and 5.5% overweight with health risks. 68.2% report engaging in regular physical activity, mostly walking, with 72.7% of respondents reporting regular walking and 41.8% exercising in the gym were 18.8% engage in moderate physical activity. 8.29% of women reported being overweight without health risks, 2.89% engage in physical activity, 7.2% overweight with health risks engage in physical activity. 12.19% of overweight men without health risks engage in physical activity, 4.8% overweight with health risks engage in physical activity. 68.2% are normal weight range and of those 72.36% engage in regular physical activity.

Conclusion: Physical activity plays a key role on maintaining a healthy and balanced body weight throughout the younger generations. Physical activity reduces the likelihood of obesity and the youths need education and promotion of physical activity.

Keywords: physical activity, BMI, underweight, overweight, health risks.

Shtatzënia dhe Duhanpirja

Arbër Aliu ¹

¹ Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

Abstrakti

Hyrje

Shtatzënia është një periudhë jetike dhe e ndjeshme në jetën e një gruaje dhe zhvillimin e një fëmije. Gjatë kësaj kohe, shëndeti dhe mirëqenia e nënës kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi shëndetin dhe zhvillimin e fetusit. Duhanpirja, një zakon i njohur për efektet e tij të dëmshme si dhe nikotina bashkë me substancat e tjera toksike të pranishme në cigare mund të ndikojnë negativisht jo vetëm tek nëna, por edhe tek fetusit që zhvillohet.

Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij punimi është që të përshkruhet patofizilogjia e e veprimit të tymit të duhanit, shtazënia dhe efektet e duhanpirjes tek nënat duhanpirëse dhe tek fetusit si dhe rekomandimet e OBSH për parandalimin dhe menaxhimin e duhanpirjes aktive dhe pasive gjatë shtatëzanisë.

Metodologjia e punës

Metodologjia e punës e përdorur në këtë punim është rishikim i literaturës botërore, OBSH, si dhe publikimet shkencore më të fundit.

Rezultatet

Gratë shtatëzëna duhanpirëse janë në rrezik më të madh për çregullime kardiovaskulare dhe pulmonare gjatë shtatëzanisë, abruptio placentae (shkolitja e placentës), IUGR(kufizim i rritjes intrauterine të frytit), lindje e parakohëshme, shtatzëni ektopike, placenta previa dhe PPRM. Tek fetusit defektet e lindjes më të shpeshta të asociuara me duhanpirjen janë: defektet kongjenitale të zemrës, çrregullimet kardiovaskulare, çrregullimet oro-faciale sikurse buza e çarë (cleft lip), qiellza e çarë (cleft palate).

Përfundimi

OBSH ka përcaktuar disa rekomandime kryesore për parandalimin dhe menaxhimin e duhanpirjes aktive dhe pasive gjatë shtatëzanisë. Këto rekomandime kanë për qëllim ruajtjen e shëndetit maternal dhe fetal si pasojë e riskut të shtuar nga përdorimi i duhanit.

Fjalët kyqe: shtatzënia, duhanpirja, parandalimi dhe menaxhimi, rekomandimet e OBSH.

Pregnancy and Smoking

Arbër Aliu ¹

¹ Faculty of Medicine, University of Prishtina

Abstract

Introduction

Pregnancy is a critical and sensitive period in a woman's life and the development of a child. During this time, the health and well-being of the mother directly impact the health and development of the fetus. Smoking, a well-known habit for its harmful effects, along with nicotine and other toxic substances found in cigarettes, can negatively affect not only the mother but also the developing fetus.

Aim of the Paper

The aim of this paper is to describe the pathophysiology of the effects of tobacco smoke, pregnancy, and the impacts of smoking on smoking mothers and the fetus, as well as the WHO recommendations for the prevention and management of both active and passive smoking during pregnancy.

Methodology

The methodology used in this paper is a review of global literature, WHO guidelines, and the latest scientific publications on the topic.

Results

Pregnant women who smoke are at a higher risk for cardiovascular and pulmonary disorders during pregnancy. They are more likely to experience conditions such as abruptio placentae (placental detachment), IUGR (intrauterine growth restriction), preterm birth, ectopic pregnancy, placenta previa, and PPRM (preterm premature rupture of membranes). In the fetus, the most common birth defects associated with smoking are congenital heart defects, cardiovascular disorders, and oro-facial abnormalities such as cleft lip and cleft palate.

Conclusion

The WHO has established several key recommendations for the prevention and management of both active and passive smoking during pregnancy. These recommendations aim to protect maternal and fetal health due to the increased risk posed by tobacco use.

Keywords: Pregnancy, smoking, prevention and management, WHO recommendations.

Pse studentët pijnë duhan? Pikëpamjet e studentëve të mjekësisë në Universitetin e Prishtinës

Aulona Hodaj¹, Butrint Ajazaj³, Sanije Hoxha-Gashi^{1,2}

1. Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

2. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës;

3. Klinika Emergjente, Qendra Klinike Universitare e Kosovës

Abstrakt

Hyrje. Pirja e duhanit, e cila njihet si ndër shkaqet kryesor të parandalueshme të sëmundjeve dhe vdekjeve, është rritur ndjeshëm që nga fillimi i saj dhe është zhvilluar në një shqetësim të madh shëndetësor në mbarë botën, veçanërisht për studentët e mjekësisë që do të përbëjnë fuqinë punëtore të ardhshme të kujdesit shëndetësor. Mësimdhënia e studentëve të mjekësisë mbi parandalimin dhe trajtimin e varësisë nga duhani do t'i pajisë ata për të ndihmuar duhanpirësit të lënë duhanin. Deri me tani nuk është e qartë cili është opinion i studentëve të mjekësisë në Universitetin e Prishtinës për arsyet e fillimit të pirjes së duhanit nga studentët.

Qëllimi: Qëllimi i këtij hulumtimi është të kuptojë arsyet pse studentët e mjekësisë fillojnë të pijnë duhan.

Materiali dhe metodat. Një studim i prerjes tërthore u krye gjatë muajve Maj-Dhjetor të vitit 2024 në një mostër prej 384 studentësh në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Madhësia e mostrës është llogaritur duke përdorur OpenEpi për një fuqi studimi prej 95% dhe një shkallë gabimi prej 0.05% dhe një efekt dizajni 1.0%. Pyetësi u plotësua nga 312 studentë ose 81.3% e studentëve të planifikuar. Mostra përfshinte studentë të vitit të parë të mjekësisë nga drejtimet: Mjekësi e Përgjithshme, Stomatologji, Farmaci dhe Infermieri. Të dhënat u mbledhën përmes një pyetësi të zhvilluar nga studiuesit bazuar në një rishikim të mëparshëm të literaturës, i cili pastaj u kontrollua nga ekspertët e fushës dhe u pilotua për të rritur besueshmërinë dhe vlefshmërinë.

Rezultatet. Sipas studentëve të vitit të parë të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës arsyet kryesore pse studentët fillojnë të pijnë duhan janë: Shoqëria pijnë duhan (kështu mendojnë 70.8% e të anketuarëve), Prindërit pijnë duhan 66.7%, Shprehite 62.5%, Varësia nga nikotina 60.6%, Duhani të jep kënaqësi 47.8% dhe Pirja e duhanit qetëson 41.7%. Ndërsa 65.7% e studentëve nuk pajtohen me pohimin se ndihmon me Përqendrimin dhe 67.6% nuk pajtohen se të jep Vetëbesim.

Përfundime. Këto gjetje nxjerrin në pah nevojën për ndërhyrje të synuara për të adresuar këto shkaqe dhe për të zvogëluar pirjen e duhanit tek studentët.

Fjalët kyçe: Studentet e mjekësisë, duhanpirja, arsyet për duhanpirje

Why Do Students Smoke? Views of Medical Students at the University of Prishtina

Aulona Hodaj¹, Butrint Ajazaj³, Sanije Hoxha-Gashi^{1,2}

1. Medical Faculty, University of Prishtina "Hasan Prishtina"

2. National Institute of Public Health of Kosova

3. Emergency Clinic, University Clinical Centre of Kosova

Abstract

Background. Cigarette smoking, which is recognized as one of the leading causes of avoidable morbidity and mortality, has significantly increased since its start and developed into a major worldwide health concern, especially for medical students who will make up the future healthcare workforce. Teaching medical students on the prevention and treatment of tobacco dependency will equip them to assist smokers in quitting. Till now it is unclear which is opinion of medical students at University of Prishtina about the reasons of starting smoking among students.

Aim: The purpose of this research is to understand the reasons why medical students start smoking.

Material and methods. A cross-sectional study was conducted during May-December of the year 2024 on a sample of 384 students at Medical Faculty University of Prishtina, where the sample size was calculated using OpenEpi for a study power of 95 % and an error rate of 0.05 % and a design effect 1.0%. The questionnaire was completed by 312 students or 81.3% of the planned students. The sample included first year medical students from the fields of General Medicine, Dentistry, Pharmacy and Nursing. The data was collected through a questionnaire developed by researchers based on a former literature review, checked from experts in the field and piloted it to increase reliability and validity.

Results. According to first-year students of the Faculty of Medicine at the University of Prishtina, the main reasons why students start smoking are: Society/Friends smokes (this is what 70.8% of respondents think), Parents smoke 66.7%, Habits 62.5%, Nicotine addiction 60.6%, Smoking gives pleasure 47.8% and Smoking calms down 41.7%. While 65.7% of students disagree with the statement that it helps with Concentration and 67.6% disagree that it gives Self-confidence.

Conclusions. These findings highlight the need for targeted interventions to address these causes and reduce smoking among students.

Keywords: Medical students, smoking, reasons of smoking

Vlerësimi i shprehive të shëndetshme te studentët e Fakultetit të Mjekësisë, Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”

Rina Hoxha^{1,2}, Merita Berisha^{1,2}, Sanije Gashi^{1,2}, Valbona Zhjeki^{1,2}, Fitore Ramadani^{1,2}, Myvedete Tershnjaku¹, Mirëllinda Hatashi¹, Fatime Ukaj^{1,2}, Pranvera Krasniqi^{1,2}, Adea Vejseli³

1. *Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës*
2. *Fakulteti I Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”*
3. *Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Podujevë*

Abstrakt

Hyrja: Jeta studentore shoqërohet me ndryshime fiziologjike dhe psikologjike të lidhura me adoleshencën dhe moshën e rritur, është një fazë e jetës me ndryshime të mëdha në sjellje dhe përgjegjësi që rrjedhin nga braktisja e shtëpisë e familjes dhe ndikimet e grupeve të bashkëmoshatarëve në këtë periudhë.

Materiali dhe Metodologjia: Hulumtimi është i tipit transversal (cross sectional) me komponenten deskriptive. Të dhënat janë grumbulluar përmes pyetsorit i cili ka përmbajtje gjithsej 20 pyetje të cilat kanë të bëjnë me zakonet dhe praktikën e studentëve për ushqimin e shëndetshëm dhe aktivitete fizike. Gjithsej në hulumtim janë përfshirë 339 studente të disa drejtimeve të fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”. Përpunimi i të dhënave është bërë me programin excel dhe janë njehsuar disa parametra statistikorë. Dallimet e rëndësishme sipas grupeve janë testuar me X^2 test për nivelin e besueshmërisë 95% $p < 0.05$ dhe 99.7% $p < 0.01$.

Rezultatet: Sipas të dhënave vetëm 43.4% e studentëve merren me aktivitete fizike me një dallim sinjifikant sipas gjinisë, meshkujt me një përqindje shumë më të lartë, mbi 70% e tyre krahasuar me 24.3% të femrave të cilat merren me aktivitete fizike. Shumica e studentëve 72% bëjnë 6-8 orë gjumë pa ndonjë dallim të rëndësishëm sipas gjinisë. Molla dhe bananet janë frutat më të preferuarat nga ana e studentëve të anketuar. Ushqim të shpejt konsumojnë shumë herë brenda javës dhe gjdo ditë afër 68 % (67.8%) e studentëve me një dallim sinjifikant sipas gjinise ($X^2=22.09$. Shl=2; $p=0.000016$).

Përfundime: Mund të konkludojmë se shprehjet e shëndetshme në disa aspekte mungojnë në mesin e studentëve të Fakultetit të Mjekësisë duke filluar nga mosaktiviteti fizik në mesin e femrave dhe ushqimi jo i shëndetshëm në mesin e meshkujve andaj kërkon një edukim dhe promovim të jetës së shëndetshme në mesin e studentëve.

Fjalët kyçe: Shprehjet e shëndetshme, studentët, Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë

Assessment of healthy habits among students of the Faculty of Medicine, University of Prishtina "Hasan Prishtina"

Rina Hoxha^{1,2}, Merita Berisha^{1,2}, Sanije Gashi^{1,2}, Valbona Zhjeki^{1,2}, Fitore Ramadani^{1,2}, Myvedete Tershnjaku¹, Mirëlinda Hatashi¹, Fatime Ukaj^{1,2}, Pranvera Krasniqi^{1,2}, Adea Vejseli³

1. National Institute of Public Health of Kosovo

2. Faculty of Medicine, University of Prishtina "Hasan Prishtina"

3. Main Family Medicine Center Podujeva

Abstract

Introduction: Student life is accompanied by physiological and psychological changes related to adolescence and adulthood, it is a phase of life with major changes in behavior and responsibilities that stem from leaving home and family and the influences of peer groups in this period.

Material and Methodology: The study is the cross-sectional type with a descriptive component. Data were collected through a questionnaire that contained a total of 20 questions related to students' habits and practices regarding healthy eating and physical activity. A total of 339 students from several departments of the Faculty of Medicine at the University of Prishtina "Hasan Prishtina" were included in the research. Data processing was done with the excel program and several statistical parameters were calculated. Significant differences by group were tested with the X^2 test for the 95% $p < 0.05$ and 99.7% $p < 0.01$ confidence level.

Results: According to the data, only 43.4% of students engage in physical activities with a significant difference by gender, males with a much higher percentage, over 70% of them compared to 24.3% of females who engage in physical activities. Most students 72% get 6-8 hours of sleep without any significant difference by gender. Apples and bananas are the most favorite fruits by the surveyed students. Fast food is consumed many times a week and every day by about 68% (67.8%) of students with a significant difference by gender ($X^2=22.09$. Shl=2; $p=0.000016$).

Conclusions: We can conclude that healthy habits in some aspects are lacking among the students of the Faculty of Medicine, starting from physical inactivity among women and unhealthy eating among men, therefore it requires education and promotion of a healthy lifestyle among students.

Keywords: Healthy habits, students, Faculty of Medicine, Prishtina

Rritja e prevalencës së sëmundjeve Autoimune dhe ndikimi i faktorëve mjedisorë dhe stilit të jetesës në zhvillimin e tyre

Albana Ahmeti, MD ¹

¹Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

albana.ahmeti@gmail.com

Abstrakti

Hyrje: Sëmundjet autoimune përfaqësojnë një shqetësim në rritje për shëndetin publik në nivel global, duke prekur organe dhe sisteme të ndryshme për shkak të një përgjigjeje imunitare jo të duhur. Në thelb të patogjenezës së çrregullimeve autoimune është një sistem imunitar i disbalancuar, i karakterizuar nga hiperaktivizimi i përgjigjes imunitare të lindur dhe defektet në qelizat T - rreguluese. Për më tepër, është e mundur që ngacmime të shumta ndaj sistemit imunitar, të ndodhura në një sekuençë të caktuar, kontribuojnë në zhvillimin dhe përkeqësimin e sëmundjeve autoimune.

Qëllimi dhe Objektivat: Qëllimi i këtij punimi është të analizojë prevalencën në rritje të sëmundjeve autoimune dhe të shqyrtojë rolin e faktorëve mjedisorë dhe mënyrës së jetesës në zhvillimin e tyre. Kuptimi i këtyre ndikimeve mund të ndihmojë në krijimin e strategjive të reja parandaluese dhe përmirësimin e rezultateve për pacientët.

Metodologjia: Artikulli përbën një rishikim të literaturës, i cili mbështetet në informacione shkencore nga burime të ndryshme si PubMed, Medscape.

Rezultatet: Rezultatet tregojnë një rritje të konsiderueshme të prevalencës të çrregullimeve autoimune në nivel botëror, të shoqëruara me ndotësit mjedisorë dhe ndryshimet në dietë. Faktorët e stilit të jetesës si tymosja e duhanit, konsumimi i alkoolit, dieta jo e shëndetshme, obeziteti, mungesa e aktivitetit fizik, gjumi i pamjaftueshëm dhe stresi psikologjik ndikojnë në përgjigjet imunitare dhe zhvillimin e çrregullimeve autoimune. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj kimikateve dhe rrezatimit ultravjollcë mund të shkaktojë përgjigje inflamatore. Ndryshimi i klimës ndikon gjithashtu në përhapjen e sëmundjeve autoimune përmes rritjes së ndotësve mjedisorë.

Përfundimi: Ndërveprimi midis gjeneve, mjedisit dhe stilit të jetës është thelbësor në zhvillimin e sëmundjeve autoimune. Përmirësimi i ndërgjegjësimit të popullatës dhe zbatimi i strategjive të duhura mund të zvogëlojë rrezikun e këtyre sëmundjeve dhe të përmirësojë cilësinë e jetesës për ata që preken nga këto çrregullime.

Fjalë kyçe: sëmundjet autoimune, faktorët mjedisorë, predispozita gjenetike.

Increasing prevalence of autoimmune diseases and the influence of environmental and lifestyle factors on their development

Albana Ahmeti, MD ¹

¹Medical Faculty, University of Prishtina "Hasan Prishtina"

E-mail: albana.ahmetti@gmail.com

Abstract

Introduction: Autoimmune diseases represent a growing concern for public health on a global scale, affecting various organs and systems due to an inappropriate immune response. At the core of the pathogenesis of autoimmune disorders lies an imbalanced immune system, characterized by hyperactivation of the innate immune response and defects in regulatory T cells. Furthermore, it is possible that multiple immune system triggers, occurring in a specific sequence, contribute to the development and exacerbation of autoimmune diseases.

Aim and Objectives: The aim of this paper is to analyze the increasing prevalence of autoimmune diseases and to examine the role of environmental factors and lifestyle in their development. Understanding these influences may help in creating new preventive strategies and improving outcomes for patients.

Methodology: This article is a literature review based on scientific information from various sources such as PubMed and Medscape.

Results: The results show a significant increase in the global prevalence of autoimmune disorders, associated with environmental pollutants and dietary changes. Lifestyle factors such as smoking, alcohol consumption, unhealthy diet, obesity, lack of physical activity, insufficient sleep, and psychological stress impact immune responses and the development of autoimmune disorders. Continuous exposure to chemicals and ultraviolet radiation can trigger inflammatory responses. Climate change also affects the spread of autoimmune diseases through increased environmental pollution.

Conclusion: The interaction between genes, environment and lifestyle is essential in the development of autoimmune diseases. Improving population awareness and implementing appropriate strategies can reduce the risk of these diseases and improve the quality of life for those affected by these disorders.

Keywords: autoimmune diseases, environmental factors, genetic predisposition.

- VI -

Temat tjera

Other topics

Trendi i lindjeve normale dhe lindjeve me prerje Cesariene në Kosovë për 5 vitet e fundit

Rina Hoxha ^{1,2}, Sanije Gashi ^{1,2}, Merita Berisha ^{1,2}, Ardita Baraku ^{1,3}, Myvedete Tershnjaku ¹, Mirë Linda Hatashi ¹, Fatime Ukaj ^{1,2}, Fitore Ramadani ^{1,2}, Valbona Zhjeki ^{1,2}, Sevdije Spahiu ^{1,2}

^{1.} Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

^{2.} Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë, Kosovë

^{3.} Kolegji UBT- Universiteti për Bisnes dhe Teknologji, Prishtinë

rina.hoxha@uni-pr.edu

Abstrakt

Hyrje: Lindjet si fenomen vital në nivel botëror janë duke pësuar trend në rënie. Në rënie të trendit të lindjeve ndikojnë faktorë të ndryshëm, tashmë të njohur si ata: ekonomik, kulturor, social dhe demografik. Në disa shtete politikat demografike kanë ndikimin në këtë dukuri. Sipas vlerësimeve të OBSH deri në vitin 2030, parashikohet që një e treta e të gjitha lindjeve do të jetë me prerje cezariene. Ky trend i rritjes së lindjeve me prerje cezariene është në mënyrë të vazhdueshme, me normat globale prej 21.1%, pothuajse të dyfishuara që nga viti 2000. Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh, 2021) prevalenca e lindjeve me prerje cezariene është rritur nga 7% në 1990 në 21% në 2021.

Qëllimi: Vlerësimi i lindjeve normale dhe atyre me prerje cezariene të raportuara në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës për Periudhën 2019-2023.

Materiali dhe Metodologjia: Punimi është i tipit kohort retrospektiv me komponenten deskriptive. Të dhënat janë marrë nga raportet statistikore të Lindjeve në Institucione Publike dhe Private shëndetësore të raportuara në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës për periudhën 2019-2023. Të dhënat janë prezantuar me tabela dhe grafikone përkatëse dhe janë testuar me X^2 test për nivelet e besueshmërisë 95% $p < 0.05$ dhe 99.7% $p < 0.01$.

Rezultatet: Gjithsej për periudhën 5 vjeçare janë raportuar 103,276 lindje ku sipas viteve trendi i lindjeve ka tendencë të rënjes, krahasuar me vitin 2019 në vitin 2023 numri i lindjeve është zvogëluar për 11.5%. Sipas mënyrës së lindjes, lindje normale për periudhën e analizuar kanë qënë 62,660, sipas viteve në vitin 2023 numri i lindjeve normale është zvogëluar për 18.6% krahasuar me vitin 2019. Numri i lindjeve me prerje cezariene sipas viteve është rritur për 28.7% krahasuar me vitin 2019. Lindjet me prerje cezariene në përgjithësi kanë tendencë rritjeje sipas viteve si në institucionet publike ashtu edhe ato private, ku kjo përqindja e rritjes është dukshëm më e lartë në institucionet private shëndetësor.

Përfundimi: Në përgjithësi trendi i lindjeve është në rënie por trendi i lindjeve me prerje cezariene është në rritje, sidomos duhet të theksohet se në institucionet private shëndetësore prevalenca e lindjeve me prerje cezariene është mbi 65%.

Fjalet Kyçe: trendi, lindjet normale, lindjet me prerje cezariene, Kosovë

Trend of Normal Births and Cesarean Section Births in Kosovo for the Last 5 Years

Rina Hoxha ^{1,2}, Sanije Gashi ^{1,2}, Merita Berisha ^{1,2}, Ardita Baraku ^{1,3}, Myvedete Tershnjaku ¹, Mirëlinda Hatashi ¹, Fatime Ukaj ^{1,2}, Fitore Ramadani ^{1,2}, Valbona Zhjeki ^{1,2}, Sevdije Spahiu ^{1,2}

^{1.} National Institute of Public Health of Kosovo

^{2.} University of Prishtina “Hasan Prishtina”, Faculty of Medicine, Prishtina, Kosovo

^{3.} UBT College - University of Business and Technology, Prishtina

rina.hoxha@uni-pr.edu

Abstract

Introduction: Births as vital phenomena at the global level are at the downward trend. Various factors which influence at the downward birth trend, already known are: economic, cultural, social and demographic. In individual countries, demographic policies have an impact on this phenomenon. According to WHO estimates, by 2030, it is predicted that one third of all births will be by cesarean section. This trend of increasing cesarean births is ongoing, with global rates of 21.1%, almost doubling since 2000. According to data from the World Health Organization (WHO, 2021), the prevalence of cesarean births has increased from 7% in 1990 to 21% in 2021.

Aim: Assessment of normal and cesarean births reported to the National Institute of Public Health of Kosovo for the period 2019-2023.

Material and Methodology: The study is a retrospective cohort with a descriptive component. The data were obtained from statistical reports of the Births in Public and Private health Institutions reported in the National Institute of Public Health for the period 2019-2023. The data were presented with relevant tables and graphs and were tested with the χ^2 test for the 95% $p < 0.05$ and 99.7% $p < 0.01$ confidence levels.

Results: A total of 103,276 births were reported for the 5-year period, where the birth trend has a downward trend over the years, compared to 2019, in 2023 the number of births has decreased by 11.5%. According to the method of births, normal births have been in total 62,660 births, according by year, in 2023, the number of normal births decreased by 18.6% compared to 2019. The number of cesarean births by year increased by 28.7% compared to 2019. Cesarean births generally have an increasing trend over the years in both public and private institutions, where this percentage of increase is significantly higher in private health institutions.

Conclusion: In general, the trend of births is decreasing, but the trend of cesarean section births is increasing. It should be especially noted that in private health institutions, the prevalence of cesarean section births is over 65%.

Keywords: trend, normal births, cesarean births, Kosovo

Ndikimi i teknologjisë në mjekësi

Dr. Albana Beqiri –Ministria e Shëndetësisë së Kosovës- albana.r.beqiri@gmail.com

BSc. Sead Ahmetaj Bursa Private Hayat Hospital - seadahmetaj@hotmail.com

Abstrakt

Teknologjia prek gjithçka përparimi i shpejtë në teknologji ka sjellë ndryshime novator në industrinë e kujdesit shëndetësor. Sot, risitë e ndryshme teknologjike në trajtimin mjekësor dhe kujdesin shëndetësor u mundësojnë profesionistëve të kujdesit shëndetësor të bëjnë më efikase proceset e diagnostikimit dhe trajtimit dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës së pacientëve.

Të gjithë ne e dimë mirë që ditët e sotme teknologjia është gjithandej në çdo fushë apo dhe në çdo vend ku sot teknologjia prek gjithçka çdo vend të mundshëm. Ky përparim i teknologjisë e ka bërë jetën tonë shumë herë më të thjeshtë dhe më të rehatshme.

Përparimet teknologjiko-shkencore dhe zbatimi i tyre në mjekësi po sjell mrekulli siç e dimë pandemia COVID-19, tregoi se bota kishte shumë nevojë për zhvillim të shpejtë të një vaksine që mund të vendosej lehtësisht në të gjithë globin dhe një gjë e tillë ndodhi, ku u shpëtuan me miliona jetë.

Diagnostikimi i shpejtë dhe i saktë i të gjitha sëmundjeve, incizimet me cilësi dhe rezolucion të lartë, doza minimale e rrezatimit, koha më e shkurtër e incizimit dhe komforti më i madh për pacientët janë avantazhet kryesore të teknologjisë mjekësore me të cilën disponon një qendër spitalore.

Këto vitet e fundit mjekësia ka përfituar nga progresi i pandërprerë në fushën e teknologjisë me ndihmën e tyre mjekët arrijnë që të diagnostikojnë dhe trajtojnë një sërë sëmundjesh që në të kaluarën as që mendohej se mund të shëroheshin.

Rezonanca magnetike për tërë trupin MRI 3 Tesla, e cila është gjenerata e fundit e aparateve të rezonancës magnetike, MRI 3 Tesla mundëson kohë të shkurtuar të incizimit deri në 30%, pasqyrë precize të strukturave dhe organeve të brendshme si dhe zbulimin e ndryshimeve që nuk mund të shihen me modelet standarde të rezonancës magnetike. Me këtë aparat të fuqishëm mund të kryhet Check up skringing të të gjithë trupit për më pak se 1 orë, pa rrezatim dhe pa kontrast.

Njashtu aparati PET/ CT i cili përdor inteligjencën artificiale AI për zbulimin më të saktë të ndryshimeve më të vogla – lezione me madhësi deri në 5 mm. Aparati PET / CT përdoret për përcaktimin e fazës së sëmundjes, për detektimin e recidiveve lokale dhe metastazave të largëta, si dhe për vlerësimin e përgjigjes së terapisë së marrë dhe për planifikimin e saktë të radioterapisë tek pacientët onkologjike. Avantazhet e gjeneratës së re PET / CT janë koha e shkurtuar e incizimit deri në 50% dhe ulja e dozës së radiofarmaceutikut për 30-50% me çka në mënyrë drastike ullet doza e rrezatimit ndaj pacientit.

Falë zhvillimeve teknologjike dhe transferimit të shumë aplikacioneve në mjedisin elektronik, i gjithë informacioni për shëndetin e pacientit regjistrohet në bazën e të dhënave dhe ky

informacion mund të aksesohet shpejt kur nevojitet. Të dhënat e regjistruara falë sistemeve të informacionit përdoren për sa i përket kapacitetit të shtratis spitalor, përshtatshmërisë së kapacitetit të departamentit të urgjencës, etj. Është e rëndësishme që pacientët të kenë akses në trajtimet që kanë marrë më parë dhe medikamentet që kanë përdorur, falë bazës së të dhënave shëndetësore të mjekëve, në drejtim të trajtimit efektiv dhe korrekt. Informacioni jetik që mund të merret nga baza e të dhënave, veçanërisht në rastet e ndërhyrjes urgjente për pacientët me diabet, presion të gjakut apo alergji ndaj ndonjë medikamenti, rrit më tej rëndësinë e sistemeve të informacionit. Sepse ndërhyrja tek pacientët pa e ditur diabetin e tyre, presionin e gjakut dhe gjendjet alergjike mbart një rrezik të madh për jetën. Sistemet e informacionit në sektorin e kujdesit shëndetësor tregojnë gjithashtu rëndësinë e tyre në ofrimin e informacionit për pacientët. Sidomos për trajtimet dentare, pacientët kanë informacion për mbushjet, trajtimet e kanalit të rrënjës etj. Aftësia për të aksesuar informacionin për trajtimin që ata kanë marrë më parë siguron transparencë në lidhje me ofrimin e informacionit për ta.

Çdo gjë rreth mjekësisë dhe mirëqenies është duke u transformuar nga teknologjia dixhitale.

The impact of technology on medicine

Dr.Albana Beqiri – Ministry of Health Kosovo - albana.r.beqiri@gmail.com

BSc.Sead Ahmetaj Bursa Private Hayat Hospital - seadahmetaj@hotmail.com

Abstract

Technology touches everything the rapid advancement in technology has brought groundbreaking changes in the healthcare industry. Today, various technological innovations in medical treatment and healthcare enable healthcare professionals to make the diagnostic and treatment processes more efficient and improve the quality of life of patients.

We all know well that nowadays technology is everywhere in every field or in every place where today technology touches everything every possible place. This advancement in technology has made our lives many times simpler and more comfortable.

Technological and scientific advances and their application in medicine are bringing miracles as we know the COVID-19 pandemic, showed that the world was in great need of rapid development of a vaccine that could be easily deployed across the globe and such a thing happened, where millions of lives were saved.

Fast and accurate diagnosis of all diseases, high-quality and high-resolution recordings, minimal radiation dose, shorter recording time and greater comfort for patients are the main advantages of medical technology available to a hospital center.

In recent years, medicine has benefited from continuous progress in the field of technology, with their help, doctors manage to diagnose and treat a number of diseases that in the past were not even thought to be curable.

Whole-body MRI 3 Tesla, which is the latest generation of magnetic resonance imaging devices, MRI 3 Tesla enables shortened recording times of up to 30%, precise overview of internal structures and organs, as well as the detection of changes that cannot be seen with standard magnetic resonance models. With this powerful device, a full-body check-up screening can be performed in less than 1 hour, without radiation and without contrast.

Also the PET/CT device which uses AI artificial intelligence for more accurate detection of the smallest changes – lesions up to 5 mm in size. The PET/CT device is used to determine the stage of the disease, to detect local recurrences and distant metastases, as well as to assess the response to the therapy received and to accurately plan radiotherapy in oncological patients. The advantages of the new generation PET/CT are the shortened recording time by up to 50% and the reduction of the dose of the radiopharmaceutical by 30-50%, which drastically reduces the radiation dose to the patient.

Thanks to technological developments and the transfer of many applications to the electronic environment, all information about the patient's health is recorded in the database and this

information can be quickly accessed when needed. The data recorded thanks to information systems are used in terms of hospital bed capacity, the adequacy of the capacity of the emergency department, etc. It is important for patients to have access to the treatments they have previously received and the medications they have used, thanks to the health database of doctors, in terms of effective and correct treatment. The vital information that can be obtained from the database, especially in cases of emergency intervention for patients with diabetes, blood pressure or allergies to any medication, further increases the importance of information systems. Because intervening in patients without knowing their diabetes, blood pressure and allergic conditions carries a great risk to life. Information systems in the healthcare sector also show their importance in providing information to patients. Especially for dental treatments, patients have information about fillings, root canal treatments, etc. The ability to access information about the treatment they have previously received provides transparency regarding the provision of information to them. Everything about medicine and well-being is being transformed by digital technology.

Dinjiteti Digjital: Rritja e Sigurisë dhe e të Drejtave Online Përmes Fushatës Bodyright

Dr. Zarife Miftari¹, Dr. Visare Mujko Nimani¹, Donika Sabovic¹

¹UNFPA, Kosova

Dhuna me bazë gjinore e ushtruar përmes teknologjisë (DHBGJPT)

Abstrakt

Hyrje: Bota digjitale, megjithëse e mbushur me potencial, është bërë gjithashtu një hapësirë ku trupat tanë dhunohen dhe dinjiteti ynë kërcënohet. Dhuna me bazë gjinore e ushtruar përmes teknologjisë (DHBGJPT) është një shqetësim në rritje për shëndetin publik dhe të drejtat e njeriut. Keqtrajttime online siç janë ngacmimi kibernetik, doks-imi (doxxing), falsifikimi i theksuar (deepfakes) dhe shpërndarja e pa pranueshme e imazheve intime janë në rritje ndaj grave, vajzave dhe grupeve të marginalizuara.

Qëllimi: Të rrisë ndërgjegjësimin dhe të promovojë ndryshime sistemike rreth DHBGJPT, përmes zbatimit dhe lokalizimit të fushatës Bodyright në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor.

Materialet dhe Metodrat: E lansuar globalisht nga UNFPA në 2021 dhe në Kosovë në 2022, fushata Bodyright prezanton simbolin  për të avokuar për autonominë trupore online dhe mbrojtjen e barabartë të imazheve personale. Fushata u realizua me të rinjtë, universitetet, figurat publike dhe institucionet. UNFPA në Kosovë poashtu përkrahu një analizë të legjislacionit për të identifikuar boshllëqet në mbrojtjet kundër dhunës digjitale dhe adaptoi në gjuhët lokale fjalorin e terminologjisë së DHBGJPT, për të ndihmuar të rinjtë dhe prindërit që të njohin abuzimin digjital.

Rezultatet: Fushata ka arritur mbi 5 milion njerëz online. Mbi 15 figura publike kanë mbështetur iniciativën, duke ndihmuar në normalizimin e dialogut publik për dhunën digjitale. Fjalori dhe analiza ligjore kanë mbështetur përpjekjet e ndërgjegjësimit dhe avokimit ndërsektorial.

Përfundim: Fushata Bodyright është shembull i një qasjeje multidimensionale për të luftuar TFGBV duke kombinuar reformën ligjore, avokimin për të drejtat digjitale dhe edukimin e komunitetit. Ajo i bën thirrje politikanëve, platformave teknologjike dhe shoqërisë që të sigurojnë që të gjithë njerëzit, veçanërisht gratë, vajzat dhe grupet e marginalizuara, të hulumtojnë në hapësirat digjitale në mënyrë të sigurt dhe me dinjitet.

Fjalë kyçe: Dhuna me bazë gjinore e ushtruar përmes teknologjisë, fushata Bodyright, autonomia trupore

Digital Dignity: Advancing Online Safety and Rights Through the Bodyright Campaign

Dr. Zarife Miftari¹, Dr. Visare Mujko Nimani¹, Donika Sabovic¹

¹UNFPA, Kosovo

Technology-facilitated gender-based violence (TFGBV)

Abstract

Introduction: The digital world, while full of potential, has also become a space where our bodies are violated and our dignity threatened. Technology-facilitated gender-based violence (TFGBV) is a growing public health and human rights concern. Women, girls, and marginalized groups increasingly face online abuse such as cyberharassment, doxxing, deepfakes, and non-consensual sharing of intimate images.

Aim: To raise awareness and promote systemic change around TFGBV through the implementation and localization of the bodyright campaign in Kosovo and the Western Balkans.

Materials and Methods: Launched globally by UNFPA in 2021 and in Kosovo in 2022, bodyright campaign introduces the  symbol to advocate for bodily autonomy online and equal protection for personal images. The campaign engages youth, universities, public figures, and institutions. UNFPA in Kosovo commissioned a legal analysis to identify gaps in protections against digital violence and adapted a TFGBV glossary into local languages to help young people and parents recognize digital abuse.

Results: The campaign has reached over 5 million people online. More than 15 public figures supported the initiative, helping to normalize public dialogue on digital violence.. The glossary and legal analysis have supported both awareness and advocacy efforts across sectors.

Conclusion: Bodyright exemplifies a multidimensional approach to combating TFGBV by combining legal reform, digital rights advocacy, and community education. It calls on policymakers, tech platforms, and society to ensure that all people, especially women, girls and marginalised groups, can navigate digital spaces safely and with dignity.

Keywords: Technology-facilitated gender violence (TFGBV), Bodyright campaign, Bodily autonomy

Shëndeti mendor në epokën digjitale: sfidat dhe mundësitë për fuqizimin e komuniteteve përmes edukimit shëndetësor online

¹Genc Bajraktari, gencbajraktari@gmail.com;

²Lirije Fazliu – Bajraktari, lirijefazliu@gmail.com;

¹Qendra Rajonale e Shëndetit Publik Mitrovicë,

²Spitali i Përgjithshëm Mitrovicë

Abstrakt

Hyrje: Rrjetet sociale janë shndërruar në një hapësirë të rëndësishme sociale dhe kulturore, sidomos për të rinjtë. Ato ndikojnë thellësisht në përjetimin e emocioneve, ndërtimin e identitetit dhe kërkimin e ndihmës për çështjet e shëndetit mendor. Megjithëse shpesh shihen si burim rreziku për mirëqenien psikologjike, rrjetet sociale ofrojnë gjithashtu potencial të madh për edukim shëndetësor dhe ndërgjegjësim publik.

Qëllimi: Ky punim synon të shqyrtojë ndikimin e rrjeteve sociale në shëndetin mendor dhe të identifikojë mënyra efektive për të përdorur platformat digjitale në funksion të promovimit të mirëqenies dhe fuqizimit të komuniteteve.

Materiali dhe metodat: Është bërë shqyrtim i literaturës shkencore lidhur me ndikimet psikologjike të rrjeteve sociale, si dhe praktikak ekzistuese të edukimit shëndetësor digjital. Janë analizuar modele ndërhyrjeje të zbatuara në kontekste të ndryshme komunitare dhe rekomandimet për qasje të përshtatshme kulturore.

Rezultatet: Platforma si Facebook, Instagram, Snapchat e TikTok, mund të përdoren në mënyrë efektive për edukim dhe ndërgjegjësim të popullatës, nëse mesazhet përshkruhen me gjuhë të qartë, të ndjeshme dhe vizualisht tërheqëse. Rrjetet sociale mund të kontribuojnë në reduktimin e stigmës dhe në promovimin e vetëkujdesit, sidomos nëse menaxhohen nga profesionistë të fushës.

Përfundimi: Teknologjia digjitale, kur përdoret me vetëdije dhe strategji të strukturuar, mund të jetë një mjet i fuqishëm në funksion të fuqizimit të komuniteteve të shëndetshme dhe promovimit të mirëqenies psikologjike.

Fjalë kyçe: shëndeti mendor, rrjetet sociale, edukimi shëndetësor

Mental health in the digital age: challenges and opportunities for empowering communities through online health education

¹*Genc Bajraktari, gencbajraktari@gmail.com;*

²*Lirije Fazliu – Bajraktari, lirikfazliu@gmail.com;*

¹*Regional Institute of Public Health Mitrovica;*

²*General Hospital Mitrovica*

Abstract

Introduction: Social networks have become an important social and cultural space, especially for young people. They profoundly influence the experience of emotions, the construction of identity and the seeking of help for mental health issues. Although often seen as a source of risk for psychological well-being, social networks also offer great potential for health education and public awareness.

Purpose: This proceeding aims to examine the impact of social networks on mental health and to identify effective ways to use digital platforms in order to promote well-being and empower communities.

Material and methods: A review of the scientific literature on the psychological impacts of social networks was conducted, as well as existing practices of digital health education. Intervention models implemented in different community contexts and recommendations for culturally appropriate approaches were analyzed.

Results: Platforms such as Facebook, Instagram, Snapchat and TikTok can be used effectively for education and awareness for population, if the messages are described in clear, sensitive and visually appealing language. Social networks can contribute to reducing stigma and promoting self-care, especially if managed by professionals.

Conclusion: Digital technology, when used with awareness and a structured strategy, can be a powerful tool in the function of strengthening healthy communities and promoting psychological well-being.

Keywords: mental health, social networks, health education

Promovimi i Shëndetit Seksual në Kosovë - qasjet dhe perceptimet

Hajrullah Fejza, Naim Bardiqi, Besa Balidemaj, Arbenita Pajaziti, Merita Vuthaj, Ariana Qerimi, Majlinda Gjocaj, Shqipe Ukelli
Ministria e Shëndetësisë e Kosovës
Hajrullah.Fejza@rks-gov.net

Abstrakt

Hyrje: Shëndeti seksual përbën një të drejtë themelore të njeriut dhe është një komponent i rëndësishëm i shëndetit publik. Në Kosovë, mungesa e edukimit seksual, normat konservatore dhe qasja e kufizuar në shërbime shëndetësore seksuale ndikojnë negativisht në mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësojë perceptimet e politikbërësve dhe qytetarëve të Kosovës mbi promovimin e shëndetit seksual, me fokus në: (1) politikat publike ekzistuese, (2) mjediset mbështetëse dhe (3) barrierat në marrjen e shërbimeve seksuale.

Materiali dhe Metodat: Studim prospektiv me metodologjinë cilësore. Të dhënat janë mbledhë në Prill 2025, me pyetësor të strukturuar, i shpërndarë online, me 453 pjesëmarrës, zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe qytetarë të rastësishëm. Të dhënat u analizuan me programin SPSS përmes përqindjeve dhe temave kyçe të përsëritura.

Rezultatet: Se nuk janë në dijeni të ndonjë politike publike kombëtare që promovon shëndetin seksual janë shprehur 61.6% kurse fusha që kanë më shumë nevojë për përmirësim përmes politikave publike janë edukimi gjithëpërfshirës mbi seksualitetin (50.7%) dhe mbrojtja nga dhuna apo abuzimi seksual (32.9%). Mbështetja nga komuniteti në këtë fushë është pak ose fare hiq mendojnë 83.7%. Ajo që do ta përmirësonte mjedisin për shëndetin seksual në komunitet është vlerësuar të jetë qasja më e mirë dhe programet edukative (74.9%). Për të hequr barrierat pjesëmarrësit theksojnë nevojën për më shumë institucione të specializuara dhe fushata ndërgjegjësuere (63.6%).

Përfundime: Pjesëmarrësit në hulumtim nuk janë në dijeni për politikat shtetërore që promovojnë shëndetin seksual dhe theksojnë nevojën për mbështetje institucionale të specializuar dhe fushata ndërgjegjësuere publike.

Fjale kyçe: shëndeti seksual, promovimi, qasje, perceptime

Sexual Health Promotion in Kosovo – Approaches and Perceptions

Hajrullah Fejza, Naim Bardiqi, Besa Balidemaj, Arbenita Pajaziti, Merita Vuthaj, Ariana Qerimi, Majlinda Gjocaj, Shqipe Ukelli

Ministry of Health of Kosovo

Hajrullah.Fejza@rks-gov.net

Abstract

Introduction: Sexual health constitutes a fundamental human right and is a vital component of public health. In Kosovo, the lack of sexual education, conservative norms, and limited access to sexual health services negatively impact the overall well-being of citizens.

Aim: The aim of this study was to assess the perceptions of policymakers and citizens in Kosovo regarding the promotion of sexual health, focusing on: (1) existing public policies, (2) supportive environments, and (3) barriers to accessing sexual health services.

Material and Methods: A prospective study using a qualitative methodology. Data were collected in April 2025 through a structured questionnaire distributed online, involving 453 participants, including officials from the Ministry of Health and randomly selected citizens. Data were analyzed using SPSS program through percentage-based summaries and recurring key themes.

Results: A total of 61.6% of participants stated they are not aware of any national public policy that promotes sexual health. The area's most in need of improvement through public policy were identified as comprehensive sexuality education (50.7%) and protection from sexual violence or abuse (32.9%). Furthermore, 83.7% believe that community support in this area is minimal or nonexistent. The key elements perceived to improve the sexual health environment in the community were better access and educational programs (74.9%). To remove barriers, participants emphasized the need for more specialized institutions and awareness campaigns (63.6%).

Conclusions: The participants in the study are not aware of state policies that promote sexual health and emphasize the need for specialized institutional support and public awareness campaigns.

Keywords: sexual health, promotion, access, perceptions

Kujdesi Grupor gjatë 1000 Ditëve të Para: Një Strategji për Promovimin dhe Kujdesin Shëndetësor gjatë Shtatzënisë

Fitim Sadiku¹, Rina Demiri¹, Labërie Çarreti-Sylejmani¹, Albiona Beha¹, Jona Kastrati¹, Elvanda Gojani¹, Era Cina¹, Donika Zeka¹, Anjeza Haradinaj², Lindita Rama³, Teuta Reçica⁴
Email: fitim.sadiku@amchealth.org

¹Aksioni për Nëna dhe Fëmijë (AMC)

² Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Vushtrri

³ Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Viti

⁴ Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Lipjan

Hyrja: Kujdesi në Grup në 1000 ditët e para (Group Care_1000) është një model ndërkombëtar gjithëpërfshirës për kujdesin antenatal dhe postnatal, i cili përfshin kombinimin e kujdesit shëndetësor klinik me promovimin shëndetësor, mbështetjen në grupe dhe rrjetëzimin social, si dhe ndërtimin e një komuniteti mbështetës.

Qëllimi: Qëllimi primar i këtij studimi është të pasqyrojë rolin e Kujdesit Grupor_1000.

Metodologjia: Ky studim ka përdorur një qasje të kombinuar për grumbullimin retrospektiv të të dhënave nga gratë shtatzëna, ku këto sesione janë implementuar nga AMC gjatë viteve 2022–2024 në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtrri, Viti dhe Lipjan. Për më shumë, është përdorur edhe një qasje e shqyrtimit të literaturës mbi Kujdesin Grupor_1000 për gratë shtatzëna në databaza si PubMed dhe Google Scholar.

Rezultatet: Nga rezultatet preliminare, në këtë hulumtim janë përfshirë 52 gra shtatzëna me moshë mesatare 28.7 vjeç. Mbi 19% kishin arsim universitar, dhe vetëm 27% ishin të punësuar derisa paramterat shëndetësor në sesionin e parë ishin në nivel optimal. Nga shqyrtimi i literaturës, studimet konfirmojnë se së fundmi Kujdesi në Grup_1000 është implementuar në 7 vende të botës, nga të cilat 4 janë vende evropiane: Holanda, Belgjika, Anglia dhe Kosova. Evidenca shkencore tregon se Kosova ka shkallën më të lartë të mortalitetit të foshnjëve në Evropë. Modelet si Kujdesi në Grup paraqesin modele për të përmirësuar shërbimet shëndetësore për kujdesin gjatë dhe pas shtatzënisë. Studimi tjetër konfirmon se nga 26 qendra implementuese nga 7 shtete të ndryshme janë gjetur sfida të ndryshme në implementim dhe ka qenë e nevojshme adaptimet lokale. Për më shumë, një rishikim sistematik ka konfirmuar kënaqshmërinë maternale më lartë me Kujdesin në Grup krahasuar me kujdesin standard e cila edhe e pasqyron metodologjinë e kujdesit grupor që kombinon vlerësimin klinik, fascilitimet nga punëtorët shëndetësor dhe diskutimi në grup dhe mundësinë e rrjetizimit dhe ndërtimin e një komuniteti mbështetës.

Përfundimi: Kujdesi në Grup_1000 paraqet një model të rëndësishëm për kujdesin dhe promovimin shëndetësor dhe një mekanizëm të rëndësishëm për një sistem të qëndrueshëm shëndetësor.

Fjalët kyqe: Kujdesi në Grup, gratë shtatzëna, kujdesi dhe promovimi shëndetësor

Group Care during the First 1000 Days: A Strategy for Health Promotion and Care during Pregnancy

Fitim Sadiku¹, Rina Demiri¹, Labërie Çarreti-Sylejmani¹, Albiona Beha¹, Jona Kastrati¹, Elvanda Gojani¹, Era Cina¹, Donika Zeka¹, Anjeza Haradinaj², Lindita Rama³, Teuta Reçica⁴

Email: fitim.sadiku@amchealth.org

¹Action for Mothers and Children (AMC)

²Primary Health Care Center, Vushtrri

³Primary Health Care Center, Viti

⁴Primary Health Care Center, Lipjan

Introduction: Group Care in the First 1000 Days (Group Care_1000) is an inclusive, international model for antenatal and postnatal care. It integrates clinical healthcare with health promotion, group support, social networking, and community-building, aiming to create a supportive environment for pregnant women.

Objective: The primary objective of this study is to highlight the role and impact of the Group Care_1000 model.

Methodology: This study utilized a mixed-methods approach, collecting retrospective data from pregnant women who participated in Group Care_1000 sessions implemented by AMC during 2022–2024 in Primary Health Care Centers in Vushtrri, Viti, and Lipjan. Additionally, a literature review was conducted using databases such as PubMed and Google Scholar to analyze existing studies on group care models for pregnant women.

Results: Preliminary findings include data from 52 pregnant women with an average age of 28.7 years. Of these, over 19% had a university degree, and only 27% were employed. Health parameters during the first session were generally at optimal levels. The literature review reveals that Group Care_1000 has recently been implemented in 7 countries, including 4 in Europe: the Netherlands, Belgium, England, and Kosovo. Scientific evidence shows that Kosovo has the highest infant mortality rate in Europe. Group care models such as this one offer promising solutions to improve maternal and neonatal healthcare services. Another study involving 26 implementation centers across 7 countries highlighted various challenges and the need for local adaptation. Furthermore, a systematic review confirmed higher maternal satisfaction with group care compared to standard care, reflecting the strengths of this model, which combines clinical assessment, health worker facilitation, group discussion, and opportunities for peer networking and support.

Conclusion: Group Care_1000 represents an essential model for health care and promotion during pregnancy and serves as a key mechanism for building a sustainable healthcare system.

Keywords: Group Care, pregnant women, health care, health promotion

Krahasimi i efektivitetit të anastomozës së vetme me mëngë ileale dhe anastomozës gastrike Roux-en-Y te pacientët obezë me Diabet të Tipit 2

Mehmet Fatih Erol (1), Huseyin Ayhan Kayaoglu HA (2).

Abstrakt

Hyrje: Rritja e shpejtë e obezitetit dhe problemeve të lidhura me të ka rritur rëndësinë e obezitetit dhe kirurgjisë metabolike, duke rezultuar në një kërkim të vazhdueshëm për metodën ideale kirurgjikale. Ky studim synonte të krahasonte efektivitetin e anastomozës gastrike Roux-en-Y (RYGB), e cila është metoda standarde e artë, dhe metodën relativisht më të re të anastomozës së vetme me mëngë ileale (SASI).

Metodat: Të dhënat mjekësore të pacientëve që iu nënshtruan anastomozës RYGB dhe SASI u rishikuan dhe u krahasuan në lidhje me humbjen e tepërt të peshës (EWL) dhe HgA1c, glukozën esëll, hekurin në serum, ferritinën, hemoglobinën (Hgb) dhe nivelet e vitaminës B12. Rezultatet: Indeksi i masës trupore ishte dukshëm më i ulët ($p = 0,003$), dhe %EWL ishte dukshëm më i lartë ($p = 0,023$) në 6 muajt pas operacionit tek pacientët që iu nënshtruan bypass-it SASI. Të dy grupet patën rezultate të ngjashme në vizitat e tjera të ndjekjes. Nivelet mesatare të HgA1c në vizitat e ndjekjes 6 dhe 12-mujore ishin dukshëm më të ulëta tek pacientët SASI ($p = 0,037$ dhe $p = 0,012$, përkatësisht). Në ndjekjen 24-mujore, nuk u zbulua asnjë ndryshim në nivelet e HgA1c midis grupeve ($p = 0,476$). Tek pacientët që iu nënshtruan RYGB, nivelet e ferritinës ($p < 0.001$), hekurit në plazmë ($p = 0.001$) dhe Hgb ($p = 0.001$) ishin dukshëm më të ulëta në 12, 24 dhe 12 muaj pas operacionit, përkatësisht.

Përfundimi: Bypass-i SASI është efektiv dhe i krahasueshëm me RYGB në aspektin e EWL dhe kontrollit metabolik dhe ka avantazhin e mosprodhimit të segmenteve të përjashtuara dhe reduktimit të mangësive ushqyese.

Informacion mbi autorin:

(1) *Departamenti i Kirurgjisë së Përgjithshme, Spitali i Edukimit dhe Trajnimit Yuksek Ihtisas, Mimarşinan Mah. Emniyet Cad. Yıldırım, Bursa, 16310, Turqi.*

(2) *Spitali Privat Hayat, Qendra e Kirurgjisë së Obezitetit dhe Metabolizmit, Bursa, Turqi.*

Artikulli u botua në Obesity Surgery, Vëllimi 34, Numri 10 (Tetor 2024), në faqet 37483754. U botua për herë të parë në internet më 20 gusht 2024, nga Springer Nature. DOI për artikullin është 10.1007/s11695-024-07472-2.

Comparison of the effectiveness of single anastomosis sleeve ileal bypass and Roux-en-Y gastric bypass in obese patients with Type 2 Diabetes

Mehmet Fatih Erol (1), Huseyin Ayhan Kayaoglu HA (2).

Abstract

Introduction: The rapid increase in obesity and related problems has heightened the importance of obesity and metabolic surgery, resulting in a continuing search for the ideal surgical method. This study aimed to compare the effectiveness of Roux-en-Y gastric bypass (RYGB), which is the gold standard method, and the relatively newer method of single anastomosis sleeve ileal (SASI) bypass.

Methods: The medical records of patients who underwent RYGB and SASI bypass were reviewed and compared regarding excess weight loss (EWL) and HgA1c, fasting glucose, serum iron, ferritin, hemoglobin (Hgb), and vitamin B12 levels.

Results: The body mass index was significantly lower ($p = 0.003$), and the %EWL was significantly higher ($p = 0.023$) at 6 months postoperative in patients who underwent SASI bypass. Both groups had similar results at the other follow-up visits. The mean HgA1c levels at the 6- and 12-month follow-up visits were significantly lower in SASI patients ($p = 0.037$ and $p = 0.012$, respectively). At the 24-month follow-up, no difference was detected in HgA1c levels between the groups ($p = 0.476$). In patients who underwent RYGB, ferritin ($p < 0.001$), plasma iron ($p = 0.001$), and Hgb levels ($p = 0.001$) were significantly lower at 12, 24, and 12 months postoperatively, respectively.

Conclusion: SASI bypass is effective and comparable to RYGB in terms of EWL and metabolic control and has the advantage of not producing excluded segments and reducing nutritional deficiencies.

Author information:

(1) Department of General Surgery, Yuksek Ihtisas Education and Training Hospital, Mimarsinan Mah. Emniyet Cad. Yıldırım, Bursa, 16310, Turkey.

(2) Private Hayat Hospital, Obesity and Metabolic Surgery Center, Bursa, Turkey.

The article was published in *Obesity Surgery*, Volume 34, Issue 10 (October 2024), on pages 37483754. It was first published online on August 20, 2024, by Springer Nature. The DOI for the article is

10.1007/s11695-024-07472-2.

Përfitimet dhe rreziqet e mundshme nga fluorizimi i ujit të pijshëm

Naile Gashi¹, Doncho Donev², Nora Berisha³

¹PhD kandidat, Departmenti i Shëndetit Publik, Fakulteti I Mjekesise, Universiteti "St. Cyril and Methodius", Shkup, Maqedonia e Veriut.

²Departmenti i Shëndetit Publik, Fakulteti I Mjekesise, Universiteti "St. Cyril and Methodius", Shkup Maqedonia e Veriut

³PhD kandidat, Departmenti i Ortodoncise, Fakulteti I Mjekesise, Universiteti I Prishtines, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt

Hyrje: Kariesi dentar është sëmundje dinamike që çon në demineralizimin e indeve të forta të dhëmbëve (struktura e dhëmbëve) duke çuar në humbjen e dhëmbëve dhe shfaqjen e deformimeve ortodontike. Është një sëmundje e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë, e parandalueshme, me ngarkesë të konsiderueshme ekonomike dhe ndikim në cilësinë e jetës. Masat parandaluese, ndër të tjera, përfshijnë fluorizimin lokal dhe sistematik. Fluorizimi i ujit si një masë parandaluese sistematike është një ndërhyrje e mirëfilltë e shëndetit publik në shumë vende, që synon reduktimin e kariesit dentar dhe përmirësimin e shëndetit oral.

Qëllimi: Të eksploroheh aspektet shëndetësore dhe etike, përfitimet dhe rreziqet, sfidat dhe shqetësimet, çështjet kritike dhe boshllëqet në kërkimin e bazuar në prova si edhe sfidat e zbatimit.

Materialet and metodat: Kërkim sistematik është bërë në studime të botuara në revista të rishikuara nga kolegët, punime të konferencave dhe raporte të qeverisë/shëndetit publik, si dhe artikuj që trajtojnë ndikimin e fluorizimit të ujit në shëndetin publik, veçanërisht në kariesin dentar, shëndetin oral ose politikat shëndetësore.

Rezultatet: Gjetjet kryesore të rishikimit të literaturës ishin përfitimet dhe shqetësimet e mundshme, udhëzimet e organeve rregullatore dhe qëndrimet globale ndaj fluorizimit. Një rishikim i studimeve të kryera në dhjetë vende midis viteve 1990 dhe 2000 për individë nga 3 deri në 44 vjeç tregoi një reduktim mesatar të kariesit midis 30% dhe 59% në dhëmbët primar dhe midis 40% dhe 49% në dhëmbët e përhershëm. Në Asamblenë Botërore të Shëndetit të vitit 2007, u miratua një rezolutë që qasja universale në fluor për parandalimin e kariesit duhet të jetë pjesë e të drejtës themelore për shëndet.

Përfundimet: Fluorizimi i ujit është një çështje komplekse. Ndërsa shumë e shohin atë si një mjet për promovimin e shëndetit publik, të tjerë kanë shqetësime për të drejtat individuale, ndikimin në mjedis dhe rreziqet e mundshme të ekspozimit afatgjatë. Pavarësisht efektivitetit të provuar të kostos dhe aftësisë për të adresuar pabarazitë e shëndetit oral, mungesa e politikave kombëtare dhe kornizave legjislative kufizon zbatimin e tij në shumicën e shteteve.

Fjalët kyçe: fluorizimi i ujit, shëndeti publik, etika e shëndetit publik, rreziqet shëndetësore të fluorizimit, përfitimet e fluorit.

The Benefits and Potential Risks of Drinking Fluoridated Water

Naile Gashi¹, Doncho Donev², Nora Berisha³

¹PhD Candidate, Department of Public Health, Faculty of Medicine, University "St. Cyril and Methodius", Skopje, North Macedonia.

² Department of Public Health, Faculty of Medicine, University "St. Cyril and Methodius", Skopje, North Macedonia

³³PhD kandidat , Department of Dentistry, Faculty of Medicine, University of Prishtina, Prishtina, Kosovo

Abstract

Dental caries is a dynamic disease that leads to demineralization of dental hard tissues (the tooth structure) leading towards tooth loss and appearance of orthodontic deformities. It is an unevenly distributed, preventable disease with considerable economic burden and impact on quality-of-life. Preventive measures, amongst others, include topical and systematic fluoridation. Water fluoridation as a systematic preventive measure is a well-established public health intervention in many countries, aimed at reducing dental caries and improve oral health.

Aim: To explore health and ethical aspects, benefits and risks, challenges and concerns, as well as critical issues, gaps in evidence-based research and implementation challenges.

